



FAKULTETI JURIDIK

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

FACULTY OF LAW

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI: E DREJTA CIVILE

TEZA:

**ADMINISTRIMI DHE DENACIONALIZIMI I VAKËFIT TË BASHKËSISË FETARE
ISLAME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT ME VËSHTRIM TË
POSAÇËM NË RAJONIN E TETOVËS**

KANDIDATI:

Muhammed Izeti

MENTORI:

Prof. Dr. Jeton Shasivari

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	7
QËLLIMET E HULUMTIMIT DHE HIPOTEZAT.....	8
KAPITULLI I PARË.....	9
INSTITUCIONI I VAKËFIT GJATË HISTORISË DHE ROLI I TIJ NË SHOQËRI.....	9
1.1 Definicioni i vakëfit dhe vendi i tij në shoqërinë Osmane.....	9
1.2 Llojet e vakëfeve.....	10
a) Humanitare	
b) Vakëfe profitabile	
c) Vakëfe trashëguese	
d) Vakëfet e përkohshme	
1.3 Mënyra e financimit të vakëfeve.....	13
1.4 Roli edukativ kulturor i vakëfeve.....	15
1.5 Vakëfet si institucione shkencore.....	24
1.6 Roli humanitar i vakëfeve.....	25
KAPITULLI I DYTË.....	29
ADMINISTRIMI I VAKËFEVE NË TERITORIN E RMV.....	29
2.1 Administrimi i vakëfeve në periudhën Osmane.....	29
2.2 Përmasat sociale dhe fetare në zgjedhjen e administratorëve.....	30
2.3 Vakëfnamet si dokumente juridike për administrimin e vakëfeve.....	31
2.4 Administrimi i vakëfeve në periudhën e Mbretërisë Jugosllave.....	40
2.5 Administrimi i vakëfeve në periudhën e ish RSFJ-së.....	58
2.6 Administrimi i vakëfeve në periudhën e Republikës së Maqedonisë.....	61
KAPITULLI I TRETË.....	65

DENACIONALIZIMI I VAKËFEVE NË RMV.....	65
3.1 Definicioni dhe historiku i denacionalizimit.....	65
3.2 Baza juridike e denacionalizimit të pronave në RMV.....	70
3.3 Procesi i denacionalizimit të vakëfeve të BFI-së në RMV.....	76
3.4 Praktika gjyqësore, administrative dhe analiza e përgjithshme e lëndëve të denacionalizimit të pronave në RMV.....	80
a) Kërkesa për denacionalizim e Myftinisë së Shkupit me numër 19-08-715/1 (38) e datës 07.09.2000.	
b) Kërkesë për denacionalizim me numër 19-385/07-2 e datës 20.11.2007 e parashtruar nga Myftinia e Shtipit këshilli i Xhamisë Pekçevë	
c) Kërkesë për denacionalizim me numër 19-08-580/1 (554) e datës 14.05.2002 e parashtruar nga Myftinia e Shkupit	
KAPITULLI I KATËRT.....	83
DENACIONALIZIMI I PRONAVE TË VAKËFIT TË BFI-SË NË RAJONIN E TETOVËS.....	83
4.1 Procesi i denacionalizimit në kuadër të Myftinisë së BFI-së në Tetovë.....	83
4.2 Denacionalizimi i Harabati Baba Teqesë.....	84
4.3 Denacionalizimi i Shtëpisë përmirësuese në Tetovë.....	87
4.4 Denacionalizimi i PK 3530, KK Tetovë-1 (në afërsi të varezave) në Tetovë.....	88
4.5 Privatizimi i tokës ndërtimore me numër PK. 1645, KK Tetovë-1 (afër shkollës së muzikës) në Tetovë.....	89
KONKLuzionet dhe rekomandimet.....	91
BIBLIOGRAFIA.....	96
A. BURIME ARKIVORE.....	96
B. TEKSTE UNIVERSITARE,PUBLIKIME, RAPORTE.....	96

C. BURIME JURIDIKE POZITIVE.....	100
SHTOJCË.....	101
VENDIMET GJYQËSORE TË LËNDËVE PËR DENACIONALIZIM.....	101
1. Kërkesa për denacionalizim e Myftinisë së Shkupit me numër 19-08-715/1 (38) e datës 07.09.2000.	
2. Kërkesë për denacionalizim me numër 19-385/07-2 e datës 20.11.2007 e parashtruar nga Myftinia e Shtipit këshilli i Xhamisë Pekçevë	
3. Kërkesë për denacionalizim me numër 19-08-580/1 (554) e datës 14.05.2002 e parashtruar nga Myftinia e Shkupit	
4. Lënda e denacionalizimit të Harabati Baba Teqesë	
5. Lënda e denacionalizimit të Shtëpisë përmirësuese në Tetovë	
6. Lënda e denacionalizimit të PK 3530, KK Tetovë-1 (në afërsi të varezave) në Tetovë	
7. Lënda e privatizimit të tokës ndërtimore me numër PK. 1645, KK Tetovë-1 (afër shkollës së muzikës) në Tetovë.	

HYRJE

Vakëfi dhe institucioni i vakëfeve kanë lozur një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme në perandorinë osmane dhe në zhvillimin e jetës arsimore, kulturore dhe fetaro-shpirtërore të popullatës. Vakëfet së bashku me administratën osmane janë zgjatur edhe në viset ballkanike dhe si pjesë e saj edhe në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që asokohe ishte pjesë administrative e Vilajetit të Kosovës.

Vakëfi është një e mirë e përgjithshme dhe bie nën kategorinë e vlerës së përhershme. Prona e lënë vakëf bëhet pronësi e Allahut dhe iu jepet në menaxhim njerëzve. Ndër veprat e bamirësisë më e mira, është ajo pasojat e së cilës janë më afatgjata, e ajo kohëzgjatje të vakëfi është e pakufizuar. Lënia vakëf është edhe një formë e veçantë e arritjes së njërit nga parimet më qenësore shoqërore-morale të Islamit, e kjo është sakrifikimi për të mirën e përgjithshme. Por, nuk duhet harruar se lënia vakëf ka qenë traditë edhe para Islamit, që është praktikuar nga profetët e Zotit, dhe nga ithtarët e tyre. Termi *vakëf* në hapësirën tonë shqiptare është i njohur, pa marrë parasysh se fjalori i gjuhës shqipe, këtij termi i kushton një rëndësi prej disa rreshtash: Vakëf... 1. Pasuri e patundshme, që ISHTE pronë e një xhamie, e një kishe, e një teqeje a e një manastiri; 2. Vend i shenjtë, sipas përfytyrimeve mistike fetare.¹

Vakëfi dhe institucioni i vakëfit është një nga çështjet më akute ndër muslimanët. Shekulli i XX-të nuk mund të flasë për institucionin e vakëfit, përpos për atë se si është shkatërruar, konfiskuar dhe harxhuar ai; këtë për fat të keq e kanë ndihmuar edhe vetë institucionet që janë ndërtuar dhe ndihmuar në mënyrë materiale që të ekzistojnë pikërisht nga vakëfi. Sistemi komunist për këtë ka qenë kapak i çdo gjëje, kohë kur janë marrë vendime, janë miratuar ligje për marrjen, shpronësimin dhe shtetëzimin e vakëfit.

Vakëfi në administratën osmane ka qenë i rregulluar me ligj, i cili kryesisht ka qenë i bazuar në ligjin fetar islam (sheriati) dhe në trajtë të hollësishme janë kodifikuar të gjitha të mirat materiale të lëna vakëf. Si rrjedhojë, nuk është e mundur të studiohet asnjë aspekt i marrëdhënieve shoqërore dhe ligjore të përfshira në jetën shoqërore-ligjore, politike dhe

¹ Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 2016.

ekonomike te perandorisë osmane nëse nuk kemi një qasje serioze për institucionin e vakëfit. Vakëfi, me një fjalë ka qenë shtyllë bartëse e jetës shoqërore në periudhën osmane dhe si pasojë rëndësia dhe pesha e tij ka vazhduar, për myslimanët, edhe në periudhat pas osmane, gjegjësisht me themelimin e komuniteteve myslimane në vendet prej të cilave është tërhequr shteti osman.

Derisa klasa sunduese osmane me në krye sulltanin dhe sistemi shtetëror reptësisht i centralizuar, kryesisht merreshin me mënyrën ushtarake të jetesës, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e organeve administative shtetërore dhe institucioneve të tjera, vakëfet përgjatë gjithë periudhës së sundimit osman mbetën burim i pashtershëm i zhvillimit dhe zgjerimit të ekonomisë, fesë, kulturës dhe arsimit në perandorinë osmane. Ekzistimi i vakëfeve të ndryshme vetëm e plotëson shumëllojshmërinë dhe ekzistimin e tyre në sistemin osman dhe jetën e përditshme të popullsisë që ishin qytetarë të këtij shteti.

Gjatë shekujve të parë të sundimit osman në territorin e RMV- së, është i dukshëm dhe shumë i zhvilluar procesi i formimit të pronës së vakëfeve dhe pronave private (mulk) të mëdha, të cilat i fitonin ushtarakët e mëdhenj që ishin dëshmuar gjatë luftërave të mëdha dhe në përforcimin e sistemit shoqëror në përgjithësi, kryesisht të bazuar në parimet fetare islame.

Kjo traditë e vakëfeve dhe ndikimit të tyre shoqëror ka vazhduar në tërë periudhën e sundimit osman , madje edhe në periudhat pas tërheqjes së shtetit osman nga këto troje. Por, tërheqja e shtetit osman ka rezultuar edhe me shpronësimin dhe konfiskimin e një numri të madh të vakëfeve të cilat kanë qenë të administruara , kryesisht, nga komunitetet fetare. Shpronësimet, gjegjësisht, uzurpimet dhe konfiskimet e vakëfit më masivisht janë bërë në periudhën e Jugosllavisë komuniste dhe si pasojë një numër i madh i pronave vakëfore të BFI-së janë konfiskuar nga ana e shtetit pa asnjë kompensim.

Me rënien e sistemit komunist, domethënë pas viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, kanë filluar edhe lëvizjet e BFI-së për kthimin e pronave të cilat kanë qenë të konfiskuara dhe nacionalizuara. Me këtë ka filluar edhe një proces juridik i denacionalizimit dhe kthimit të vakëfeve Bashkësisë Fetare Islame në territorin e RMV-së.

Qendra dhe fokusi kryesor i hulumtimit tonë janë vakëfet, llojet dhe shtrirja e tyre në territorin e RMV-së; mënyra e administrimit të tyre si dhe procesi i denacionalizimit, me theks të veçantë në rajonin e Tetovës.

Punimi përpiqet të nxjerrë në pah rolin juridik dhe shoqëror të vakëfit në këto vise si dhe problemet e denacionalizimit të të njëjtit në territorin e RMV-së. Si rrjedhojë, qëllimi është të nxirren rekomandime dhe përfundime të nevojshme në drejtim të kontekstit ligjor dhe analizës së paradigmes historike të këtij institucioni të rëndësishëm në jetën shoqërore në RMV.

Falënderim i veçantë i takon mentorit tim të nderuar Prof.dr. Jeton Shasivarit i cili me këshillat dhe intervenimet e tij e mundësoi plotësimin dhe formësimin përfundimtar të këtij studimi. Gjithashtu falënderoj edhe anëtarët e komisionit Prof.dr.Emine Zendeli dhe Doc.dr. Sami Mehmeti të cilët me kontributin shkencor ndihmuan dukshëm në rritjen e standardit shkencor të punimit.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Institucioni i vakëfit në RMV është shumë pak i shqyrtuar dhe analizuar nga aspekti shkencor. Përveç disa teksteve dhe punimeve monografike nuk ka ndonjë punim më serioz në lidhje me këtë çështje. Si rrjedhojë, hulumtimi shkencor juridik i vakëfeve, administrimit dhe denacionalizimit të tyre ka rëndësi të veçantë për kontekstin shkencor të kësaj lëmie por njëkohësisht edhe nga aspekti i të mirës publike.

Punimi është i rëndësishëm edhe nga aspekti i përgjithshëm i analizës së institucionit të vakëfit dhe krahasimit të procesit të denacionalizimit me shtetet e rajonit. Punimi, gjithashtu, do të nxjerr në pah edhe rolin e përgjithshëm shoqëror të vakëfeve gjatë historisë në çështjet arsimore, shkencore, kulturore, humanitare, etj.

Gjatë përgatitjes së këtij punimi shkencor janë shfrytëzuar disa metoda, për të cilat kemi menduar se mund të shërbejnë për një qasje thelbësore dhe sa më objektive. Ndër metodat kryesore që do të shfrytëzohen janë: *metoda e deduksionit*, në analizën koncepteve teorike mbi lëndën e studimit dhe sipas të cilave do të nxirren përfundime konkrete lidhur me rajonin e hulumtimit; *metodën historike*, në përcaktimin e gjenezës dhe evoluimit të vakëfeve; *metoda*

statistikore, për paraqitjen e anës praktike të lëndëve të denacionalizimit; *metodën analitike*, për analizimin e të dhënave për procesin e denacionalizimit, normave ligjore pozitive dhe konkluzave të dalura prej tyre dhe; metodën juridike dhe normative në interpretimin e dispozitave ligjore dhe vendimeve administrative.

QËLLIMET E HULUMTIMIT DHE HIPOTEZAT

Qëllimi i hulumtimit i kësaj teme është i orientuar në analizën dhe sqarimin e sistemit vakëfor në teritorin e RMV duke filluar nga themelimi i tyre në Perandorinë Osmane e deri në ditët e sodit me përqëndrim në dokumente burimore; gjithashtu të nxirret në pah roli dhe kontributi i vakëfeve në sistemin social dhe juridik të këtyre viseve dhe konteksti i tyre edukativ, shkencor, arsimor, kulturor dhe humanitar.

Një prej çështjeve elementare të temës është edhe procesi tejet i vështirë dhe i stërgjatur i denacionalizimit të vakëfeve të cilat janë nacionalizuar si pronë e BFI-së. Me zbardhjen e fakteve për vakëfet automatikisht do të dalin në pah edhe pargullsitë juridike në kuadër të procesit të denacionalizimit. Deri te këto qëllime do të përpiqemi të vijmë nëpërmjet fakteve burimore shkencore dhe duke patur kujdes që të mos cënohet objektiviteti shkencor.

Hipoteza kryesore e këtij punimi është rëndësia dhe roli i vakëfeve dhe mënyrës së administrimit të tyre në kuadër të shoqërisë në teritorin e RMV-së me theks të veçantë në rajonin e Tetovës si dhe zbardhja, sipas mundësive, e procesit të denacionalizimit të vakëfeve të BFI-së në RMV.

Hipoteza dytësore është e përqëndruar në analizën dhe sqarimin e përmasave pozitive apo negative që kanë lozur vakëfet gjatë historisë dhe mundësia që ata të shërbejnë si paradigmë për mënyrat e veprimtarive të ndryshme organizative në shoqërinë e sodit.

KAPITULLI I PARË

INSTITUCIONI I VAKËFIT GJATË HISTORISË DHE ROLI I TIJ NË SHOQËRI

1.1 Definicioni i vakëfit dhe vendi i tij në shoqërinë Osmane

Institucioni i Vakëfit, kuptimet e të cilit në fjalor hasen si "të ndalet; të ndalë, të privojë" do të thotë një organizatë bamirëse e themeluar me një proces ligjor që mund të përmblihet si "dhurim i përjetshëm i një prone nga ana e pronarit, pronë kjo e cila duhet të përdoret për arsye dhe nevoja fetare, bamirësie dhe nevoja të përgjithshme" dhe përbën një nga elementet e rëndësishme të civilizimit islam². Vakëfet - të cilat përbëjnë një gamë të gjerë llojllojshmërie-mund të grupohen si më poshtë:

1. Për nga pronësia vakëfet ndahen në burimore dhe jo-burimore. Vakëfet të cilat kanë të bëjnë me prona të tokave, pasuri të tjera të luajtshme dhe të paluajtshme konsiderohen si vakëfe burimore. Realisht ky është kuptimi bazë i nocionit 'Vakëf'. Ndërsa vakëfeve jo-burimore u referohet edhe si vakëfe **irsadi** ose vakëfe të përvetësuar. Vakëfe të tilla vijnë si rezultat i ndarjes së tokës e cila është pronë e autoritetit publik (shtetit), por me kushtin që pronësia e tokës në fjalë të mbetet prap në shtet. Sipas kësaj, shteti vazhdimisht ndanë të ardhurat e kësaj prone për financimin e shërbimeve publike si arsimi, shëndetësia dhe shërbimet e sigurimeve shoqërore, në emër të vakëfit. Për shkak se të mirat materiale të cilat sigurohen në këtë mënyrë nuk përmbajnë cilësi me anë të së cilave këto të mira do të mund të konsideroheshin si prona, atëherë edhe vakëfi si i tillë nuk konsiderohet si vakëf në kuptimin e parë të fjalës. Prandaj këto vakëfe konsiderohen si vakëfe jo-burimore. Kjo nuk do të thotë që ky lloj vakëfi ligjërisht mund të konsiderohet i pavlefshëm. Për më tepër, vakëfet jo-burimore i janë nënshtruar dispozitave të tokës publike.

2. Për sa i përket përfituesve, vakëfet ndahen në vakëfe bamirësie dhe **zurri**. Vakëfet e bamirësisë janë vakëfe të cilat janë themeluar për bamirësi si qëllimin e vetëm të tyre, ndërsa përfitues nga këto vakëfe janë të varfërit, udhëtarët, nxënësit etj. Në anën tjetër, vakëfet **zurri** janë vakëfe nga të cilat përfitojnë të afërmit e pasur apo/dhe të varfër të dhuruesit, ndërsa përfitimi i përfituesve

² Enciklopedia Islame e Dijanetit të Turqisë, DIA, Stamboll 1986, vëll.: 42; faqe: 475.

të tjerë (që nuk janë të afërt me dhuruesin) nga ky lloj vakëfi e bënë të pamundur cilësimin e këtij të fundit si vakëf **zurri**. Ky lloj vakëfi ndryshe quhet edhe si vakëf për fëmijë të adoptuar. Edhe pse ky lloj vakëfi i cili është konsideruar i lejueshëm nga shumica e juristëve u ka hapë rrugë diskutimeve të shumta përgjatë shekujve të fundit, ai në shoqërinë Osmane është konsideruar si i ligjshëm dhe ka gjetur një aplikim të konsiderueshëm.

3. Sa i përket formës së përdorimit të tyre, vakëfet ndahen në vakëfe të cilat sjellin përfitime direkte dhe vakëfe të cilët sjellin përfitime indirekte. Vakëfet që sjellin përfitime direkte, në literaturën e legjisllacionit janë quajtur si ‘muessesat-i hajrije’, ‘hajrat’ dhe ‘meberrat’. Këto janë gjithashtu të ndara në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë hapësirat apo/dhe objektet nga të cilat përfitojnë të gjithë njerëzit, siç janë: faltoret, bibliotekat, bujtinat, çesmet, puset, urat, hanet, varrezat publike etj., ndërsa në grupin e dytë bëjnë pjesë institucionet nga të cilat përfitojnë vetëm të varfërit, siç janë: bujtinat, spitalet, **dulhanet** etj. Në anën tjetër, vakëfet të cilat sjellin përfitime indirekte janë ato vakëfe përfitimet e të cilave vijnë jo direkt nga vakëfi, por nga të ardhurat që i sjellin këto të parat.

Në këto vakëfe, kapitali i nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve në të mirë të shoqërisë sigurohet përmes të ardhurave që sjell menaxhimi me këto vakëfe. Patundshmëritë si: tokat, vreshtat dhe minierat të ardhurat e të cilave shfrytëzohen, quhen **“mustegallat”**, ndërsa qendrat e mbuluara të punës, pazaret (çarshitë) etj. quhen **"musakkafat"**. Në praktikën osmane, vakëfet e tilla u ndanë në katër grupe të cilat për bazë kishin mënyra të ndryshme të menaxhimit: **"ixhare-i gahideli, ixharejitesi, mukataali dhe ixhare-i shahide-i kadimeli"**. Si rezultat i disa nevojave të veçanta të cilat janë imponuar përgjatë procesit historik, disave prej tyre u është njohur edhe e drejta për përdorime të vakëfeve që sjellin përfitime direkte, siç janë: malet (gedik), ndërtesat, **huluv, urf-i belde dhe sukna**³.

1.2 Llojet e vakëfeve

Sipas studimeve të deritashme të vakëfeve, ato mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme. Si pasojë e mendimeve të ndryshme juridike islame edhe klasifikimi i tyre, nga autorë të ndryshëm, është bërë në shumë mënyra. Shumica e llojeve të vakëfeve janë të kushtëzuara nga natyra dhe

³ Enciklopedia Islame e Dijanetit të Turqisë, DIA, Stamboll 1986, vëll.: 42; fq: 477-78

nevoja e ushtrimit të obligimeve, qëllimeve, detyrave të ndryshme shoqërore, etj., si dhe nevoja materiale e ekzistimit të tyre, ato më tutje ndahen në grupe dhe nëngrupe varësisht nga qëllimi i themelimit të tyre.

Vakëfet në të shumtën e rasteve kishin karakter fetar, arsimor, human, social, ekonomik, etj., si dhe ishin të dedikuara për qëllime të ndryshme të cilat dhuruesi- vakëflënësi i ka marrë parasysht gjatë hartimit të aktit të vakëfimit (vakëfnames).⁴

Duke mos u thelluar në ndarjen e hollësishme të vakëfeve, pasi që edhe nuk është bosht i temës tonë, ne do të paraqesim vetëm njërin prej ndarjeve për të cilën mendojmë se është më përfshirëse për teritorin e RMV-së. Ndarja më përfshirëse për vakëfet në teritorin e RMV-së mund të jetë ndarja e vakëfeve sipas peshës së tyre shoqërore. Në bazë të kësaj ndarjeje llojet e vakëfeve janë:

a) Humanitare

Vakëfe të cilat shfrytëzohen nga shoqëria dhe popullata pa pasur ndonjë reciprocitet apo kompensim material dhe para së gjithash shfrytëzohet për të ndihmuar institucionet bamirëse dhe për qëllime humanitare. Siç janë: vakëfet e xhamive, shkollave, bibliotekave, barnatoreve, spitaleve, vakëfet që u ndihmonin njerëzve të varfër dhe të sëmurë, mirëmbajtjen e burimeve të ujit, varrezave, banjave dhe të ngjashme. Ilustrim më adekuat për këtë lloj të vakëfit është vakëfi i Sungur Çavush Beut (vd. 1470) i cili ka qenë edhe guvernator/vali i vilajetit të Manastirit. Ai, siç e shpreh në vakëfnamen e tij, ka lënë trashëgimi të madhe për të mirën e myslimanëve në këto troje. Në vakfijen e përpiluar në vitin 837 sipas kalendarit lunar/1435 për mirëmbajtjen e xhamisë, medreses dhe teqes që i ka ndërtuar në Manastir ka lënë vakëf një han, 25 dyqane, një kopsht, dy tregje/pazare, shtatë mullinjë dhe një vrrështë me sipërfaqe të madhe.⁵

b) Vakëfe profitabile

Vakëfe që kishin kapital dhe të ardhura dhe të cilat në masë të madhe shfrytëzoheshin për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore dhe kulturore, apo edhe për ndihmesë të të varfërve.

⁴ Begoviç, Mehmed, *Vakufi u Jugoslaviji*, Beograd 1963, f.25

⁵ Kaleshi, Hasan, *Najstari Vakufski Dokumenti u Jugoslaviji na Arapskom Jeziku*, Prishtinë, 1972, f.72-73.

Pjesa dërmuese e këtyre vakëfeve përbëhej nga patundshmëritë, siç ishin, dyqanet, hanet, mullinjtë, vrrështat, arrat etj. Si ilustrim për këtë lloj të vakëfit mund të konsiderohet vakëfi i Is'hak Beut të Shkupit i cili për funksionimin e vakëfit të tij ka lënë vakëf dy hamame/banjo publike, 102 dyqane, dy hane, një shtëpi, dhe 7 ara me sipërfaqe të madhe.⁶

c) Vakëfe trashëguese

Ky lloj i vakëfeve, nga ana e juristëve myslimanë, nuk është pranuar si lloj i vakëfimit islamik, por ama vakëfe të tilla ka pasur në periudhat më të vonshme të perandorisë osmane. Në këtë lloj të vakëfit vakëflënësi për trashëgimtarë të pronave vakëfore i ka vendosur trashëgimtarët biologjik të tij. Të tilla mund të konsiderohen vakëfet e bejlerëve të periudhës së vonshme, gjegjësisht në shekullin e XIX. Si shembull mund të përmenden shtëpitë e bejlerëve të Tetovës në fshatin Bardovc të Shkupit, të cilat janë trashëguar nga vetë bijt e tyre, bëhet fjalë për Rexhep dhe Abdurrahman Pashain dhe të cilat më vonë në periudhën komuniste janë konfiskuar nga ana e shtetit.⁷

d) Vakëfet e përkohshme

Ky lloj i vakëfeve formohet sipas nevojës dhe në kohë të caktuar lidhur me rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme shoqërore-ekonomike, politiko-ushtarake si dhe të problemeve aktuale që paraqiteshin.

Vakëfe të tilla formoheshin për zbutjen e pasojave nga fatkeqësitë natyrore: epidemitë e ndryshme, sëmundjet, vërshimet, zjarret, etj. Pas arritjes së qëllimit të këtyre vakëfeve ato shfuqizoheshin dhe nuk ekzistonin më. Vakëfe të tilla formoheshin edhe për ndërtimin e ndonjë rruge të përbashkët, ujësjellësit, çezmave dhe objekteve tjera. Si shembull mund të përmendet vakëfi i formuar për rregullimin e rrugëve anësore pas ndërtimit të hekurudhës Manastir- Shkup në fillim të shekullit XX.⁸

⁶ Kaleshi, Hasan, *po aty*, f. 90.

⁷ Në vendin e këtyre vakëfeve momentalisht gjinden rezidencat e disa ambasadave të huaja, siç është rezidenca e ambasadës së Rusisë.

⁸ Birol, Nurettin dhe Akpinar, Deniz, *xix. yüzyıl sonlarında manastir vilâyeti ve vali Halil Rifat Paşa'nın faaliyetleri (1887-1889)*, *Akademik Sosyal Araştırmalar Dergisi*, Viti: 3, numër: 14, Qershor 2015, fq. 139-156

1.3 Mënyra e financimit të vakëfeve

Themeluesi i vakëfit (Vakifi) për t'i shërbyer qëllimit për çka e ka themeluar vakëfin ka lënë edhe burimet e të ardhurave përmes të cilave do të qëndrojnë në këmbë vakëfi gjegjësisht. Gjithashtu në Vakëfname e ka paraqitur hollësisht edhe pagesën për personat që do ta administrojnë vakëfin. Ky sistem i të ardhurave nga vakëfet ka shërbyer si mirëmbajtës kryesor i jetës fetare në kuadër të komuniteteve fetare edhe në periudhën e ish RSF të Jugosllavisë, në viset ku ka pasur myslimanë. Të ardhurat nga vakëfet janë shfrytëzuar për organizimin e jetës kulturore dhe fetare në kuadër të komunitetit fetar.

Financimi kryesor i vakëfeve të themeluara në periudhën osmane ka qenë prej pronave që vakëflënësi ia ka bashkangjitur institucionit kryesor të cilit i shërbente vakëfi. Për shembull: nëse vakëflënësi kishte themeluar vakëf për ndërtimin e një medreseje/shkolle, xhamie ose teqeje, krahas objektit i cili do të shfrytëzohej për aktivitetet e secilës prej të sipërpërmendurave ka lënë vakëf edhe fusha, vrrështa, dyqane, mullinj, pazare dhe të ngjashme nga të ardhurat e të cilave do të mirëmbaheshin institucionet arsimore, fetare ose kulturore që ishin në kuadër të një vakëfi të caktuar.⁹

Fuqia ekonomike e vakëfeve në periudhën osmane ka qenë shumë e madhe dhe burimet e të ardhurave i kanë pasur të ndryshme. Pra, ata krahas pasurisë dhe pronave që i ka lënë vakifi kanë pasur të ardhura edhe nga pjesa tjetër e afaristëve dhe pasanikëve në shoqëri si dhe nga fitimet e ndryshme që janë fituar prej pronës së vakëfit, si qiraja, tregtia, e kështu me rradhë. Sipas statistikave pasuria e vakëfeve në periudhën osmane ka qenë përafërsisht $\frac{3}{4}$ e pronave të përgjithshme private në shtetin osman.¹⁰

Sipas një hulumtimi të bërë me sondazhe të parafytyruara në lidhje me përmasën financiare të vakëfeve brenda një shekulli është konstatuar se ekonomia e shtetit Osman në shekullin e XVII 15,97%, në shekullin e XVIII 26,80%, në shekullin XIX 15,77%, ka qenë në duart e vakëfeve. Krahas asaj që në periudha të ndryshme ka ndryshuar organizimi dhe sistemi i punës, por ama është më

⁹ Çizakça, Murat, *Osmanli Donemi Vakıfların Tarihsel ve Ekonomik Boyutları*, Stambol 2000, f.24.

¹⁰ Güran, Tevfik, *Ekonomik ve Mali Yönleri ile Vakıflar Süleymaniye ve Şehzade Süleyman Paşa Vakıfları*, Stambol, 2006, f. 10,11.

se e qartë se vakëfet, në saje të pasurisë së tyre, kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin agrar, industrial, tregtar si dhe në prodhimtarinë e vendeve ku kanë vepruar.¹¹

Vakëfet janë institucione që kanë bërë edhe investime në vende të ndryshme, gjegjësisht burimet letargjike, të papërdorshme janë shndërruar në dinamike përmes investimeve të ndryshme. Si rrjedhojë, në arrat e lëna vakëf janë mbjellur kultura bujqësore profitabile, dyqanet janë dhënë me qira ose janë punuar në trajtë të ortakërisë me esnafët, depotë e ndryshme janë shndërruar në atelje për prodhime, kryesisht, manifakturale. Ndërsa të ardhurat prej këtyre vakëfeve u janë dedikuar institucioneve arsimore, kulturore, fetare, madje me një pjesë janë ndihmuar edhe të varfërit.¹²

Vetëm fakti se në gjelltoret e vakëfit/imaretet e Stambollit në shekullin e XVIII në ditë kanë ngrënë ushqim tridhjetë mijë persona e tregon qartë aktivitetin e vakëfeve dhe fuqinë financiare të tyre. Situata, nga aspekti i funksionimit ka qenë e njëjtë edhe në viset tona. Për shembull, në gjelltoren/imaret të Harabati Baba Teqesë në Tetovë për çdo ditë, sipas vakëfnames, është dashur që t'u shtrohet ushqim tre here në ditë më së paku 60 personave nga të varfërit apo udhëtarët.¹³

Shembujt në lidhje me të ardhurat, mënyrën e financimit të vakëfeve dhe rolin që ata e kanë lozur në ngritjen kulturore dhe arsimore në trevat e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të shtohen edhe më. Ndër vakëfet e para në këto treva janë edhe vakëfet e themeluara në qytetin e Shkupit, si p.sh.: vakëfi i xhamisë dhe i medresesë Medah, që konsiderohen si objekte më të vjetra islame në këto treva të ndërtuar gjatë viteve 1397/98, nga udhëheqësi i Shkupit, Jigit Pasha. Medreseja Medah ka dhënë shumë personalitete të shquara, midis të cilëve më i njohuri është filozofi Lutfullah Efendiu. Emrin Medah e ka marrë nga myderrizi i parë baba Medah – emri i vërtetë i të cilit ishte Mudehin. Brenda oborrit të xhamisë dhe medresesë, është ndërtuar edhe

¹¹ Öztürk, Nazif "Sosyal Siyaset Açısından Cumhuriyet Öncesi Vakıflar", **Cumhuriyetin 80. Yılında Uluslararası Vakıf Sempozyumu**, Ankarë: 2004, f. 41.

¹² Yediyıldız Bahaeddin, "Türk Vakıf Kurucularının Sosyal Tabakalaşmadaki Yeri 1700-1800", **Osmanlı Araştırmaları**, II, Stamboll: 1982, f. 156.

¹³ Ömer Lütfi Barkan, "Fatih İmaretleri 1489-90 Yılları Muhasebe Bilançoları", **İktisat Fakültesi Mecmuası**, vëll. XXIII, Stamboll: 1963, f. 299.

tyrbeja ku gjendet varri i Jigit Pashës¹⁴. Osmanologu nga Shkupi, Ahmed Sherif, duke iu referuar dëfterëve osmane, thekson se të dhëna më të vjetra për vakëfin e Jigit Pashës gjendet në defterin e detajuar të vitit 1453/54, i cili është regjistruar nën titullin “Vakëfet e Pashait Jigit beut në qytetin e Shkupit”. Në përbërje të këtij vakëfi kanë qenë përfshi këta objekte: një han kryesor (një dyqan për krerë të deleve, dhive dhe lopëve) me të ardhura vjetore me një shumë të përgjithshme prej 3.700 akçe; 26 dyqane me të ardhura vjetore prej 500 akçe, përkatësisht, të ardhura të përgjithshme vjetore prej gjithsej 14.200 akçe¹⁵. Sipas tij, vakëfet dhe pronat vakëfnore shumë më të rëndësishme janë të djalit të tij, Is’hak beut të cilat janë të regjistruara si “Vakëfet e të ndjerit Is’hak beut”, si dhe të dy djemeve të këtij të fundit: Isa beu dhe Mustafa Pashës¹⁶, të cilët gjatë qeverisjes së tyre, i kanë ndërtuar dy xhamitë e njohura të Shkupit, atë të Isa Beut e të Mustafa Pashës, ndërtimi i së cilave sipas të dhënave të ofruara në vitin 1936 nga Drejtoria e Vakëfit në Shkup, e para është ndërtuar në vitin 884 sipas hixhretit, ndërsa e dyta në vitin 890 po sipas hixhretit¹⁷. Këtu veçmas duhet përmendur vakëfi i Mustafa Pashës, i cili siç thuhet në Promemorien e vitit 1930 të tre famullitarëve të Kishës Katolike të Kosovës, dërguar sekretarit të Këshillit të Kombeve në Gjenevë, Erik Dramondit “xhamia Gazi Mustafa Pasha në Shkup ishte organizatë bamirëse e klasës së parë” e cila posedonte 13 fshatra në mesin e të cilëve ishin edhe Krushapeku, Bullaçani, Novo Sella dhe Rashtaku. “Kryersit të testamentit të kësaj prone – thuhej në promemorie - Shefqet Beut djalit të Haxhi Mustafa Beut iu konfiskua e tërë prona nga qeveria jugosllave. Kjo organizatë ju ndante nga 200 bukë në ditë të varfërve....”¹⁸.

1.4 Roli edukativ kulturor i vakëfeve

Vakëfi, që do të thotë shpërndarje gjatë gjithë jetës e një pasurie, me qëllim afrimin të Zotit, duke përmbushur qëllimet shoqërore, bamirësie dhe fetare, në përputhje me nevojat e shoqërisë, në të njëjtën kohë vinte edhe në kuptimin e ndihmës institucionale. Një gjë është e ditur që

¹⁴ Архив Југославије /Министарство просвете Краљевине Срба, Хрвата и Словенаца/ (мë tej АЈ), фасцикл 1102, арх. јед. 1429 (Велика Медреса Крал Александар I), Историја Школа у Скопљу.

¹⁵ Sherif, Ahmed, po aty, f.71.

¹⁶ По ату.

¹⁷ Државен Архив на Република Македонија, фонд Улема Меџлис во Скопје, кутија 23, документи 91-96, листови 378-414 (нë текстин е мëtутјешëm: ДАРМ. 1. 613. 23. 91-96/378-414).

¹⁸ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941, përmbledhje dokumentash, përzgjedhjen, parathënien dhe redaktimin: Mr. Qerim Lita, dok. nr. 16, fq. 101-137.

ndërtesat që ishin *vetëpërfituese* si spitale, çezma, ura, biblioteka, zaviye, imarete, shkolla, medrese, mesxhide apo xhami, të cilat hynin në të ashtuquajturën “çështje bamirësie” (*muessesat-i hajrije*), gjithashtu me burimet e të ardhurave si para, dyqane, hane, mulli, tokë e shtëpi, të gjitha këto janë quajtur vakëfe.¹⁹ Vakëfi si instancë kishte treguar progres në shumë shtete islame, me veçanti te osmanët, dhe në të njëjtën kohë qytetërimi osman u njoh edhe si “qytetërimi i vakëfeve”. Brenda asaj që sot quhet “shteti social”, ku pritet ndihma nga shteti në aspektin e mirëqenies shoqërore, të shkollimit, transportit, sigurimit shëndetësor, punëve publike etj, nën qeverisjen osmane u realizuan përmes vakëfit.

Me futjen nën sovranitet të ndonjë vendi, së pari ndërtoheshin vakëfet si hamame, imarete, medrese, mektepe, zaviye, teqe, mesxhide e xhami të iniciuara nga sulltanët, pjesëtarët e dinastisë, administratorët dhe bamirësit, dhe për këto caktohej një shumë e të ardhurave dhe emëroheshin nëpunës. Kështu duke futur nën kontroll si jetën shoqërore po ashtu edhe atë fetare, u arritën shumë qëllime si zhvillimi ekonomik, zhvillimi i veprimtarive arsimore dhe jetesa fetare. Ndërtimi i objekteve të vakëfeve të ndryshme, në njërin anë pakësonte nevojat e elementit mysliman, në anën tjetër i jepte një karakter edukativ islam pamjes ndërtimore të qendrave të banuara.²⁰

Shqiptarët jo vetëm që kanë lënë vakëfe në vendlindjen e tyre, por kanë lënë gjithandej ku jetuan e vepruan asokohe në kufijtë e shtetit osman. Edhe pse nuk është e mundur të tregohen dhe të renditen këtu të gjitha llojet e vakëfeve që kanë të bëjnë me përhapjen e arsimit dhe kulturës të themeluara në trevat tona, dhe fushat e shërbimit të tyre, - megjithatë mund të jepen disa shembuj të rëndësishëm, sa për të pasur një ide dhe një pasqyrë më të plotë për ato vakëfe që kanë shërbyer për çështje edukative:

- ndërtimi dhe mirëmbajtja e xhamive, namazgjaheve, teqeve dhe tyrbeve;

- mektepet, medresetë dhe bibliotekat;²¹

¹⁹Yediyildiz, Bahaeddin , “*Vakıf*”, **Enciklopedia e Dijanetit të Turqisë DIA**, XIII, Stamboll, 1986, fq. 153-172.

²⁰Ulken, Hilmi Ziya , “*Türk Vakıf Sistemi ve Türk Şehirciliği*”, **Vakıflar Dergisi**, IX, Ankara 1971: fq.13-37.

²¹Osman Nuri Topbash, *Vakëfi, dhurimi dhe shërbimi*/përktheu Mithat Hoxha, pa vend dhe vit botimi, f. 24-25; Dr. Hasan Kaleşi, “*Najstariji vakufski...*”, vep. cit., f. 13-14.

Me një fjalë, vakëfet kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe domethënës në jetën e shqiptarëve, dhe kjo si në aspektin fetar e profan, po ashtu edhe në aspektin kulturor, arsimor, social dhe human. Roli i vakëfit është shumë i madh edhe në formimin dhe ndërtimin e zhvillimin e shumë lagjeve dhe kasabave/qyteteve shqiptare. Korça, zhvillimin e saj si kasaba e ka marrë edhe në saj të vakëfeve që i ka lënë Iljas Bej Mirahori, Kaçaniku me vakëfet e Koxha Sinan Pashës, Gjakova me vakëfet e Bizeban Sylejman Agës, Tirana me vakëfet e Sylejman Bargjinit, Opoja (Kosovë) me vakëfet e Mehmet Kuklibegut, Rogova (Kosovë me vakëfet e Jemishxhi Hasan Pashës), Shkupi me vakëfet e Is'hak dhe Isa beut dhe medresetë e tij, Tetova me vakëfet e Sinan Çelebiut dhe të Koxha Rexhep Pashës etj. Thënë shkurt, të rralla janë vendbanimet tona ku jetojnë ose ku kanë jetuar myslimanët; që të mos kenë një e më shumë vakëfe dhe hajrate. Në vendbanimet urbane numri i vakëfeve është ku e ku më i madh, për të arritur në dhjetëra sosh.

Në shumë vende ka edhe sot e kësaj dite emra vakëfesh, të cilët dëshmojnë për vakëfet dhe vakëflënësit tanë që kanë jetuar në ato vende; edhe sot e kësaj dite komuniteti islam dhe institucionet e tyre (xhamitë, medresetë etj.) përfitojnë nga vakëfet që dikur, moti, patën lënë njerëzit e mirë dhe fetarë, pavarësisht se vakëfet e mbetura janë një pjesë fare e vogël, nga gjithë ai mal vakëfesh që ekzistonte dikur.

Sipas rrëfimeve të udhëpërshkruesit të njohur Evlija Çelebi në vitin 1660 numri i medreseve në Maqedoni ka qenë 24, ndërsa në shekullin e XIX kishte më tepër se 45 medrese.²² Gjithashtu Evlija Çelebiu e thekson se në teritorin e RMV-së asokohe ka pasur 97 mektepe.

Për rolin e institucionit të vakëfit në përhapjen e kulturës dhe arsimimit te ne mund të shihen duke u bazuar në vakëfnamet e shkruara nga themeluesit. Sa për ilustrim mund të përmenden vakëfnamet: *Vakëfnameja e Kukli-begut nga Opoja*, e legalizuar në vitin 1538, *Vakëfnameja e Koxha Sinan Pashës nga Topojani i Lumës*, e legalizuar në vitin 1586, dhe *Vakëfnameja e Mahmud pashë Rrotllës nga Prizreni*.²³

²² Ramadani, Naser, *Depërtimi osman në Maqedoni dhe zhvillimi i arsimit islam gjatë shekujve XV-XVI*, Shkup 1998, f. 82.

²³ Krahës asaj që këta vakëfname sipas kufive të tashëm i takojnë Republikës së Kosovës asokohe një pjesë e madhe e qyteteve të RMV-së sotshme kanë qenë nën administrimin e këtyre sanxhaqeve. Si p.sh. Tetova dhe Gostivari kanë qenë të administruara nga Sanxhaku i Prizrenit.

Sipas vakëfnameve të sipërpërmendura, vakëfet më të mëdha janë lënë për xhamitë, mektepet, medresetë, bibliotekat etj., kurse arsimimi islam në trojet tona përmes formave institucionale, gjithnjë sipas këtyre vakëfnameve, zhvillohej kryesisht në:

1. *Xhami* - me anë të hytbeve, ligjëratave të rregullta javore për xhematlinjtë; me anë të ligjëratave nga *qyrsitë*, me anë të vazeve; me anë të ligjëratave të përkohshme;
2. *Mektepe* - me anë të arritjes së arsimimit themelor;
3. *Medrese* - me anë të arsimimit të përgjithshëm, të mesëm dhe të lartë, dhe sidomos të arsimimit profesional;
4. *Biblioteka/kutuphane* - me anë të shfrytëzimit të literaturës.

Përhapja e *xhamive*, *mektepeve*, *medreseve*, *teqeve* dhe *bibliotekave* ka ndikuar në mënyrë të ndjeshme në zgjerimin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të ndërsjella kulturore shqiptaro-orientale.

Xhamitë, mektepet, medresetë, bibliotekat, etj., kanë ndikuar pa dyshim në vetë popullsinë, në kulturën e saj, në zhvillimin moral, në zakonet, në arsimin fetar e artistik dhe në aspekte të tjera.

Xhamitë, si institucioni më i rëndësishëm fetar islam, në RMV kanë njohur një shtrirje të madhe në kohë dhe hapësirë. Xhamitë, gjatë tërë historisë së tyre, përveçse faltore, *u bënë edhe shkolla të para*. "Shkolla, - siç vëren me të drejtë historiani i njohur F. Hiti, - i qe bashkuar xhamisë, nëse ajo vetë nuk ishte xhami"²⁴ dhe nuk kishte ndryshime parimore midis shkollës dhe xhamisë²⁵. Më vonë afër xhamive u ndërtuan godina për arsimin fillor, të quajtura *mektepe*, numri i të cilave u rrit aq shumë, saqë në çdo fshat kishte të tillë, madje në shumë raste kishte edhe më tepër se një²⁶.

Në teritorin e RMV-së funksioni shkollor i xhamive ishte i pranishëm, d.m.th. shkollat fetare islame në RMV janë të vjetra po aq sa edhe xhamitë. Kështu, vakëfnameja e Kuklibeut, e vërtetuar më 1538, i cili në atë kohë kishte ndërtuar shumë objekte fetare dhe social-humanitare, dëshmon se ai kishte ndërtuar dy xhami, të cilat njëkohësisht ishin edhe shkolla, kurse në mesin e dëshmitarëve

²⁴ Filip Hiti, *Istorija Arapa*, Sarajevo, 1983, f. 370.

²⁵ Nerkez Smailagić, *Leksikon Islama*, Sarajevo, 1990, f. 150.

²⁶ Prof. Dr. Ziya Kazici, *Historia e arsimit islam*, Tiranë, 2001, f. 18.

kishte edhe disa mësues (mualimë)²⁷. Një shkollë të ngjashme më 1513 kishte ndërtuar edhe Suziu, madje ai edhe vetë ishte mësues në të²⁸. Faktin se vetë vakëflënësi ishte edhe mësues në shkollën që themelonte dhe linte vakëf, e quajmë mjaft domethënës dhe me rëndësi të veçantë. Gazi Mehmed pasha, pranë njërës prej xhamive më të bukura jo vetëm në Prizren, ndërtoi edhe medresenë e parë e cila për nga përmbajtja dhe niveli i arsimit dallohej në tërë Rumelinë²⁹.

Veprimtarinë e xhamive e dëshmojnë edhe dokumentet e tjera, sipas të cilave deri në gjysmën e dytë të shek. XVII-të zakonisht kishte aq mektepe, sa kishte edhe xhami. Prandaj mund të përfundohet se në mjediset myslimane numrit të xhamive përafërsisht i përgjigjej numri i mektepeve³⁰. Në teritorin e RMV-së përveç *mektepeve* (numri i të cilave ishte shumë më i madh), gati në çdo qytet relativisht të madh të RMV-së ,vepronte edhe nga një *medrese* që mbaheshin mbi parime vakëfi³¹.

Secila medrese, sipas rregullit, kishte *bibliotekë/kutuphane* të veten. Bibliotekat, krahas xhamive dhe medreseve, kanë ndikuar shumë në zhvillimin kulturor dhe në ngritjen arsimore të popullsisë myslimane në këto treva. Më e vjetra ndër to, me sa dihet, është ajo që pati themeluar Isa Beu në Shkup para vitit 1513³².

Mirëpo, librat - dorëshkrimet orientale nuk janë ruajtur vetëm nëpër bibliotekat e medreseve - shkollave (ndonëse këto ishin më të rëndësishmet, sepse shërbenin edhe si biblioteka publike), por ato kanë qenë pronë dhe e xhamive, teqeve dhe bibliotekave private, numri i të cilave në RMV, sikurse dihet, ka qenë i madh.

Në arsimimin islam në trevat tona, mund të thuhet se në pjesën më të madhe përfshiheshin dituritë tradicionale (*nakli*), siç janë *tefsiri* - komentimi i Kuranit, *Hadithi* - Tradita islame, *Fikhu* - shkenca e së drejtës së Sheriatit, por nuk mbeteshin anash as dituritë racionale (*akl*), si p.sh.

²⁷ Kaleši, Hasan në: *Kosova nekad i danas*, Beograd, 1973, f. 922.

²⁸ Redžepagić, Jašar, *Razvoj i obelježa turskih škola na teritoriji današnje Jugoslavije do 1912 godine*, "Studije", 1988, f. 52 - 53.

²⁹Kaleši, Hasan në: *Kosova nekad i danas*, vep.cit., f.470.

³⁰Dr. Svetozar G. Čanović, *Specifični problemi nastave u školama Kosova i Metohije*, Priština, 1967, f. 30.

³¹ Madžida Bećirbegović, *Prosvjetni objekti islamske arhitekture*, "Starine Kosova", VI-VII, Prishtinë, 1972-1973, f. 82.

³² Madžida Bećirbegović, *Prosvjetni objekti islamske arhitekture*, , f. 91-92.

historia (*tarih*), apologjetika (*kelam*), gramatika (*sarf*), morfologjia dhe sintaksa (*nahv*) dhe të tjera. Kurse mësimi të Kuranit, arsimimi islam i jepte rëndësi të veçantë, dhe kjo është e kuptueshme pikërisht për faktin se Kurani, për myslimanët, është burimi i parë dhe se në te kanë bazën të gjitha shkencat³³.

Në këtë aspekt myslimanët në trevat tona shfrytëzonin disa tefsirë nga komentatorë të shquar botërorë, si Tefsirin e Bejdaviut, Ibn Hazmit, Zemahsheriut, Taberiut etj.. Kujdes i veçantë në arsimimin islam i kushtohej edhe Hadithit, si burim i dytë i Islamit dhe për shkak të popullaritetit që gëzonte.

Për studimin e *Fikhut* /drejtësisë islame shfrytëzoheshin vepra të ndryshme, kryesisht të shkollës juridike hanefite, duke pasur parasysh se medhhebi hanefij ishte zyrtar në trevat tona si pjesë përbërëse të Perandorisë Osmane³⁴.

Karakteristikat e sipërcituara të arsimimit islam në trojet tona ishin të ngulitura në vetëdijen e myslimanëve si rregulla, si të thuash, që kishin karakter detyrues, dhe si të tilla i detyronin edhe vakëflënësit në vendosjen e kushteve (shurûtu 'l-vakifi)³⁵, për se edhe u përpoqëm të tërheqim vërejtjen për së paku disa nga karakteristikat e arsimimit islam në trevat tona.

Kështu, vakëflënësit përcaktonin kushtin që imamët dhe hatibët duhej të njihnin mirë patjetër të drejtën e Sheriatit dhe Traditën islame (Hadithin). Koxha Sinan pasha i sipërpërmendur, kishte vënë kusht që në xhaminë që ai kishte ndërtuar në Kaçanik: *“Të emërohet një hatib i aftë, që njëj Sheriatin, që është i arsimuar, orator, me zë të mirë, të mbajë hydben në mënyrë tradicionale për çdo të xhuma dhe bajrameve”*. Ai po ashtu kishte vënë kusht: *“Që në xhami të emërohej edhe një imam i arsimuar me veti lakmuese, me përvojë në respektimin e kushteve për namaz me xhemat për secilin namaz, të jetë i drejtë dhe i këndshëm... Edhe dy myezinë që secili prej tyre do të thërrasë ezanin, duke u kujdesur për pastërtinë dhe duke hipur në minare...”*.³⁶

³³ Dževat Hodžić, *Vakuf i islamska prosvjeta u našim krajevima*, në; “Islamska misao”, br. 66, Sarajevo juni 1984, f. 31; Ibrahim Džananović, *Vakuf u svjetlu islamskih propisa*, në: “Anali Gazi Husrev-Begove biblioteke”, knjiga IX-X, Sarajevë, 1983, f.9.

³⁴ Për më tepër, shih në: Dr. Omer Nakičević, *Izučavanje hadisa u našim krajevima do polovine XIX vijeka*, në: Glasnik VIS-a u SFRJ, br. 4 dhe 5, 1983, f. 513-522 dhe fq. 641-653.

³⁵ Dževat Hodžić, *Vakuf i islamska prosvjeta...* f. 31.

³⁶ Dr. Hasan Kaleši, *“Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku”*, Prishtinë, 1972, f. 302

Pastaj, kishte vakëflënës të cilët në vakëfndametë e tyre kërkonin që detyrën e imanit dhe hatibit ta kryenin persona të ndryshëm. Vakëflënësit ngulmonin edhe në faktin që imamët dhe hatibët nuk mund të jenë assesi shërbyes gjyqësorë dhe të merren me detyra të tjera, në mënyrë që të mos e lënë pas dore shërbimin në xhami. Kështu p.sh. Kukli Begu kishte vënë kushtin që: *“Në qoftë se dikush nga shërbyesit, qoftë imam, myezin ose kushdo qoftë, merret me bujqësi, detyra e tyre le t’u jepet të tjerëve”*³⁷. Vakëflënësit ndikimin e tyre e shprehnin edhe përmes caktimit të vlerës së pagave për shërbyesit e xhamive. Kështu, p.sh. hatibët shpesh kishin pothuaj pagë të barabartë me pagën e imamëve. Kukli Begu, imanit dhe hatibit të xhamisë në kasabanë e Zinovës, u kishte caktuar pagën prej 4 akçesh në ditë, kurse dy myezinëve nga dy akçe në ditë. Po aq e kishte caktuar edhe pagën për hatibin e xhamisë në Prizren³⁸.

Vakëflënësit mund të ndikonin në arsimimin islam edhe në mënyrë që të vendosnin kushte për numrin e ligjëratave (vazeve dhe derseve), llojin e tyre, për caktimin e individit që do t’i realizonin si dhe burimet (librat) në të cilat do të bazoheshin. Në këtë pikëpamje “është karakteristike dhe interesante të theksohet se një numër i konsiderueshëm i vakëflënësve, shumica e tyre tregtarë, linin të holla dhe patundshmëri amanet për mbajtjen e vazeve (ligjëratave) në këtë xhami. Shpesh me atë rast përcaktohej edhe libri, i cili do të përdorej me rastin e ligjëratave, e caktohej edhe personi që do të mbante atë ligjëratë.”³⁹

Vakëflënësit mektepet i ndërtonin dhe i themelonin të shumtën herë pranë xhamive. Mektepet në trojet tona gjatë pushtetit osman ishin në funksion të shkollave fillore. Në ato arrihej arsimimi fillestar fetar.

Ata kishin ndikim edhe në nivelin e mësimi dhe drejtimet e zhvillimeve në mektepe. Atë ndikim e arrinin me kushtet e ndryshme që përcaktonin në vakëfndametë e tyre. Vakëflënësit, me kushtet e veta, siguronin kujdesin material për fëmijët që shkolloheshin në këto mektepe. Mahmud pashë Rrotlla kishte paraparë 800 groshë për furnizimin e talebeve. Kështu p.sh. vakëflënësi kishte siguruar mjetet për blerjen e rrobave dhe e kishte kushtëzuar që për çdo Ramazan në prag të

³⁷Dr. Hasan Kaleši, Hasan Kaleši-Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zadužbine*, , f. 165.

³⁸Dr. Hasan Kaleši, Hasan Kaleši-Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg.*, f. 164.

³⁹Mehmed Mujezinović, *Islamska epigrafika BiH*, Knjiga I, Sarajevë, 1974, f. 278.

natës së Kadrit t'u ndaheshin secilit fëmijë në mektep.⁴⁰ Ose, vakëflënësi p.sh. kishte përcaktuar që çdo fëmijë t'i ndahej ushqim, ose fruta, ose ëmbëlsira (në prag të ditës së xhuma)⁴¹. Vakëflënësit ndikonin në ligjëratat e mektepeve edhe me kërkesa pedagogjike. Kështu, përveç të tjerash, vinin kushte të tilla që mësuesi në mektep gjithmonë të jetë i "buzëqeshur, i këndshëm, i butë", ose ndaj të gjithë nxënësve të këtë sjellje sikur babai ndaj fëmijëve të vet, "duke mos bërë kurrfarë dallimi në mes tyre".⁴² kishin kushtëzuar (Sinan pasha) që mësuesi të ishte njohës i mirë i Kuranit dhe texhvidit, me tipare pozitive, me moral të fortë që do t'i mësonte fëmijët e myslimanëve që të lexonin Kuran⁴³. Meqenëse, mektepet ishin kryesisht mjaft të frekuentuara ndonjëherë vakëflënësit (p.sh. Koxha Sinan pasha, Kukli begu etj.) përcaktonin ndihmësin për mësuesin, respektivisht zëvendësin, të cilin e kushtëzonin që të ishte "një njeri i mirë dhe i ditur, i cili do të jetë zëvendës i mësuesit: ai do t'i përsërisë leksionet para nxënësve.⁴⁴ Duhet pasur parasysh edhe fakti që vakëflënësit gati përherë caktonin edhe sasinë e pagave për mësuesit/mualimët në mektepe. Mahmud pashë Rrotlla, për mësuesin e mektepit të tij, kishte caktuar 140 groshë, kurse Kukli begu kishte paraparë dy akçe për mësuesin, kurse një akçe për zëvendësin e tij, përsëritësin.

Gjatë periudhës osmane numrin më të madh të medreseve/shkollave i kishin themeluar dhe i mirëmbanin vakëflënësit. Dhe, kur është fjala për arsimimin islam në trojet tona, vakëflënësit me kushtet që parashikonin për punën e atyre shkollave, kishin shumë ndikim. Ata, me vënien e kushteve të tyre, rregulluan gati të gjitha veprimtaritë e punëve të atyre medreseve. Në vakëfnametë e tyre ata së pari siguronin pagë të lakmueshme për profesorët/myderrizët dhe nxënësit e medreseve (talebet, softët). Kështu, Mahmud pashë Rrotlla, për myderrizin e medresesë së tij, të nderuarin haxhi Ali Efendiu, kishte përcaktuar 1.200 groshë. Ose, sipas vakëfnamesë së Ishak Çelebiut nga Manastiri (v. 1508), të gjithë nxënësit e medresesë së tij merrnin nga dhjetë derhemë për çdo ditë, ndërsa myderrizi i asaj medreseje nga njëzet derhemë për çdo ditë.⁴⁵ Që nxënësve t'iu siguroheshin kushte optimale për mësim dhe punë, vakëflënësit

⁴⁰ Dževat Hodžić, *po aty*, f. 33

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty.

⁴³ Dr. Hasan Kaleši, *"Najstariji vakufski dokumenti...", po aty, f. 304.*

⁴⁴ Dr. Hasan Kaleši, *"Najstariji vakufski dokumenti ..., vep. cit., f. 303.*

⁴⁵ Dr. Hasan Kaleši, *"Najstariji vakufski dokumenti ..., f. 198.*

pranë medreseve ndërtonin dhoma banimi (konvikte). Mahmud pasha Rrotlla kishte ndërtuar tetë dhoma për banimin e studentëve të medresesë.

Vakëflënësit përcaktonin shpesh se cilat lëndë do të mësoheshin si dhe numrin e lëndëve. Kishte raste që edhe vetë ata të kishin punuar si profesorë në medresetë e tyre. Edhe raste kur vakëflënësit me kushtet e tyre të përcaktuara në vakëfname, synonin që medresetë e tyre të ishin në funksion të përhapjes së Islamit në troje të caktuara.⁴⁶

Për të gjitha vakëfnamet nga kushtet që vakëflënësit parashihnin e që kishin të bënë me procesin edukativo-arsimor në medrese, është e përbashkët se kërkonin mësimin kryesisht të *shkencave tradicionale*, pastaj atyre *racionale*; dhe që për profesorë të caktoheshin njerëzit e ndershëm, të moralshëm, të përgatitur, me përvojë, "të cilët me ligjërata dhe shkrime zbulonin të vërtetat"⁴⁷.

Historia e edukimit dhe e arsimit klasik në teritorin e RMV-së ka një lidhje të ngushtë me bibliotekat, sepse midis shkollave islame (mektepeve, medreseve etj.) dhe bibliotekave kishte marrëdhënie të ngushta dhe të veçanta. Shumicën e bibliotekave që u themeluan në kuadër të arsimit islam në trojet tona, i themeluan bamirësit duke vakëfnuar numër të madh veprash të ndryshme nga lëmi i shkencave islame. Vakëflënësit i ndërtuan bibliotekat pranë mektepeve, medreseve, xhamive (p.sh. në Prizren Suzi Çelebiu, Gazi Mehmed pasha, Gazi Isa Beu etj.). Vakëflënësit në vakëfnametë e tyre parashihnin një regjim të saktë të rendit të bibliotekave, për të cilat, në të gjitha rastet është karakteristike se "librat nuk mund të dilnin jashtë objekteve që ishin paraparë për shfrytëzimin e tyre". Libra kanë lënë edhe gratë fisnike dhe të njohura. Shumica e dorëshkrimeve dhe librave në gjuhët orientale, që kanë arritur deri në ditët tona, mbajnë vulat dhe firmat që dëshmojnë se janë lënë vakëf nga akëcili vakëflënës dhe për akëcilën medrese⁴⁸. Këtë çështje e konsiderojmë tepër domethënëse.

Është shumë e njohur se bibliotekat/kutuphanet i kishin themeluar disa dijetarë, personalitete të rëndësishme si dhe dashamirësit e librit, të cilët kishin bërë punë të ndryshme gjithandej intelektuale e profesionale, dhe që kishin mundësi për të blerë libra.

⁴⁶ Dr. Hasan Kaleši, "Najstariji vakufski dokumenti", f. 15.

⁴⁷ Dževat Hodžić, *po aty*, f. 34.

⁴⁸ Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës, Prishtinë*, 2008, f. 47, 69, 72, 133.

Është i njohur fakti se librat ishin shumë të shtrenjtë, sepse ata shkruheshin me dorë dhe shoqëroheshin me ilustrime të ndryshme. Të shumtën këta libra liheshin vakëf para vdekjes së pronarëve të tyre, ose ata i linin vakëf trashëgimtarët e tyre pas vdekjes, për disa shkolla (medrese), bibliotekat e të cilave ishin rritur në këtë mënyrë dhe ishte shtuar numri i librave në to.

Si bibliotekat po ashtu dhe medresetë, ishin të themeluara vetëm sipas sistemit të vakëfit. Meqenëse vakëfi ishte institucion i bamirësisë dhe librat ishin prej gjërave që mund të liheshin vakëf, shumë biblioteka, të cilat në kohën e themelimit të tyre ishin shumë modeste, me kalimin e kohës u shtuan me një numër të konsiderueshëm librash. Kështu nuk ishin vetëm personalitetet e njohura dhe të pasurit, që linin libra vakëf, por këtë e bënë edhe njerëzit që kishin një pasuri modeste, madje edhe zanatçinjtë e ushtarët (gazitë), të cilët jo vetëm kishin lënë vakëf libra, po ata i hasim të kenë qenë edhe përshkrues e kopjues të tyre⁴⁹.

Dëshirën që libri të ishte i shfrytëzueshëm sa më mirë dhe sa më shumë, e gjejmë të përmendur në çdo vakëfname ku përmenden librat e vakëfnuar. Këtë të dhënë e gjejmë edhe në vetë librin e vakëfnuar.

1.5 Vakëfet si institucione shkencore

Nga pikëpamja e arsimimit në trojet tona, duhet theksuar edhe një faktor shumë i rëndësishëm. Ky ka të bëjë me faktin se, me ardhjen e fesë islame në trojet tona dhe gjatë shekujve, njerëzit tanë kanë kaluar nëpër qendra të ndryshme kulturore dhe shkencore (Stamboll, Kajro, Damask, Mekë, Bagdad) për të arritur arsimimin, sidomos arsimin e lartë, specializimin në fusha të caktuara, synonin njohjen sa më të mirë të arritjeve shkencore. Që nga fillimi i shekullit XV-të bamirësit në trojet tona themeluan vakëfe për të ndihmuar udhëtarët (*imarete, mysafirhane, karavansaraje* e të tjera). Me ato vakëfe ata kontribuan në një masë të madhe në zhvillimin dhe nivelin e lidhjeve të komunikimit. Kukli begu, përveç të tjerash, kishte lënë vakëf edhe 117 dyqane në Prizren, 50 dyqane dhe shumë mullinj në Lezhë të Shqipërisë, një urë në lumin Vardar afër

⁴⁹ Zagorka Janc, *Islamska minijatura*, Zagreb, 1985, f. 26.

Tetovës dhe 14 karvansaraje në “Rrugën e Dukagjinit” dhe në “Rrugën e Stambollit”.⁵⁰ Kurse Koxha Sinan pasha vetëm në Kaçanik kishte lënë vakëf 2 hane dhe një hamam etj.⁵¹

Përveç asaj që vakëfet kanë kontribuar në shkollimin profesional të kaudrove ata kanë themeluar edhe institute të ndryshme për zhvillimin e degëve të caktuara shkencore. Të tilla janë Institutet për mësimin e traditës profetike/Daru’l-hadith, Institutet për shkencat kuranore/Daru’l-kurra, observatoriumet/rasathane dhe të ngjashme.

1.6 Roli humanitar i vakëfeve

Institucioni i vakëfit në shtetin osman nënkuptonte që myslimani vakëflënës nëpërmjet bamirësisë, të përjetonte kënaqësinë e një veprimi të tillë dhe për rrjedhojë, të përjetësonte edhe emrin e tij nëpërmjet këtij akti. Nga ana tjetër, vakëfi gëzonte edhe nxitjen dhe përkrahjen e vetë shtetit, sepse, në këtë mënyrë, ky i fundit realizonte edhe një pjesë të mirë të shërbimeve publike në dobi të shoqërisë. Nëpërmjet institucionit të vakëfit gjithashtu për shumë familje, garantohej trashëgimi i pasurisë në një mënyrë të qëndrueshme dhe më të rregullt.⁵²

Diapazoni i vakëfit në shtetin osman ishte shumë i gjerë. Ai përfshinte sfera të tilla të rëndësishme si arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën dhe sidomos, mirëmbajtjen, funksionimin dhe ndërtimin e monumenteve të kultit, ndihmën për të sëmurët dhe të vobegët, etj. Në procesin e vakëfimit të pasurisë ishte kusht që vakëflënësit të ishin njerëz të pjekur mendërisht, por nuk kishte kufizime gjinore dhe fetare në këtë çështje. Kjo do të thotë që aktorë të këtij procesi mund të ishin si burrat ashtu edhe gratë, si myslimanët ashtu edhe jomyslimanët. Nga të dhënat arkivore del se në Perandorinë Osmane 36% e dhuruesve të pasurisë nëpërmjet institucionit të vakëfit, ishin gra.⁵³

Vakëfet kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë dhe vendbanimeve në vendet islame sepse në saj të këtij institucioni në këto vende janë ndërtuar shumë ndërtesa publike. Përgjatë administrimit osman, ato në të njëjtën kohë përfaqësojnë edhe institucionin e

⁵⁰ Hasan Kaleši-Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg ... po aty*.

⁵¹ Dr. Hasan Kaleši, *“Najstariji vakufski dokumenti”, f. 274.*

⁵² Ekrem Buğra Ekinci, *Osmanlı Hukuku: Adalet ve Mülk* (İstanbul: Arı Sanat, 2012), 411. Shih gjithashtu: J. N. D. Anderson, “Religious Element in Waqf Endowments”, *Journal of the Royal Asian Society*, Volume 38, 1951-[Issue 4](#); marrë nga: <https://doi.org/10.1080/03068375108731420> (published online on 25 Feb. 2011), 292.

⁵³ *Po aty*, 413

vetëm të kredisë. Si burim i përhershëm i burimeve materiale, në saj të vakëfeve janë realizuar funksionet e institucioneve fetare, kulturore, edukative dhe humane si dhe kishin mbetur aktive ato institucione.

Në aspektin ekonomik dhe shoqëror, vakëfi është një institucion financiar dhe social që jep kontribut në jetën e individit dhe cilësinë e zhvillimit ekonomik, social, kulturor dhe fetar të shoqërisë. Me vakëfname përfundon pronësia e personit mbi atë mall dhe kështu ai mall kalon në pronësi të vakëfit.

Nuk ka fare dyshim se roli kryesor i vakëfeve ka qenë i përqëndruar në aspektin human, gjegjësisht si institucione shoqërore humanitare. Përmeshja e qëllimeve humanitare të tyre ishte në përpikshmëri i kornizuar nga e drejta islame, gjegjësisht pronat e vakëfuara dhe të ardhurat nga vakëfet pa kushtëzime do ti shfrytëzojnë edhe të varfërit edhe anëtarët e komunitetit të cilët nuk kanë pronë.⁵⁴

Sa i përket përmeshjes së detyrës humanitare, përmes dhënies së lëmoshës dhe formave të ndryshme të ndihmës, arriheshin qëllimet e mëposhtme: ndihmesa e të varfërve, strehim i bonjakëve dhe të pastrehëve, ndihmesa e nxënësve, ndihmesa e udhëtarëve, dhënia e ushqimit falas përmes kuzhinave të vakëfeve/imareteve, strehim të udhëtarëve në ndërtesa të ashtuquajtura mysafirhane, ndërtimin e kervansarajeve/motele përgjatë rrugëve për strehim të udhëtarëve dhe tregtarëve, ndihmesë e atyre që kishin borxhe, dhënien e mbrojtjes dhe lirimit e skllevërve, ndihmë të sëmurëve dhe njerëzve të vobektë etj.

Në vakëfname në të shumtën e rasteve nënvizohej fakti se pjesa më e madhe e të ardhurave nga vakëfi do të shpenzohen për ndihmesë për të varfërit. Mënyra e ndihmesës, poashtu, ishte e cekur në vakëfname, ndërsa shpeshherë haset në të dhëna për ndarjen e ushqimit nga kuzhinat e vakëfeve apo ndarjen e ndonjë ndihme tjetër materiale. Në shumë vakëfname është theksuar ndarja e ndihmesës në veshmbathje dhe ushqim për bonjakët.⁵⁵

Një lloj tjetër i ndihmës humanitare dhe dhënies së lëmoshës ishte edhe ndihma që u ndahej nxënësve, të cilët më pas duhej t'i përkushtohen zhvillimit dhe përhapjes së edukimit dhe

⁵⁴ Ahmet Sherif, *Vakëfet në Maqedoni në periudhën osmane*, Shkup 2006, f. 47.

⁵⁵ Shabanovic, Hazim, *Dvije najstarije vakufname u Bosni*, **Prilozio za orijentalnu filologiju I istoriju jugoslovenskih naroda pod turskom vladavinom**, II, Sarajevo, 1951, f.18

arsimimit në teritorin prej ku vinin. Për ta vakëfuesit përveç formave të ndryshme të ndihmës, parashihnin edhe sigurimin e banimit falas në dhomat e medresesë dhe ushqim falas. Poashtu, nxënësve, sipas kushteve, u ndaheshin edhe libra falas dhe ndihmë e caktuar financiare, siç theksohet në vakëfnamen e Is'hak Beut për nxënësit e Alaxha xhamisë në vitin 1445.⁵⁶

Në mesin e objekteve më të njohura vakëfore humanitare ishin edhe imaretet/kuzhinat popullore, të cilat paraqitnin një lloj prone vakëfore në të shumtën e rasteve të themeluara nga sulltanët dhe njerëzit me famë në shtetin osman, në të cilat ndahej ushqim falas për të varfërit, udhëtarët, tregtarët, nxënësit dhe njerëzit që ishin zyrtarë të vakëfit. Për këto objekte haset shpesh në të dhëna nëpër vakëfname, ku vakëflënësit përcaktojnë sasinë e ushqimit që do të ndahet, çfarë ushqimi do të ndahet dhe kush do të ushqehet brenda ditës.⁵⁷

Në mesin e aktiviteteve humane të vakëfeve bëjnë pjesë edhe ndihmesa e njerëzve që kishin borxhe. Ky akt shtetëroro-juridik te osmanët është bartur nga arabët dhe masovikisht kishte gjetur përdorim në RMV dhe më gjerë në Ballkan.⁵⁸ Sipas parimeve të Kuranit myslimanëve u rekomandohej që ti mbronin borxhlinjtë, gjegjësisht rekomandohet të respektohen ata njerëz të cilët në një fare mënyre kishin borxhe. Në disa pjesë të Kuranit, madje edhe rekomandohet që borxhlinjtë të ndihmohen⁵⁹, gjegjësisht dhënësi të borxhit të mos ketë mundësinë që vetvetiu ti padisë apo dënojë për borxhin pa leje dhe vendim të përparshëm të kadiut.

Sipas normave dhe të drejtës së sheriatit në aktet humane dhe bamirëse konsiderohet edhe dhënia e mbrojtjes borxhlinjve apo edhe lirimit të skllëvërve. Lirimi i skllëvërve në qarqet feudale osmane vlerësohej si akt bamirës, për çka flasin shumë të dhëna në dokumentet osmane, veçanërisht në sixhilet të shkruara nga kadinjtë. Të tilla raste ka shumë edhe në sixhilet e qytetit të Manastirit.⁶⁰

Roli human dhe bamirës i vakëfeve shihet edhe nga respektimi i akteve që kanë të bëjnë me ndihmesën e njerëzve të sëmurë dhe të varfër. Ky akt dhe obligim rezultonte nga respektimi i

⁵⁶ Elezovic, Glisla, *Turski Spomenici u Skoplju*, **Glasnik Skopskog Naucnog Društva**, libri I, fletorë 1, Shkup 1925, fq. 460-461.

⁵⁷ Po aty, fq. 467-470.

⁵⁸ *Sixhilet e Manastirit*, Departamenti për dokumentacion pranë Institutit për histori nacionale të RMV, Shkup

⁵⁹ Kuran, Surja Tevbe, ajeti 60.

⁶⁰ Po aty.

traditës dhe riteve fetare myslimane, për çka ishin formuar edhe spitale vakëfore. Këtu të sëmurët shëroheshin falas.⁶¹

Sa i përket traditës dhe riteve fetare lidhur me vakëfet, është me rëndësi të përmendet edhe shembulli i përmbushjes së qëllimeve bamirëse, që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e kafshëve në shtetin Osman. Gjatë përmbushjes së këtij qëllimi, kishte rregulla të veçanta që i dedikoheshin mbrojtjes së kafshëve, më drejtë, se njeriu është i obliguar të kujdeset për kafshët, t'i ushqejë dhe mbrojë ata nga fatkeqësitë, etj. Nëse zbulohej se ndonjë person keqtrajton kafshët, ai dënohej nga kadiu/gjykatësi. Ndarja e ndihmës nga ky lloj i vakëfeve në botën islame konsiderohej si bamërisë e parapëlqyer dhe nuk ishte e rrallë praktika që ushqim vakëfor t'u jepej edhe kafshëve shtëpiake, veçanërisht qenve endacakë, macave, kuajve, zogjve, etj.⁶²

⁶¹ Spitali i parë vakëfor në shtetin osman është ndërtuar në qytetin Bursa nga sulltan Bajezidi I (1389-1402). Begović, Mehmed, *Vakufi u Jugoslaviji*, Beograd 1963 f.38

⁶² *Po aty*, f.36.

KAPITULLI I DYTË

ADMINISTRIMI I VAKËFEVE NË TERITORIN E RMV

2.1 Administrimi i vakëfeve në periudhën Osmane

Vakëfi në sistemin juridik të fesë islame është një institucion legal shtetëror i kursimit. Në këtë akt nuk evidentohen personat të cilët do ta shfrytëzojnë atë vakëf me emra dhe mbiemra, por ai paraqet akt ligjor të njëanshëm. Domethënë vakëflënësi pasurinë e tij e lë në shfrytëzim të grupeve të caktuara shoqërore të cilat do t'i përmbushin karakteristikat e kërkuara në vakëfname. Si rrjedhojë, për themelimin e një vakëfi mjafton vetëm deklarata e vakëflënësit dhe nuk ka nevojë për deklaratë pranuese nga ana e atyre që do të ndihmohen nga pasuria e vakëfit. Pra, krahas asaj që në aktin e themelimit të vakëfit nuk theksohet pala marrëse, teknikisht, vetë nevoja e personave që e shfrytëzojnë atë konsiderohet si pranim i palës së dytë, gjegjësisht, marrësit.

Juristët islam kanë konsensus në lidhje me kushtet e vakëfit dhe ata i kanë përmbledhur në katër kushte:

1. Deklarimi i vullnetit për lënie të vakëfit (siga)
2. Vakëflënësi (Vakif)
3. Pasuria e lënë vakëf (mevkuf)
4. Shfrytëzuesit e vakëfit (mevkuf alejh)

Këtyre kushteve gjithashtu në tekstin e vakëfnames është shtuar edhe klauzula se këta katër kushte kanë karakter të përhershëm dhe nuk janë të përkohshme në kontekst të vakëfit të caktuar.

Administrimi i një vakëfi dhe parimet e matëset për shfrytëzimin e pasurisë së vakëfit përcaktohen sipas vullnetit të vakëflënësit. Deklarata e shkruar ku janë të evidentuara kushtet e administrimit dhe shfrytëzimit të vakëfit është emërtuar si vakëfname (vakfijje). Drejtësia islame kushtet e përmendura në vakëfnamen i konsideron si obligative. Pasuria e vakëfit, në të drejtën islame dhe si pasojë edhe në atë të periudhës osmane, konsiderohet si pronë publike dhe nuk mund të shitet, të dhurohet dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i jepet në pronë dikujt. Përdorimi

dhe dhënia me qira e pronave të vakëfit bëhet në bazë të kushteve të përmednura në vakëfname. Juristët islam e kanë lejuar marrjen e borxhit në emër të vakëfit vetëm në rastet kur është nevojitur meremtimi ose ndërtimi i objekteve shtesë të një vakëfi të caktuar.

Për të realizuar qëllimin e themelimit të vakëfit drejtësia islame rreptësisht ka theksuar se duhet të respektohen kushtet e përmendura në vakëfname, të kihet kujdes të plotë në mbrojtjen e të mirave vakëfore dhe të ardhurat prej pronave vakëfore t'u ndahen atyre që i meritojnë dhe kanë nevojë për to. Këta shërbime dhe punët tjera në lidhje me vakëfit janë administruar nga udhëheqësit/administratorët e vakëfit. Edhe pse nuk është e theksuar në vakëfname por udhëheqësi shtetëror dhe gjykatësit kanë të drejtë që të kontrollojnë dhe të ndjekin punën dhe administrimin e vakëfit.

Në bazë të dispozitave të ligjit fetar islam dhe kushteve të përmendura në vakëfname kompetenca e administrimit të vakëfit emërtohet me termin “velajet”. Në praktikën osmane, kryesisht, është përdorur ky term. Administratori udhëheqës i cili merret me udhëheqjen e vakëfit emërtohet si “Mutevel-li” ose “Nazir”. Mutevel-liu dhe administratorët tjerë të vakëfit kanë qenë të obliguar të kujdesen për vakëfin dhe në asnjë mënyrë nuk kanë pasur të drejtë ta shpronësojnë apo ta dëmtojnë pronën vakëfore. Për shembull, mutevel-liu nuk ka pasur të drejtë që të punësojë dikend në vakëf me çmim më të lartë se çmimi mesatar i punëtorëve në treg as edhe të blejë diçka për vakëfin me çmim më të lartë se ai që është çmim mesatar i tregut. Nëse do ta bënte një gjë të tillë atëherë tepërcën duhej ta paguajë vetë ai.⁶³

2.2 Përmasat sociale dhe fetare në zgjedhjen e administratorëve

Juristët islam janë të mendimit se vakëflënësi është përgjegjës mbi vakëfin dhe ai drejton dhe administron me të gjatë jetës së tij, me çështjet të cilat kanë të bëjnë me vakëfin; për shembull: ndërtimin, meremetimin, qiranë dhe shpërndarjen e dobive të vakëfit palës që i takon ajo dobi. Vakëflënësi ka të drejtë që për mbikëqyrjen e vakëfit të caktojë edhe ndonjë person tjetër. Nëse vakëflënësi vdes e drejta e mbikëqyrjes kalon te personi që vakëflënësi e ka caktuar para vdekjes së tij, e nëse nuk ka caktuar askend atëherë e drejta e mbikëqyrjes i takon gjykatësit i cili kujdeset

⁶³ Për më tepër, shih në: Hüseyin Hatemi, *Türk Hukukunda Vakıf Kurma Muamelesi: Önceki ve Bugünkü*, Stamboll, 1969; ; Ahmet Akgündüz, *İslâm Hukukunda ve Osmanlı Tatbikatında Vakıf Müessesesi*, Ankara 1988.

për çështjet e vakëfit, gjykatësi përkujdesjen ndaj vakëfit mund ta bëjë vetë drejtëpërdrejtë ose duke e caktuar ndonjë zëvendës i cili do të administrojë me vakëfin. Administruesi i vakëfit gjithashtu mund të caktohet edhe në bazë të kushteve që kërkohen për të dhe të cilat janë të përmendura në vakëfnamen.

Administruesi i vakëfit duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të jetë i drejtë sipas parimeve të ligjit fetar islam. Person i drejtë konsiderohet ai që vepron me urdhërat e ligjdhënësit islam dhe largohet nga atao gjëra të cilat i ka ndaluar ligji fetar islam.
2. Aftësia për të administruar me vakëfin. Do të thotë që personi duhet të jetë i moshëritur, i mençur dhe pjekur. Nuk kushtëzohet që administruesi të jetë mashkull, si rrjedhojë edhe femra mund të jetë administratore e vakëfit.

Administruesi i vakëfit ka për detyrë që të kujdeset për çështjet e vakëfit në mënyrë të zakonshme dhe të mos u kundërvihet kushteve të përmendura në vakëfnamen. Ai duhet të veprojë në interes dhe dobi të vakëfit, të ndërtojë, meremetoj, të jep me qira vakëfet, të shpërndajë dobitë e pronës së vakëfit palës që i takon. Nëse administruesi e keqpërdor vakëfin dhe i tradhton të mirat vakëfore atëherë gjykatësi ka të drejtë ta shkarkojë nga posti dhe të caktojë administrues tjetër në vend të tij. Sipas juristëve islam administruesit të vakëfit nuk i lejohet që vakëfin ta jep me qira për kohë të gjatë, vetëm nëse vakëflënësi e ka përmendur një gjë të tillë apo nëse qiraja afatgjate është në dobi dhe interes të vakëfit, pasi kontratat e qirasë afatgjate shpien në humbjen dhe shpronësimin e pronës së vakëfit. Juristët për qiranë e pronave të patundshme, siç janë, dyqanet, shtëpitë, mullinjtë etj. Nuk lejojnë që kontrata për qira e atyre të jetë më tepër se një vit kalendarik. Kurse për tokat bujqësore jo më shumë se tri vite.⁶⁴

2.3 Vakëfnamet si dokumente juridike për administrimin e vakëfeve

Si shembull të administritimit të vakëfit dhe vakëfnames në përgjithësi si dhe në teritorin e RMV-së mund ta përmendim vakëfin e Jahja Pashait në Shkup. Jahja Pashai është prej familjeve luftarake dhe njëri ndër djemtë e Mallkoç Mustafa Beut. Gjatë kohës së Fatih Sulltan Mehmetit

⁶⁴ Özcan, Tahsin "Osmanli Vakif Hukuku Çalismalari", Türkiye Arastirmalari Literatur Dergisi, III/5, Stamboll2005, fq. 513-552.

dhe Bejazidit të II-të në Ballkan ishte si luftëtar në pozitë të komandantit. Mes viteve 1475-1481 ishte princ i Bosnës, kurse mes viteve 1481-1482 dhe 1488-1494 dy herë ishte princ i Rumelisë, pastaj mes viteve 1494-1501 sërish u bë princ i Bosnjës. Pas kësaj kur Jahja Pashai u bë Kryeprinc në Anadoll dhe për herë të tretë u bë Kryeprinc në Rumeli gjatë viteve 1504-1507 ka shërbyer si ministër dhe sipas të gjitha gjasave vdekja e ka gjetur në vitet 1510. Djemtë e dhëndrit Jahja Pashai i cili u martua me vajzën e Bejazidit të II-të, Koxha Bali Pashai dhe Gazi Ahmed Beu shërbyen në pozitë të komandantëve, dhe kryeprincërve⁶⁵. Sado që në gjurmime tregohet si njëri ndër djemtë e Mallkoç Mustafa Beut, Jahja Pashai në dokumentin e përgatitur në vitin 912 Rexheb / 1506 Nëntor, e thekson se emri i tij është Jahja Pasha bin Abdulhaj⁶⁶. Në veprën Sixhilli Osmani të Mehmet Syreja Efendiut, përmendja e dhëndrit Jahja Pashai si i konvertuar dhe i shkolluar në Enderun⁶⁷ pa dhënë ndonjë burim, dhe marrja e kësaj të dhëne për bazë nga disa studiues, është çështje që duhet shikuar me rezervë. Megjithatë qoftë në dokumentin e vitit 1506 edhe atë të vitit 1509, në dokumentin që Jahja Pashai i bëri të tjerët ta përgatisin, derisa flet për detyrën e përkujdesjes ndaj mallrave të vakëfit, e bëri kusht që kjo e drejtë derisa është gjallë të jetë në dorë të tij. Pas vdekjes thotë kjo e drejtë t'i jepet djalit të madh Bali Beut, pastaj Mehmet Çelebiut, pastaj Mustafa Çelebiut, pastaj të tjerëve sikurse janë Ahmetit, Mahmutit, Jusufit dhe Iskenderit⁶⁸.

Prej këtyre vakëfeve, në ditët tona xhamia ende është në këmbë dhe shërben për besimtarët. Por fatkeqësisht imareti, shkolla, hani dhe hamami janë rrënuar dhe janë zhdukur. Tyrbeja që gjendet në kopsht të xhamisë dhe që e ka një pjesë të madhe të saj të shkatërruar, s'dihet se kujt i takon. Gjithashtu nuk kemi informata as për varrin e Jahja Pashait. Edhe pse në dokumentin e tij ka folur shumë për varrin dhe shërbimet që do të bëhen. Gjatë analizave të bëra në dokument,

⁶⁵ Fahamettin Başar, "Malkoçollarët", *DİA*. 27, Ankara 2003, fq.538; F. Basar, "Vendi i familjeve të Akënxhive Osmanë në historinë e Ballkanit", *Kumtesat e Sempoiumit të tretë Ndërkombëtar për Qytetërimin Islam në Ballkan II (Bukuresht, 2006)*, Stamboll 2011, f. 224.

⁶⁶ Arkivi i Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfve (VGMA.) Vakfija e Jahja Pasha bin Abdylhaj, *VGMA*, 629/332, f. 415

⁶⁷ Mehmet Süreyya, *Regjistri Osman*, 5, İstanbul 1996, fq. 1675; Mevlüt Dede, *Vakëfet e Shkupit; Një analizë e historisë sociale*, Instituti i Shkencave Sociale pranë Universitetit Gazi, Teza e Doktoraturës, Ankarë 2015, f. 92.

⁶⁸ "Dhe themeluesi i vakëfit të lartpërmendur ka bërë kusht që të përfaqësojë vakëfin e lartpërmendur vetë deri sa të jetë gjallë. Pas tij përgjegjës të vakëfit përcaktoi djalin e tij, Bali Bej, pastaj djali i tij Mahmet Çelebi, pastaj djali Mustafa Çelebi, pastaj djali Ahmed Çelebi, pastaj djali Mahmud Çelebi, pastaj Jusuf Çelebi, pastaj djali Skender Çelebi.". *VGMA*, 629/332, f. 425, Pjesa e përgjegjësisë së vakëfit në Vakfijen e Jahja Pashait i biri Abdylhajit.

jepen disa të dhëna sipas së cilave tyrbeja e Jahja Pashait duhet të jetë tek imareti i tij⁶⁹. Në po këtë dokument është vënë kusht që përkujdesësi ndaj tyrbes (tyrbedari) të jetë njeri i mirë, kur njerëzit të vijnë të lexojmë pjesë nga Kurani, ta hapin derën e tyrbes, pasi ta kenë kryer punën e tyre, duhet ta pastrojnë tyrben, ta mbyllin derën dhe për këtë të paguhet me nga dy akça. Njëkohësisht sipas të dhënave që gjenden në dokument, prej ushqimit që përgatitet në imaret për tyrbedarin të ndahen nga një pjesë mish, dy bukë, një enë ushqim, dhe gjithashtu ai të shërbehet me ushqimin që përgatitet në netët e mëdha dhe në Ramazan. Meqenëse imareti gjendet në Shkup edhe varri i Jahja Pashait duhet të jetë në po këtë qytet. Përkundër kësaj, s’kemi informata nëse tyrbeja e cila gjendet në kopshtin e xhamisë i përket Jahja Pashait apo jo.

Lidija Kumbaraxhi e cila e komenton tyrben që gjendet në kopshtin e xhamisë Jahja Pashai, duke u thirrur Glissha Elezoviçin, thotë se në atë tyrbe gjendet djali i Jahja Pashait, Mehmet Pashai⁷⁰. Veçse mendohet se për këtë temë duhet të bëhen studime të reja dhe se ka gjasa të mëdha që varri i cili gjendet në kopshtin e xhamisë t’i përkasë Jahja Pashait.

Vakëfnameja që e përgatiti Jahja Pashai për xhaminë, shkollën, kroyin dhe imaretin që i ndërtoi, i përket vitit 912 Rexhep / 1506 muajit Nëntor. Dokumenti me numër 629 i cili është i regjistruar në radhën e 332-të në arkivën e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve, përbëhet nga tetë faqe⁷¹. Ky dokument i cili është i shënuar me numrin 6, thuhet se i përket Gazi Jahja Pasha Bin Abdylhajit. Regjistrimi i 2-të i dokumentit të Jahja Pashait është i regjistruar në Arkivën e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve me numër Y-648-3 dhe ky regjistrim është bërë me shkrim dore. Kjo situatë na bën me dije se ky dokument është shtuar më pas⁷².

Në pjesën hyrëse të këtij dokumenti bëhet me dije se Jahja Pashai xhaminë, imaretin dhe shkollën që e ndërtoi në Shkup, limanin Kadërga në Stamboll si dhe për vakëfet e burimet e tjera që i ka të regjistruara në vende tjera, pas kërkesës së përgjegjësve të vakëfit Mehmet Esad dhe Mustafa

⁶⁹ “Tyrbedar i tyrbes së lartpërmendur të bëhet një person i devotshëm. Ai të hapë dyert e tyrbes për lexuesit e Kur’anit, të ju ndaj mushafat lexueseve, pas leximit t’i mbledhë mushafat dhe t’i vendosë në dollap, të mbyll derën e tyrbes, të pastroj tyrben dhe të përkujdeset për të gjitha nevojat e saj. Paga ditore e tij të jetë dy akçe dhe të hajë në çdo kohë të ushqimit nga një cop mish, dy bukë dhe nga një garuzhdë ushqim të përgatitur në imarethane. Në netët e mëdhaja të hajë ushqime të shijshme”, *VGMA*, 629/332, fq. 422.

⁷⁰ Lidija Kumbaracı – Bogoyevič, *Arkitektura Osmane në Shkup*, Stamboll 2008, fq. 137.

⁷¹ *VGMA*. 629 / 332, fq. 415-422.

⁷² M. Dede, *Vakëfet e Shkupit*, f. 92

Nexhib, u bë rillogaritja e tyre dhe u vërtetua nëse janë të përshtatura me kushtet e vakëfit të juristi Sejjid Osman Efendiu më datë 26 Muharrem 1211 / 1 Gusht 1796⁷³.

Këtij dokumenti që e përgatiti Jahja Pashai më datë 14 Shevval 914 / 5 Shkurt 1509, ia shtoi edhe një aneks. Në këtë aneks janë sjellë sqarime shtesë për pjesën që ka të bëjë sidomos me përgjegjësit, djemtë përgjegjës që i thekson në dokument, ka thënë të jenë sipas moshës duke nisur nga më i rrituri, kurse pas vdekjes së tyre këtë punë ta marrë përsipër ai që vjen në radhë po ashtu sipas moshës.

Sërish në këtë aneks është kërkuar që pjesa e cila tepron prej burimeve materiale të vakëfit, të përdoren në rinovimin e veprave të tyre⁷⁴. Në pjesën hyrëse të dokumentit të Jahja Pashait,⁷⁵ janë dhënë informata për vendet e dhuruara. Sipas kësaj duke i blerë vendet që quhen shtëpitë Bozdogan, ka ndërtuar xhami, imaret dhe vendqëndrimin të mysafirëve, zotërinjëve, dijetarëve, bamiësve ose varfanjakëve, kushdo qofshin, për të cilët u bënë katër dhoma, kuzhinë, furrë, dy hambarë, një bodrum dhe vendi i ngrënies së ushqimit. Krahas këtyre në këtë dokument thuhet se janë bërë dy vende për dijetarët, dy dhoma për shërbëtorët, ahuri për kafshët dhe dy tualete. Kurse në shënime thuhet, se uji i cili gjendet në Saraçpënar, të Sofja që është njëri ndër vendet ku gjendet vakëfi i Jahja Pashait, shpërndahet përmes gypave në vende të ndryshme të qytetit që të pijë populli prej tij.

Duket se institucionet që u sjellin të ardhura vakëfeve të Jahja Pashait, gjenden në Shkup, Stamboll, Sofje, Filibe dhe Niibollu. Vakëfet që gjenden në Shkup, sipas të dhënave të dokumentit janë si vijojnë⁷⁶. Jahja Pashai i dhuroi këto vende; 23 dyqane përreth xhamisë Jahja Pasha, hamamin e ndërtuar nga vet ky njeri, shtëpinë ku do të qëndrojë hamamxhiu, kopshtin e blerë nga Ali Pazarbashë, dyqanet e blera në Çarshinë Bakkallët, shtëpitë e marra nga Hysejin Çelebiu dhe Hamzai, ahrin dhe hambarin, arën ku mbillen drithëra në lagjen Shahinogllu të blerë nga gruaja e njohur si Dilbend Çelebi, shtëpitë e blera nga Haxhi Hysami, dhomat, ahrin, kroin dhe

⁷³ "Janë regjistruar xhamia, imarethania dhe mektepi i të ndjerit Gazi Jahja pashës në Shkup, porta Kadërka në Stamboll dhe të tjerat. Më 29 Muharrem 1211 me urdhëresë dhe me raport të gjykatësit të Stambollit, Sejti Osman Efendia dhe me kërkesën e Mehmet Esadit në praninë e Mustafa Nexhibit dhe administruesit të tjerë të vakëfit është bërë rillogaritja e të ardhurave të vakëfit në përputhshmëri me vakfijen me të cilën punohet". VGMA. 629 / 332, f. 415.

⁷⁴ VGMA. 629 / 333, f. 427.

⁷⁵ VGMA. 629 / 332, f. 417.

⁷⁶ VGMA. 629 / 332, fq. 417-418.

dymbëdhjetë dyqanet që janë të bashkangjitura ndaj këtyre, pesë dyqane peshqish të blera në tregun e peshqve dhe dy shtëpia e dyqanet e tjera që janë pranë tyre, dy mullinjë, hambari dhe kopështi që i kishte blerë në breg të lumit Vardar, dy mullinj në fshatin Lubaniçe që janë pjesë e Shkupit, çifligun që e kishte blerë në fshatin 'Fshati me Shelgje' dhe kopshti, dy shtëpitë që i kishte blerë në Shkup, të gjitha të ardhurat nga fshati Radishan, që ia kishte dhënë Sulltan Bejazidi i II-të dhe tetë dhomat që i kishte blerë përreth vendit të quajtur Kapanhanë.

Kurse sa i përket burimeve që ishin në Sofje gjendja ishte kjo; ⁷⁷ 36 dyqane, dhomat brenda bedestenit të ndërtuar nga Jahja Pashai dhe shtatë dyqane brenda hanit që gjendej pranë bedestenit, shtëpia që e kishte blerë në lagjen Davud Attar në Sofje, shtatë mullinj të blerë në Sofje, një çiflig dhe mulliri pranë Sofjes, 13 dyqane, dy shtëpi dhe një kopësht të blerë në lagjen Pombatë, dyqani i blerë i Peshkatarit dhe tërë hamami i ndërtuar në Sofje u dhuruan për vakëf. Sa i përket burimeve që janë në Plovdiv gjendja është kjo;⁷⁸ të gjitha llojet e të ardhurave të dhëna nga Sulltan Bejazidi i II-të në fshatin Kaljorve, grupin prej katër mullinjsh në Kozlludere dhe dy mullinjë e tjerë, në po të njëjtin lum, çifligu në fshatin Jakupça dhe 455 kafshët që përbëheshin nga delet e kuajtë dhe buallicat që gjendeshin aty, i dha për burime ndaj vakëfeve.

Gjendja e vakëfeve që gjendeshin në Nigbollu është kjo;⁷⁹ 38 dyqane të ndërtuara nga Jahja Pashai në kervansaraj, 11 dyqane dhe një dyqan thertoreje, 23 dyqane në Çarshinë Debbagllar, teqja Ahi Evran për qëndrim të njerëzve të mirë dhe për synetim të njerëzve të kthyer në Islam, 22 dyqane në çarshinë e Peshkatarëve dhe 10 dyqane të tjera përballë limanit, 38 dyqanet në mes të Hisarkapë dhe çarshisë, hambari i kripës dhe bashhani, gjashtë dyqanet e blera dhe ahuri, dhomat e ndryshme dhe dyqanet, çifligu dhe mullinjtë, hamamet dhe mullinjtë e blera në Hërsova, Izdin Çummu dhe Lofça.

Vakëfe që i ka në Stamboll janë këto;⁸⁰ kopshti pranë limanit Kadërگا që ishte pronë e tij, shtëpitë që i kishte blerë nga Hysejin Beu në principatën e Selanikut, hamami që e kishte ndërtuar në Limanin Kadërگا, shtëpia dhe kopështi që e kishte blerë nga gruaja e tij Hadixhe Sulltan, shtëpitë që i kishte blerë pas shkollës që e ndërtoi në Limanin Kadërگا, vendpërgatitja e bozës, thertorja,

⁷⁷ VGMA.629 / 332, fq. 418-419.

⁷⁸ VGMA.629 / 332, fq. 419.

⁷⁹ VGMA.629 / 332, fq. 419.

⁸⁰ VGMA.629 / 332, fq. 419-420.

12 dyqane, 10 shtëpi, 16 dyqanet dhe depot e tyre që i ndërtoi në Unkapanë, toka që e kishte blerë në lagjen Ballat, arat për mbjellje që i kishte blerë në Kozlludere, kopshtet dhe vreshtat, tre mullinjë që i kishte blerë, me të ardhurat e tyre i kishte dhuruar si të hyra për vakëfin e ngritur nga vetë ky.

Vendet për të cilat janë ndarë të ardhurat e vakëfeve

Sipas asaj që bëhet me dije në dokumentin e Jahja Pashait, një pjesë e rëndësishme e të ardhurave të vakëfeve, 200 sikke/monedha janë ndarë për punonjësit e xhamisë së Muhammedit a.s. në Medinë. Si kundërvlerë e tërë kësaj është kërkuar që të lexohet Fatiha për shpirtin e Jahja Pashait ⁸¹.

TABELA 1 :

Të ngarkuarit me punë në Medinë

Haremejn Nazëri/Admistratorë në Mekë e Medinë	10 sikke
Regjent i Medinës	10 sikke
Ligjëruesi në Xhaminë e Pejgamberit	10sikke
Imami i medhhebit Hanefi në Xhaminë e Pejgamberit	10 sikke
Dy myezinët në Ravza-i Mutahhara/Xhamia e Pejgamberit	10 sikke
Punëtorët në Ravza-i Mutahhara/Xhamia e Pejgamberit	20 sikke
Pastruesit në Ravza-i Mutahhara/Xhamia e Pejgamberit	20 sikke
Portierët e Xhamisë së Pejgamberi	5 sikke

⁸¹ “Themelusi i vakëfit të lartpërmendur ka detyruar që kur të mirret nga shpërndarësi paga e caktuar secili të këndoj e nga një elham për shpirt të themelusi të vakëfit dhe të bëjë dua për pranimin e bamirësive të tij. Gjithashtu themelusi i vakëfit të lartërmendur ka detyruar që kur të dërgohen të ardhurat e vakëfeve tjera, dyqind eshrefi (valut ari) për në Mekën e madhërushme dhe Medinën e nderuar, Allahu i nderoftë të mirët dhe të varfërit e tyre, t’i shpërndajnë ato në mënyra të hapur edhe t’i regjistrojnë në regjistër”, VGMA.629 / 332, fq. 421.

Shpenzimet për vaj guri të Xhaminë e Pejgamberit	15 sikke
Bamirësve dhe nevojtarëve në Medinë-i Munevvere	80 sikke
Shërbyesit me ujë në kohën e haxhit për haxhinjtë	10 sikke
Totali	200 sikke

Njëkohësisht është bërë kusht që të mbahet regjistër për shpenzimet e bëra. Pas kësaj pjesa më e madhe e ndarë në vakëf, shihet të jetë përcaktuar për bijtë e tij që janë përgjegjës për vakëf. Një element që tërheq vëmendjen në dokumentin e Jahja Pashait është pjesa e ndarë prej tij për gjashtë vajzat që ai ka ⁸². Sipas kësaj për gjashtë vajzat e Pashait, derisa të jenë gjallë çdo gjashtë muaj duhet t’iu jepen nga 1500 akça, pra që i bie 3000 akça në vit. Veçse është kërkuar që kjo pjesë e ndarë t’iu jepet vetëm vajzave dhe të mos vazhdohet për djemtë pas vdekjes së tyre⁸³. Të ardhurat e vakëfit përveç punëtorëve të vakëfit, janë ndarë për çdo ditë edhe nga tri akça për tepihët e thurrur, kandilat dhe qirinjtë ⁸⁴.

Në dokument në mënyrë të veçantë është theksuar se gjatë netëve të mëdha, gjatë Ramazanit dhe Bajramit të gatohen ushqime të veçanta dhe të shpërndahen për njerëzit përreth. Njëri ndër elementet e dokumentit që e tërheq më së shumti vëmendjen është ndërtimi i shtëpisë diku afër imaretit ku do të qëndronin imami i xhamisë, muezinët, dijetarët, gjellëbërësit, kontribuesit dhe punëtorët e imaretit dhe ndarje e mjeteve materiale për mirëmbajtje të objekteve. Mbajtja e këtij qëndrimi tregon ndjeshmërinë e Jahja Pashait sidomos ndaj punonjësve të vakëfit. Në dokumentin e Jahja Pashait është bërë kusht që çdo vit në Xhumanë e parë të muajit Rebiul Evvel, të këndohet mevlud dhe kënduesit t’i jepen 50 akça ⁸⁵. Kërkohej që kjo praktikë të mos lihet pas dore sepse përkon me ditëlindjen e Muhammedit a.s..

⁸² VGMA.629 / 332, fq. 421.

⁸³ “Themelusi i vakëfit të lartpërmendur ka obliguar çdo vit nga të ardhurat e vakëfeve të lartpërmendura tui dhurohen nga tre mijë akçe dhe sipas llogarisë vjetore çdo gjashtë muaj nga pesë mijë akçe sëcilës prej gjashtë vajzave. Por, ka qenë kusht që nga llogaria vjetore t’iu dhurohet vetëm vajzave biologjike. Pas tyre të mos iu jepet djemve dhe vajzave të tyre”, VGMA.629 / 332, fq. 421.

⁸⁴ VGMA.629 / 332, fq. 424-425.

⁸⁵ Në vakëfname është e regjistruar kështu: “Në xhaminë e lartpërmendur në cdo vit në natën e xhumas së parë të muajit Rebiu’l-evvel të këndohet mevlud dhe të paguhet kënduesi i mevludit me pesdhjetë akçe” VGMA.629 / 332, fq. 425.

Për shkollën që e përbën një pjesë të rëndësishme të vakëfit të themeluar nga Jahja Pashai, në këtë dokument flitet në pjesë të gjerë të saj.

Sa i përket përgjegjësit; detyra e përgjegjësit i cili e përfaqëson vakëfin zyrtarisht dhe para ligjit në dokumentin e përgatitur nga Jahja Pashai më 1506, thuhet se derisa të jetë gjallë do të jetë vet përfaqësues, duke e theksuar këtë çështje në aneksin e datës 1509 ⁸⁶. Pas vdekjes së Jahja Pashait, sipas radhitjes së moshës përgjegjësia dhe përkujdesja ndaj vakëfit është si në vazhdim; djali Bali beu, pas vdekjes së tij Mehmet Çelebiu, pas vdekjes së tij Mustafa Çelebiu, pas vdekjes së tij Ahmet Çelebiu, pas vdekjes së tij Mehmet Çelebiu, pas vdekjes së tij Jusuf Çelebiu dhe pas vdekjes së tij Iskender Çelebiu.

Jahja Pashai, pasi që për përgjegjës i cakton bijtë e tij në një dokument tjetër thotë se, përgjegjësia duhet të shkojë sipas moshës së djemve të tij, madje edhe nëse ndërpritet gjenerata e nipave, djemtë e tyre të jenë përgjegjës sipas moshës. Sipas dokumentit të Jahja Pashait, nëse përfundon gjenerata e djemve të tij, është kërkuar që të ngarkohen me detyrë djemtë e vajzave, apo djemtë e vajzave të djemve, kushdo prej tyre që të jetë i përshtatshëm për këtë detyrë ⁸⁷. Sërish në dokument thuhet se po përfundoi edhe gjenerata e këtyre, është vënë kusht që të ngarkohet me detyrë ndokush që e meriton përfaqësimin. Jahja Pashai në dokumentin e vitit 1506 dhe në aneksin e vitit 1509 të këtij vakëfi, për çështjen e përgjegjësiave jep informata të detajshme, dhe i thekson kushtet e përfaqësimit. Posti i përfaqësuesit që vjen nga loza e tij dhe lihet në përgjegjësi të djemve të tij, në rast të përfundimit të gjeneratës së tyre, me këtë detyrë të ngarkohen djemtë e vajzave të tyre, ose djemtë e vajzave të djemve të tyre, andaj kështu këtë vakëf e bën të përfaqësohet në mënyrë të barabartë mes djemve dhe vajzave. Përkundër kushteve të përmendura në vakëf, kuptohet se kohë pas kohe ka shmangie nga kjo praktikë. Megjithatë në shkresat që dalin nga Arkiva Osmane e shohim se përfaqësuesit i kanë keqpërdorur të ardhurat e vakëfit dhe i kanë transferuar në dobi të tyre. Në gjysmën e dytë të shek. XVI-të mes viteve 1556-1568 gjatë 12 viteve, nuk është rastisur në financat e vakëfit. Përmes urdhërit

⁸⁶VGMA. 629 / 332, s. 421, 425; Por, në aneksin e vakëfit e botuar në vitin 1509 është në këtë mënyrë; “do ta përfaqësoj dhe do të kujdesem për vakëfin në Shkup dhe vakëfet e tjera të mia deri sa të jam gjallë.” VGMA.629 / 333, f. 427.

⁸⁷ Në vakëfname kjo temë është kështu: “Të përfaqësoj vakëfin kush është më i mirë brez pas brezi, nëse nuk mbetet askush nga djali i djalit dhe djali i djalit të djalit atëherë të përfaqësoj më i miri dhe më i merituari nga djemët e vajzave dhe nga djemët e vajzave të djalit brez pas brezi.” VGMA.629 / 332, f. 425; VGMA.629 / 333, f. 427.

që i është shkruar përgjegjësit, në Stamboll u ftua mbajtësi i llogarive për identifikim të orientimit të shpenzimit të mallrave të vakëfit⁸⁸.

Pas mosardhjes së Mehmetit që ishte përgjegjës i vakëfit në Shkup në vitin 1572, nuk është mbajtur kontabiliteti i vakëfit, andaj përmes urdhrit që i është dërguar gjykatësit të Shkupit është kërkuar që të mbahet kontabiliteti, të kryhen pagesat e të ngarkuarve me punë në vakëf dhe Stambolli të informohet për gjendjen⁸⁹. Për shkak të lirimit nga detyrimet të Jahja Pashait në vitin 1577, u dërgua me detyrë në vend tjetër⁹⁰. Në shek. XVII, janë identifikuar të dhëna për nëpunësit e vakëfit. Në vitin 1620 Ibrahim Bin Hysejini për kundërvlerë prej shtatë akça në Xhaminë Jahja Pashai që ngarkuar me detyrë të dijetarit dhe lexuesit të Kuranit⁹¹. Pas vdekjes së administruesit të vakëfit Muslu Ramazanit, pas urdhrit të gjykatësit Mehmetit, me këtë detyrë u ngarkua i biri i tij Abdylkerimi⁹². I ngarkuari me punë Abdullahu, pasi që ndërroi jetë lutësi Abdullahu, me këtë detyrë e ngarkoi Jahjanë në vlerë prej 35 akça⁹³. Në kundërvlerë ditore prej dy akçash, vakëfi i Jahja Pashait ishte nën monitorim të gjykatësit të Shkupit. Mes mbledhësit të pagesave për shpenzime të vakëfit dhe gjykatësit kujdestar Ahmetit kishte pasur problem në fshatin Kalure. Në fshatin e lartpërmendur 55 koptë janë dërguar të banojnë dhe të ardhurat e tyre gjatë kohës së Sulltan Bejazidit të II-të janë caktuar për vakëf. Mbledhësit e tatimit kanë pretenduar se popullata Kopte është bërë pjesë e vakëfit duke thënë; *“Koptët kanë ndërhyrë në punët e vakëfit dhe kjo mund të ndikojë në revoltimin e tyre kundrejt buxhetit...”*. Sa i përket të ardhurave të fshatit ekziston një normë e cila thotë; *“Përgjegjësi e ka fjalën e fundit për tatimin...”* Meqë është menduar se përgjegjësi s’do të jetë në nivel të detyrës gjatë mbledhjes së tatimit, andaj është marrë vendim që të mblidhet vetëm nga një njeri nga të ardhurat e tatimit mes viteve 1645-1655 për përgjegjësin e vakëfit çdo vit janë ndarë nga 10.000 akça.

Veçse s’është zgjidhur problemi sepse gjykatësi Ahmeti kishte thënë se sasia e përcaktuar nuk i

⁸⁸ Myhimme Defteri Numër 7 (975-976/1567-1569) *Përmbajtja-Transkripcioni-Indeksi*, Botimet e Arkivit Osman të Kryeministrit, Ankara 1998, fq.561-562.

⁸⁹ “...Mehmeti, i cili ka qenë ish-administrues dhe myderris i imarethanes së Jahja Pashës, për shkak të mos ardhjes në qytet që gjashtë muaj e më shumë nuk i ka bërë llogaritjet...”, BOA. KK.d.67, 20 Cemaziye’l-evvel 980/28 Shtator 1572, fq. 529.

⁹⁰ BOA. A.RSK.d.1461, fq.9.

⁹¹ BOA. D.KEV.d.22388, 10 Cemaziye’l-evvel 1029/13 Prill 1620, f.59.

⁹² BOA. KK.d.217, 8 Cemaziye’l-evvel 1071/9 Janar 1661, f.108.

⁹³ BOA. A.RSK.d.1543, 28 Muharrem 1087/12 Prill 1676, f.16.

ishite ndarë vakëfit dhe vakëfi kishte pasur probleme materiale. Të ardhurat e ndara nga tatimi janë përcaktuar si të ardhura për vakëfin dhe vendbanimet e mbetura është vendosur që tatimet t'i paguajnë për shtetin. Mbledhësit e tatimit gjatë viteve 1678-1679 kanë kundërshtuar në formën; “këto duhet të jenë specifikisht për ne...” dhe pas kësaj është urdhëruar që kryeadministratori i buxhetit çdo vit të paguhet me nga 10.000 akça. Sikurse shihet ka pasur probleme mes kadiut dhe mbledhësve të tatimit, shteti e merr parasysh mendimin e gjykatësit, veçse problemi ka vazhduar të ekzistojë për vite të tëra.

2.4 Administrimi i vakëfeve në periudhën e Mbretërisë Jugosllave

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore dhe krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, u formuan dy organizata të komunitetit mysliman: Bashkësia Fetare Islame e Bosnjës e Hercegovinës, e cila pati një autonomi të plotë që mbartej nga Kushtetuta e sjell që nga koha e Perandorisë së Austro-Hungaresë. Qendra e saj ishte në Sarajevë ndërsa në të udhëhiqte Reis-ul-Ulemaja; dhe, Myftinia Supreme, në kuadër të së cilës përfshihej komuniteti mysliman i Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Sanxhakut. Qendra e saj ishte Beogradi ndërsa në të udhëhiqte kryemyftiu, i cili njihej si myftiu suprem. Për dallim nga BFI-ja e Bosnjës e Hercegovinës, Myftinia Supreme, ishte nën varësi të plotë të Qeverisë së SKS-së, përkatësisht të Ministrisë për Fe. Veprimtaria e saj mbështetej mbi një Rregullore të miratuar gjatë vitit 1919, e cila në vitin 1920 kaloi në Ligj. Sipas dispozitave të asaj rregulloreje, i tërë pushteti ishte përqëndruar te kryemyftiu, dhe myftitë e qarqeve e të rretheve të cilët emëroheshin nga ana e ministrit për Fe. Në krye të këtyre institucioneve u emëruan njerëz më të besuar të pushtetit, siç ishin Hasan Rebac, udhëheqës i Dhomës Myslimane⁹⁴ e cila funksiononte në kuadër të ministrisë, Mehmet Zeki, kryemyfti dhe Mustafa Kulenoviç sekretar i Ministrisë Supreme⁹⁵, Talat Selim, myfti i Myftinisë së Qarkut në Manastir, Xh. H. Mejliq, myfti i Myftinisë së Qarkut të Shkupit, Ali Riza, myfti i Myftinisë së Qarkut të Ohrit etj.⁹⁶. Se vërtetë e tërë hierarkia udhëheqëse e saj ishte nën

⁹⁴ Државен Архив на Република Македонија, фонд Улема Меџлис во Скопје, кутија 23, документи 91-96, листови 378-414 (në tekstin e mëtutjeshëm: ДАРМ. 1. 609. 2. 38/51.

⁹⁵ ДАРМ. 1. 611. 1. 1/1-7.

⁹⁶ ДАРМ. 1. 611. 1. 4/10-11.

mbikqyrje të plotë të pushtetit, dëshmon shkresa e Hasan Rebacit, dërguar më 23 mars 1920 kryemiftiut, Mehmet Zeki, përmbajtja e së cilës ishte si vijon: “Jam informuar se, myftiu i Qarkut të Ohrit z. Hajredin Ahmeti dhe myftiu i rrethit të Dibrës z. Hysni Aliu koketojnë me shqiptarët dhe punojnë kundër shtetit tonë, ata janë njerëz shumë të rrezikshëm, prandaj në interes të shtetit duhet sa më parë të ndërrohen nga ato pozita. Në informatën e njëjtë përmendet edhe një farë Hafiz Sherifi (Sherif Langu një atdhetar dhe udhëheqës i spikatur fetar i cili në vitin 1938 u zgjodh kryetar i Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, ndërsa nga viti 1942 kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Më vonë, përkatësisht pas vitit 1945 u burgos nga pushteti komunist i Enver Hoxhës si “armik i popullit dhe shtetit”) si ndihmës myftiu gjithashtu si një figurë e rrezikshme për shtetin tonë.”⁹⁷. Për rrjedhojë, erdhi deri te ndërrimi i menjëhershëm, ku në vend të Hajredin Ahmetit, për myfti të Ohrit u emërua Ali Riza, ndërsa Hafiz Mahmudi e zëvendësoi myftiun e mëparshëm të Dibrës, Hysni Aliun⁹⁸. Në kuadër të fushatës së luftës kundër krerëve fetarë me vetëdije të qartë kombëtare, duhet përmendur edhe shkresa e 27 marsit të atij viti të Hasan Rebacit, përmes së cilës e urdhëronte kryemiftiun, Mehmet Zeki, që të ndërmarrë masa kundër disa hoxhallarëve në Kosovë e Maqedoni, për shkak se nga njoftimet që i kishin arritur nga ana e Ministrisë së Luftës, në këto krahina “në mesin e muhamedanëve po vërehet një farë lëvizje me qëllim të autonomisë politike e fetare”, dhe se në to “po marrin pjesë edhe hoxhallarët, duke mbajtur fjalime të fshehta nëpër xhami...”⁹⁹.

Nga sa u tha më sipër lirisht mund të themi se e tërë struktura udhëheqëse, përfshi këtu edhe myftitë e qarqeve e të rretheve përbënin elementin më të besueshëm të pushtetit dhe si të tillë atyre, krahas organizimit fetar u qe besuar edhe menaxhimi, përkatësisht administrimi i pasurisë vakëfnore. Këtë e shohim në shkresën me nr. 2397 të datës 16 qershor 1922, të Ministrisë për Fe dërguar asaj për Punë të Brendshme, ku thuhej shprehimisht: “Në kufijtë e Serbisë, Serbisë Jugore e Malit të Zi ka shumë prona vakëfnore, të cilat janë dhënë nga njerëz besimtar, që nga të ardhurat e tyre të mirëmbahen xhamitë, medresetë dhe shkollat e tjera fetare dhe nëpunësit e tyre si dhe për t’iu ndihmuar të varfërve. Për administrimin e këtyre pronave vakëfnore, në vitin 1919 është sjellë edhe rregullore e përkohshme për Administrimin e Vakëfit në Mbretërinë

⁹⁷ ДАРМ. 1. 609. 1. 101/160-161.

⁹⁸ По аты.

⁹⁹ ДАРМ. 1. 609. 1. 7/20-21.

Serbo-Kroate-Slllovene përveç Bosnjës e Hercegovinës, e cila Rregullore tashti ka kaluar edhe në ligj. Mbi bazën e kësaj Rregullore për çdo qark ku ka vakëfe, janë zgjedhur këshilla vakëfnore të qarkut, kryetar të të cilëve janë myftitë vendor, të cilët administrojnë me vakëfet mbi bazën e Rregullores së mësipërme dhe sipas udhëzimeve të Ministrisë për Fe”¹⁰⁰.

Mënyra e këtillë e organizimit fetar, ku tërë pushteti u përqendrua në disa njerëz të caktuar, vegla të pushtetit, solli deri te rrëmbimi dhe plaçkitja e pakontrrolluar e pronës vakëfnore. Dokumentet e kohës hedhin dritë se gjatë periudhës kohore tetor 1918 - maj 1925, shumë objekte vakëfnore: si xhami, hane, medrese, dyqane, tokë bujqësore, pyje etj., qenë rrëmbyer nga ana e njësive ushtarake, policore si dhe nga zyrtarë e nëpunës të ndryshëm civilë serbë të cilët pushteti qendror në Beograd i kishte dërguar në tokat e pushtuara shqiptare të udhëheqin me pushtetin lokal.

Më 11 maj të vitit 1922, këshilli i Vakëfit të teqesë Arabati në Tetovë, njoftonte Ministrinë për Fe në Beograd, se kolonistët malazez në fshatin Bërvenicë, rrethina e Tetovës, e kanë konfiskuar “tërë tokën në çiflikun e teqesë Arabati” e cila shtrihet në distriktin e këtij fshati dhe se pas kërcënimeve mirëmbajtësit e çiflikut janë detyruar të ikin, ndërsa “ndërhyrjet tona ndaj teqesë ngelën pa asnjë veprim nga pushteti”. “Duke ua dorëzuar të mësipërmen – thuhej në fund të njoftimit - nuk marrim asnjë përgjegjësi për udhëheqjen e punës së kësaj teqeje dhe nga dita e sotme i ndëpresim të gjitha punët mbi drejtimin e vakëfit të njëjtë”¹⁰¹. Kjo ngjarje e shëmtuar, e detyroi myftiun e Tetovës, Nebi Mahmut, t’i shkruaj një letër Myftinisë Supreme, ku ia bënte me dije se pronësia vakëfnore e “Teqesë Arabati”, ishte rreth 1.000 hektarë tokë pjellore, që shtrihej në distriktin e fshatit Bërvenicë, dhe se nga kjo tokë “gjatë kohës së udhëheqjes së ish muteveliut $\frac{3}{4}$ e ka marrë agrari dhe ua ka shpërnda fshatarëve”¹⁰². Rrëmbime të pronësisë vakëfnore pati edhe në qendrat e tjera, siç ishte rasti me vakëfet e shumta e të pasura të Shkupit, si p.sh. vakëfet e Mustafa Pashës¹⁰³, Ibni Pajkos¹⁰⁴, Isa Beut, Faik Pashës¹⁰⁵, Sulltan Muratit etj¹⁰⁶, vakëfi i haxhi

¹⁰⁰ ДАРМ-оделение Скопје, 6. 1. 15. 55/276.

¹⁰¹ ДАРМ. 1. 609. 2. 59/72-74.

¹⁰² По аты.

¹⁰³ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941, po aty.

¹⁰⁴ ДАРМ-оделение Скопје, 6. 1. 16. 77/334-64.

¹⁰⁵ По аты. 105/632-656.

¹⁰⁶ По аты, 106/657-672.

Sulejmanit në Manastir¹⁰⁷. Pastaj rrëmbimi i tri xhamive të njohura në Ohër: “Haxhi Kasami”, “Imaret” dhe “Durgut” nga ana e Kishës Ortodokse serbe të këtij qarku¹⁰⁸ e shumë vakëfe të tjera. Tërë kjo binte ndesh me Marrëveshjen e “Shën Gjermenit”, të cilën Qeveria e SKS-së e kishte nënshkruar më 10 shtator të vitit 1919. Në nenin 10 të Marrëveshjes thuhej: “Qeveria e SKS-së detyrohet të lejojë mbrojtje të plotë të xhamive myslimane, të gjitha lehtësimet dhe lejet, të pronës fetare (Vakëfit) ose organizatave bamirëse myslimane që ekzistojnë. Qeveria e SKS-së nuk do të refuzojë asnjë nevojë për lehtësimin e krijimit të organizatave fetare dhe bamirëse të cilat janë të siguruara me organizatat të atij lloji”¹⁰⁹.

Reagimet dhe pakënaqësitë e shumta të popullsisë shqiptare-myslimane, e detyruan ministrin për Fe, t’i shkruajë ministrit për Punë të Brendshme, në të cilën vinte në dukje se organet të caktuara me kompetencë shtetërore “pronat vakëfnore i konsiderojnë si pasuri pa zotërues ose si pasuri të ish Mbretërisë Osmane, prandaj shpesh herë vërsulen ndaj pasurisë vakëfnore për t’i përvetësuar”, gjatë së cilës çështjet fare nuk i konsultojnë te kompetentët, e ato janë këshillat e vakëfeve vendore. “Për sa më sipër – thuhej më tej në shkresë - kam nderin të Ju lusi Juve zoti ministër, që t’i njoftoni organet tuaja të nënshtruara dhe t’i urdhëroni që të kenë më shumë kujdes për këtë çështje që të shmanget çdo formë e grabitjes me forcë të pasurisë vakëfnore, të cilësdo formë qoftë kjo të jenë varreza myslimane, xhami, medrese, ndërtesa, dyqane, ara, livadhe e kështu me radhë...”¹¹⁰.

Kjo shkresë jo që nuk solli ndonjë normalizim të situatës, përkundrazi, e njëjta u përkeqësua edhe më shumë pas sjelljes së Planit Rregullues për Qytetin e Shkupit, i cili qe miratuar nga ministri i Ndërtimatarisë me vendimin nr. 36994 të datës 30 nëntor 1922¹¹¹, me të cilin, ishte paraparë rrënimi i xhamisë “Burmali” që ndryshe njihej si “Bukuroshja e Shkupit” që gjendej në anën e djathtë të Vardarit, përkatësisht në sheshin e qytetit. Realizimi i këtij plani filloi më 6 qershor të vitit 1924, kur Gjyqi Komunal i Shkupit, me shkresën nr. 18245, njoftonte Myftininë e Shkupit, se një hap i tillë duhej të ndërmerrej “për shkak zbukurimit të asaj pjese të qytetit”, dhe “për shkak se një pjesë të atij trualli, i cili ishte pjesë përbërëse e oborrit të xhamisë, të ndërtohej objekt

¹⁰⁷ Po aty, 107/673, 694.

¹⁰⁸ ДАРМ. 1. 611. 1. 45/94-95.

¹⁰⁹ ДАРМ. 1. 613. 1. 2/56-59.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ ДАРМ-отделение Скопје, 6. 1. 34. 43/821.

monumental Shtëpia e Armatës”. Nisur nga kjo: “Gjyqi ka nderin ta lusë Myftininë e Qarkut, për një përgjigje urgjente, se në cilën mënyrë kuptohet miqësore, mundet dhe dëshiron që këtë truall, për të cilin Gjyqi ka të drejtë sipas dispozitave ligjore ta marrë dhe t’ia dorëzojë komunës”. “Lënda është urgjente dhe nuk duron shtyrje – thuhej në shkresë – sepse duhet menjëherë të kryhet, ndërsa Myftynisë i ka ngel tre ditë afat për t’u përgjigjur, pas të cilit afat Komuna do të shfrytëzohet me të drejtën që ia mundëson neni 3 pika 1 dhe 2 nga Ligji për marrjen e pronësisë së patundur private për nevojat e përgjithshme popullore”¹¹². Në përgjigjen e Myftinisë së Qarkut të Shkupt thuhej: “Në lidhje me shkresën e Gjyqit të Komunës nga 6 qershori 1924 nr. 18245 në lidhje me ekspropriimin dhe rrënimin e xhamisë “Burmali” në Shkup, kam nderin t’u njoftoj se kjo myftini ftoi këshillin e vakëfit dhe mexhlisin e xhematit, të cilët kanë ngelë në pikëpamjen, se kjo xhami nuk parqet pronë private, por pronë shoqërore, e cila shërben për qëllime fetare dhe se mendimi i opinionit publik të qytetarëve të fesë myslimane nuk pranojnë që në asnjë mënyrë kjo xhami të rrënohet”¹¹³. Një ditë më vonë, Gjyqi i Komunës së Shkupit, solli vendim me të cilin lejohej rrënimi i xhamisë, ku thuhej se nëse këtë refuzon ta bëjë Myftinia, në atë rast “ajo do të kryhet nga vetë komuna”¹¹⁴. Menjëherë pas kësaj, u bë rrënimi i dhunshëm i xhamisë, një akt i cili revoltoi tej mase popullsinë myslimane të këtij qyteti e më gjerë. Lidhur me këtë akt arbitrar e tejet të shëmtuar, në Promemorien e sipërpërmendur të klerit katolik shqiptar të Kosovës thuhej: “....Ka qenë shpronësuar xhamia e madhe ‘Burmali’ të qytetit të Shkupit pa pëlqimin e komunës dhe pa as çfarë dëmshpërblimi. Në vendin e saj është ndërtuar Shtëpia e Armatës. Ka mundësi që pëlqimi të jetë dhënë nën kërcënimin e gjeneral Terziçit, i cili lidhur me këtë që më parë e kishte shprehur mendimin e tij: ose një milion dinarë, ose dy bomba që të ngrihet xhamia në ajër...”¹¹⁵.

Në fillim të vitit 1925, ministri për Fe, formoi një komision anketues, me detyrë të hartojë një projekt për “zgjidhjen” e problemit të administrimit të pronës vakëfnore. Kryetar i komisionit u emërua kryemiftiu Mehmet Zeki, ndërsa për anëtarë: Talat Selim, myfti i Myftinisë së Qarkut të Manastirit, Ali Riza, myfti i Myftinisë së Qarkut të Ohrit, M. Alija, myfti i Myftinisë së Rashkës, D,

¹¹² ДАРМ-оделение Скопје, 6. 1. 34. 12/387.

¹¹³ ДАРМ-оделение Скопје, 6. 1. 34. 43/820.

¹¹⁴ ДАРМ. 6. 1. 34. 43/822, Пов. Бр. 19741, 19 јуна 1924 год., Скопљу.

¹¹⁵ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941, po aty.

Sheqerkadiq, myfti i Myftinisë së Sjenicës, Xh. H. Mejliq, myfti i Myftinisë së Qarkut të Shkupit dhe Sejfi Sheqerkadiq, anëtar i Myftinisë Supreme. Komisioni, me përbërje të plotë, më 25 mars të vitit 1925 u mbledh në Shkup, me ç'rast hartoi projektin e kërkuar, i cili përbëhej prej dhjetë pikave:

“1. Pronësia vakëfnore në Serbinë Jugore (Kosovë e Maqedoni) dhe Sanxhak madje edhe në qoftë se është përvetësuar të bashkohet dhe t’u dorëzohet këshillave vakëfnor vendor.

2. Në çdo Këshilli Vakëfnor të rrethit të emërohet një drejtues vakëfnor i cili do ta kryente edhe detyrën e arkëtarit.

3. Këshillat Vakëfnor të rrethit zgjidhen në atë mënyrë, çdo mëhallë (lagje) deri më 200 shtëpi të zgjedhë nga një delegat, ndërsa mbi 200 shtëpi dy delegatë. Gjithashtu edhe secili fshat që zotëron pronësi vakëfnore zgjedh nga një delegat. Para këtyre delegatëve të zgjedhur secila mëhallë përkatësisht fshat do të delegojë edhe delegatin e dytë përkatsisht të tretin dhe imamin shtetëror të mëhallës (fshatit) përkatëse. Këta delegatë në marrëveshje me myftiun vendor do ta zgjedhin këshillin e vakëfit. Mandati i këshillit të vakëfit zgjatë tre vjet.

4. Buxheti i të hyrave e të dalave si dhe llogaritë përfundimtare vjetore t’i dorëzohen paraprakisht Myftinisë Supreme për propozim dhe vlerësim e cila më pas do ia dorëzojë Ministrisë për Fe për miratim me vërejtjet eventuale.

5. Pranë Myftinisë Supreme të emërohet një inspektor vakëfnor dhe një daktilograf, detyra e të cilit do të jetë të udhëheqë me korrespondencat e tërësishme me këshillat vakëfnor të rretheve dhe në rast nevojë të kryej inspektimin e pasurisë vakëfnore.

6. Kryemyftiut si drejtor i përgjithshëm i të gjitha vakëfeve në Serbinë e Jugut dhe të Sanxhakut, nën mbykqyerjen e të cilit do të jetë edhe inspektorati vakëfnor t’i paguhet 60.000 dinarë në vjet në emër të shpenzimeve dhe reprezentacionit.

7. Mytevelive të vakëfeve evlevijet (trashëguese) të cilët e dëshmojnë me dokumentin e vërtetë, përkatësisht fermanin, vakëfnamen, beratin e kështu me radhë se janë trashëgimtarët e vërtetë të krijuesve të pronave vakëfnore me të cilat udhëheqin, këshilli vakëfnor të caktojë një shumë të caktuar në emër të mirëmbajtjes, në përputhje me dispozitat e vakëfeve.

8. Përqidja e paraparë në disa vakëfname për kadi përkatësisht myfti t’i paguhet myftiut vendor si mbykqyrës i vakëfit përkatës.

9. Atyre nëpunësve të vakëfeve të cilët sipas dispozitave të vakëfnameve grumbullojnë frytet nga pasuria vakëfnore, këshilli i vakëfit t'iu caktojë rrogë sipas detyrës që e kryejnë dhe sipas dispozitave të vakëfnameve.

10. Të gjitha varrezat myslimane si shkëlqimi më i lartë mysliman do të konsiderohen si pronësi vakëfnore që në të vërtetë edhe janë¹¹⁶.

Nga ky projekt, i cili më pas kaloi në Rregullore për administrimin dhe menaxhimin e pronës vakëfnore, shihet qartë se më së paku dobi kishin institucionet e Bashkësisë Fetare Islame, siç ishin xhamitë, mesxhidet, teqetë, medresetë, mektepet, organizatat bamirëse fetare etj, për të cilët nuk parshihej asçfarë ndihme financiare nga të ardhurat vjetore të vakëfeve, përkundër faktit se qëllimi kryesorë i themeluesve të këtyre vakëfeve, ka qenë pikërisht mirëmbajtja e këtyre institucioneve, për çka dëshmojnë vakëfnamet e shumta të cilat gjenden në Arkivin e Maqedonisë. Përkundrazi, nga kjo përfitonin vetëm krerët më të lartë të kësaj organizate, në radhë të parë kryemiftiu, të cilit sipas pikës 6 të projektit, i takonin 60.000 dinarë në vjet (që kjo nënkuptonte 60 rroga të nëpunësve), por edhe myftitë e qarqeve e të rretheve, ndërsa një pjesë e vogël e këtyre mjeteve ishin paraparë për pagat mujore të një numri të vogël të nëpunësve vakëfnor.

Ndërkohë, kryemyftiu Mehmet Zeki, solli një vendim, me të cilin urdhëroheshin myftitë e qarqeve e të rretheve që brenda një afati prej katër muajve t'i shesin të gjitha pronat vakëfnore, ku popullsia myslimane ishte shpërngulur në tërësi, si dhe objektet vakëfnore që nuk ofrojnë asçfarë të hyrash. Ja se çfarë thuhej në atë vendim:

“Në viset ku myslimanët janë shpërngulur tërësisht, ndërsa që të mund të shpëtohen vakëfet dhe të shërbejnë edhe më tej për të mirën e bashkësisë myslimane, të gjitha pronat vakëfnore, të shiten përmes shpalljes publike më së voni katër muaj nga pranimi i këtij vendimi; parat që do të merren nga shitja e këtyre vakëfeve do të shfrytëzohen për blerjen e një pallati vakëfnor qoftë në Shkup apo Beograd;

¹¹⁶ ДАРМ. 1. 611. 1. 4/10-11.

Të futen në shitje në një ankand të gjitha objektet vakëfnore të cilët nuk sjellin asçfarë të hyrash ose nuk shfrytëzohen për asnjë qëllim, edhe atë më së voni tre muaj nga pranimit i këtij vendimi”¹¹⁷.

Një vendim i tillë ngeli në fuqi deri në mars të vitit 1936, kur udhëheqja e përkohshme e BFI-së, e cila erdhi si rrjedhojë e Kushtetutës së re të kësaj bashkësie fetare, solli një Rregullore, e cila siç thuhej pati peshë ligjore. Në nenin 6 paragrafi 6 të saj thuhej: “Pronësia vakëfnore dhe të gjitha të mirat dhe institucionet e tjera të Bashkësisë Fetare Islame ngelin nën pronësi të saj, edhe atëherë në qoftëse popullsia për të cilën shërben ajo pasuri ato të mira dhe institucione, do të kalonte në ndonjë fe tjetër ose nëse do të shpërngulej.”¹¹⁸.

Ndërkohë, Dhoma Myslimane pranë Ministrisë për Fe, më 9 nëntor 1928 i shkruante Myftinisë Supreme, që të ndërmarrë masa urgjente për rregullimin e problemit të vakëfeve të evladijetit (vakëfe me administrim të trashëguar). “Mutevelitë e atyre vakëfeve – thuhej në shkresë – edhe pse janë të detyruar me nenin 6 të rregullores të japin llogari dhe t’i përmbushin detyrimet e testamenteve vakëfnore këtë jo që nuk e bëjnë, por përkundrazi, për këtë çështje është kryer një kaos. Ajo pasuri vakëfnore shpenzohet për tërë atë që nuk është paraparë, aq më tepër shumë muteveli i tejkalojnë të gjitha kufijtë e të lejuarës, i përvetësojnë disa objekte vakëfnore e më pas i shesin dhe parat i shpenzojnë për qëllimet e tyre”¹¹⁹.

Për rrjedhojë, Kryemyftiu, më 26 dhjetor 1928, solli Vendim të Sheriatit, përmes së cilit urdhëroheshin myftitë e qarqeve, të marrin masa urgjente edhe :

“1. T’i ftojnë të gjithë mutevelitë nga territori i tyre të cilët udhëheqin me pronën vakëfnore, që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi të raportojnë, ndërsa ata që nuk do ta bëjnë këtë me vendim të menjëhershëm të largohen dhe të emërohen zëvendësit e tyre, përderisa nuk kryhet inspektimi i llogaridhënies.

2. Të ftohen të gjithë mutevelitë, që përmes dispozitave dhe mënyrës së Sheriatit, të dëshmojnë të drejtën e tyre për pozitën e mutevelit, ndërsa ata të cilët nuk kanë mundësi ta dëshmojnë të

¹¹⁷ ДАРМ. 1. 611. 1. 13/27-28.

¹¹⁸ АЈ. Фонд. 63, фасц. Бр. 134, УРЕДБУ са законском снагом.

¹¹⁹ ДАРМ. 1. 609. 4. 142/157-158.

eliminohen me Vendim të Sheriatit, ndërsa udhëheqja me vakëfin përkatës t'i besohet këshillit të vakëfit..."¹²⁰.

Për rrjedhojë, puna erdhi deri te shkarkimi i dhunshëm i një numri të madh të administratorëve të ligjshëm të vakëfeve, që ligjshmërinë e zotëron si pasardhës të themeluesve të atyre vakëfeve dhe në vend të tyre nga ana e myftive u emëruan këshilla të vakëfeve, anëtarët e të cilave i shërbenin me përkushtim politikës antimyslimane dhe antishqiptare, që drejtohej nga Beogradi. Gjatë vitit 1930, u krye bashkimi i BFI-së në Mbretërinë Jugosllave, përkatësisht nga dy organizata sa ekzistonin deri në atë periudhë u krijua një udhëheqje e përbashkët, që ndryshe quhej Udhëheqja Supreme e BFI-së, selia e së cilës kaloi në Beograd. Në kuadër të saj u formuan dy mexhlise të ulemasë me të drejta dhe kompetenca të barabarta: Mexhlisi i Ulemasë së Shkupit dhe Mexhlisi i Ulemasë së Sarajevës, që përbëheshin prej tre anëtarëve. Udhëheqjen Supreme e përfaqësonte Reis-ul-Ulemaja, ndërsa Mexhlisin e Ulemasë kryetari. Zgjedhja e Reis-ul-Ulemasë kryhej nga Bordi të cilin e përbënin: të gjithë anëtarët e Mexhlsit të Ulemasë në Sarajevë dhe Shkup; të gjithë myftitë; të gjithë anëtarët e Gjyqit Suprem të Sherijatit, Gjimnazit të Sherijatit në Sarajevë dhe Medresesë së Madhe Kral Aleksandri i I në Shkup; referenti i Fesë Islame pranë Ministrisë së Ushtrisë dhe Marinës; ministrat aktivë¹²¹. Edhe zgjedhja e anëtarve të Ulema Mexhlsit ishte e njëjta, përkatësisht nga Bordi i cili përbëhej prej: Reis-ul-Ulemaja; anëtarët e Mexhlsit të Ulemasë për të cilin zgjidhet anëtari, myftitë nga territori e Mexhlsit të Ulemasë për të cilin zgjidhet anëtari; anëtarët e Gjyqit Suprem të Sherijatit në territorin e të cilit është selia e Mexhlsit të Ulemasë për të cilin zgjidhet anëtari¹²². Në kuadër të Mexhlsit të Shkupit funksiononin Kuvendi Mearif i Vakëfit, i cili për detyrë pati ta mbikëqyrë tërë pasurinë e tundshme dhe të patundshme brenda territorit të vet, zgjedhja e të cilit ishte e njëjta sikurse edhe ata të dy institucioneve të mëlarta. Në kuadër të Kuvendit Mearif të Vakëfit emërohej Drejtori i Vakëfit si dhe Këshilli Drejtues i Kuvendit Mearif të Vakëfit. Emërimi i tyre bëhej nga ana e pushtetit edhe atë nga vetë ministri i Drejtësisë. Ndërsa Këshilli Drejtues bënte emërimin e anëtarëve të këtij organi nëpër rrethe¹²³.

¹²⁰ ДАРМ. 1. 609. 4. 159/183-184.

¹²¹ ДАРМ. 1. 613. 1. 4/59-66, Закон о избору Реис-ул-Улема, чланова Улема-меџлиса и Муфтија Исламске верске заједнице Краљевине Југославији, нени 2 i Ligjit.

¹²² По ату, нени 3.

¹²³ ДАРМ.Ф. Вакуфко Меаривски Сабор, К.1 Док.1, стр. 1-11 (мë tej ДАРМ.1..954.1.1/1-11)

Një mënyrë e tillë e funksionimit të BFI-së, i garantonte pushtetit serbomadhi që përmes këtij institucioni edhe më tej ta mbajë nën kontroll të plotë tërë popullsinë myslimane, në radhë të parë atë shqiptare. Burimet arkivore ofrojnë të dhëna të thukta për keqpërdorimet e shumta që struktura udhëheqëse e kësaj organizate në Shkup kryente ndaj pasurisë vakëfnore. Sa për ilustrim po i referohem proceverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup, punimet e së cilës u zhvilluan më 30 maj 1933, ku është diskutuar për projekt-buxhetin e vitit 1933/34 ku thuhet se të hyrat nga pasuria vakëfnore vitin e kaluar kanë rënë 50%, në krahasim me një vit më parë. Si shembull merren të hyrat e vakëfeve të Shkupit, që gjatë vitit buxhetor 1932/33 kishin arritë shumën prej 1.200.000 dinarë, ndërsa një vit më vonë, përkatësisht në vitin 1933/34 kishin ra në 374.000 dinarë¹²⁴.

Në fillim të vitit 1935, ndodhën trazira të shumta brenda organeve të Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, të cilat erdhën si rrjedhojë e kërkesave të vazhdueshme të krahut opozitar shqiptar, që në këtë bashkësi të udhëheqin vendorët, përkatësisht shqiptarët, e jo klika serbomadhe e instaluar nga Bosnja e Hercegovina. Në anën tjetër edhe shumica dërrmuese e popullsisë boshnjake-myslimane ishte e pakënaqur me politikën e organeve të atëhershme supreme të BFI-së. Me emrimin e kryetarit të "Organizatës së Myslimanëve të Jugosllavisë", Mehmet Spaho, qeveria e Stojadinoviqit, pranoi të bëhen ndryshime rrënjësore në organizimin e brendshëm të kësaj Bashkësie Fetare. Ndër pikat kryesore të marrëveshjes midis Spahos dhe Stojadinoviqit ishin: miratimi i Kushtetutës së re, kalimi i selisë së Reis-ul-Ulemasë nga Beogradi në Sarajevë, hapja e një medreseje në Shkup (Medreseja Gazi Isa Beu) dhe organizimi i zgjedhjeve të lira¹²⁵.

Pas këtyre kërkesave qëndronte edhe opozita shqiptare e Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, e cila autorizoi Ferhat bej Dragën, që të mbajë lidhje me Spahon. Për rrjedhojë, më 25 mars të vitit 1936, organet supreme të BFI-së, sollën Kushtetutën e re e cila hyri në fuqi me 5 nëntor të atij viti, pasi u publikua në gazetën zyrtare¹²⁶. Kushtetuta e re e BFI-së, u garantonte autonomi të plotë organeve të kësaj bashkësie, përfshi edhe menaxhimin me pronën vakëfnore. Kjo vinte në

¹²⁴ ДАРМ. 1. 954, Записник десете седнице Вакуфске-меарифског Већа у Скопљу одржане дне 30 маја 1933 године.

¹²⁵ Lita Qerim, Zgjedhjet e vitit 1937 konform Kushtetutës së BFI-së të vitit 1936 në Mexhllisin e Ulemasë së Shkupit, tryezë shkencore nga Bashkësia Fetare Islame në RM "80 vjet të Kushtetutshmërisë së BFI-së", Riaseti i BFI-së, Shkup 2017, fq. 15-28.

¹²⁶ ДАРМ. 1. 613. 1. 1/1-55; Lita, Qerim, po aty.

shprehje në nenin 32 të Rregullores së punës së BFI-së, e cila u soll paralelisht me miratimin e Kushtetutës, ku thuhej:

“Tërë pasuria e patundshme vakëfnore: varrezat myslimane, xhamitë, mesxhidet, teqetë, medresetë, mejtepet ose trualli, nëse janë ndërtesa të rrënuara, objekte dobipruese, të përkushtuar për qëllime fetare, arsimore e humanitare, të cilat në vitin 1912 janë hasur si të tilla, ndërsa më pas janë konfiskuar pa dëmshpërblim nga ana e pushtetarëve shtetëror e vetëqeverisës, do t’i kthehen Bashkësisë Fetare Islame ose do t’i paguhet vlera e tyre e përlllogaritur.

Pushtetarët kompetent të Vakëfit Mearif, Ministrisë së Drejtësisë do t’i dorzojnë një listë ku do të përfshihen të gjitha objektet e këtilla, e cila më pas do të formojë komision të përbërë nga nëpunës shtetëror e të vakëfit-mearif për përlllogaritjen e tyre dhe në marrëveshje me ministrin e Financave do ta rregullojë pagesën e shumës së përlllogaritur nga mjetet shtetërore apo vetëqeverisëse, në rast se nuk do t’i kthehen Bashkësisë Fetare Islame”¹²⁷.

Udhëheqja e re e Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, e cila erdhi pas zgjedhjeve të para të fshehta e të lira të cilat u mbajtën më 30 maj të vitit 1937¹²⁸, solli ndryshime rrënjësore, si në mënyrën e organizimit fetar dhe arsimor, po ashtu edhe në menaxhimin me pasurinë e tundshme e të patundshme vakëfnore. Në krye të saj ishin veprimtarët, intelektualët dhe atdhetarët e shquar shqiptar të asaj kohe si: Ferhat bej Draga, Ibrahim Lutfiu, Kadri Saliu, Asim ef. Luzha, Mustafa Dërguti, Sherif ef. Langu, Ataullah ef. Kurtishi, Bedri ef. Hamidi, mulla Idriz Hajrullau – Gjilani, Azem ef. Latifi, Iliaz Agushi, Shaban ef. Jashari, Sefedin Mahmutbeu, Abdullah Musliu e shumë të tjerë. Ardhja e tyre në krye të BFI-së së Shkupit, ishte rrjedhojë e fitores bindëse të krahut atdhetar shqiptar në zgjedhjet e sipërpërmendura, që ndryshe njihej si “lista opozitare shqiptare”, kundrejt listës serbomadhe të cilës i prinin Fejzi Haxhiamziq, Hasan Rebac, Mehmet Zeki, Murat Sheqeragiq, Dervish Sheqekadiq, Zufer Musiq etj., që të gjithë boshnjakë të serbizuar. Në krye të Kuvendit Mearif të Vakëfit u zgjodh, Ferhat bej Draga, ndërsa Këshilli i Kuvendit përbëhej prej 5 anëtarëve: Kadri Saliu kryetar ndërsa anëtarë u zgjodhën: Qemal Osmani, Sefedin Mahmutbeu, Zenel Strazimiri dhe Xhevat Mahmutbeu¹²⁹. Përveç kësaj u zgjodh edhe Mexhllisi i Ulemasë, i cili

¹²⁷ АЈ. Фонд. 63, фасц. Бр. 134, УРЕДБУ са законском снагом.

¹²⁸ Lita, Qerim, po aty.

¹²⁹ ДАРМ. 1. 954. 1. 1/1-6.

përbëhej prej katër anëtarëve: hfz. Sherif Langu kryetar, Ataullah ef. Kurtshi, Idriz ef. Hajrullau dhe Bedri ef. Hamidi për anëtarë¹³⁰. Ndryshime pati edhe në organet e tjera të BFI-së, siç ishin Drejtoria Qendrore e Vakëfit, me të cilin deri në atë periudhë kohore udhëhiqte albanofobi i njohur Fejzi Haxhiamziq etj.

Nisur nga fakti se popullsia shqiptare-myslimane, në përgjithësi ishte në nivelin tepër të ulët kulturor-arsimor, që vinte si rrjedhojë e mospasjes së të drejtës për t'u arsimuar në gjuhën amtare, Këshilli i Kuvendit Mearif të Vakëfit, rëndësi të madhe i kushtoi ndarjes së bursave si për nxënësit e shkollave të mesme, po ashtu edhe për studentët të cilët studionin në Universitetin e Beogradit e atë të Zagrebit. Këtë e shohim në buxhetet e viteve 1937/38, 1938/39 dhe 1939/40, ku një shumë e madhe ishte caktuar për këtë lëmi. Buxheti i vitit 1937/38 shuma e përgjithshme arrinte shifrën prej 11.385.500 dinarë, prej saj 650.000 ishin paraparë për bursa të studentëve¹³¹. Shuma e njëjtë ishte në buxhetin e vitit 1938/39, ndërsa në vitin 1939/40 kjo shumë u rrit në 800.000 dinarë¹³². Nga kjo shumë përfituan bursa mbi 150 studentë shqiptarë, turq e boshnjak. Në mesin e bursistëve pati edhe disa personalitete të cilët kanë lënë gjurmë në historiografinë shqiptare: Esad Doko, Dr. Zyrap Sejfullau, akademik Esad Mekuli, Mexhid Esadi, Nexhmedin Besimi, Xhevdet Pallaska, Jahja Osmani, akademik Idriz Ajeti, Sokol Dobroshi, Tahir Ismaili, Ibrahim Lutfiu, Abdulla Saqipi, Shaip Kamberi, Shaip Mustafa, Kurtesh Agushi, etj.¹³³

Veprimtaria atdhetare e kreut të BFI-së Shkup, i prishi të gjitha planet e projektet antishqiptare, të parapara nga ana e udhëheqjes së atëhershme jugosllave. Në këto rrethana, Qeveria Cvetković-Maçek, urdhëroi ministrin e Drejtësisë, L. Marković, të ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj BFI-së në Shkup. Ky i fundit, me vendimin nr. 42554/40-IV, të nënshkruar më 17 maj 1940, i pezulloi të gjitha organet e Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Mexhllisit të Ulemasë në Shkup, dhe në vend të organeve legjitime, emëroi një komisarariat shtetëror, i përbërë prej tre vetësh: Mehmet Zeki, Dervish Sheqrkadiq dhe Murat Sheqeragiq, që të tre, njerëz më të besueshëm të politikës serbomadhe. Një vendim i till, siç u mundua ta arsyetojë ministri, kishte ardhë për shkak, se gjoja Ministrisë së Drejtësisë, i kishin arritur “ankesa nga një numër i

¹³⁰ Lita, Qerim, po aty.

¹³¹ ДАРМ. 1. 616. 1. 7/114-119.

¹³² По aty, 8/122-129.

¹³³ По aty., Списак Стипендиста високошколаца за годину 1937/38; 1938/39; 1939/40.

konsiderueshëm i myslimanëve” nga territori i Mexhlisit të Ulemasë në Shkup “nga të cilat vihet në dukje se në Bashkësinë Fetare Islame në atë territor që nga zgjedhjet e Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup të kryera në vitin 1937, mbisundon një situatë e jashtëzakonshme....”¹³⁴. Në vendim, përcaktoheshin detyrat dhe kompetencat e komesaritit, ku thuhej: “Anëtarët e emëruar të Komesaritit Shtetëror do të kryejnë revizionin e punës së tërësishme të trupave dhe organeve të Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, duke filluar nga zgjedhjet e mbajtura në vitin 1937 e deri në ditën e pranimit të detyrës së komesaritit dhe do të më raportojnë për rezultatin e punës së tyre, si dhe raport se në cilin afat do të mund të shpallëshin zgjedhjet e reja për Kuvendin Mearif të Vakëfit në Shkup. Gjatë kohës së punës së Komesaritit Shtetëror në tërësi ndërpritet puna e mbarë funksionarëve e nëpunësve të zgjedhur në trupat Qendrore në territorin e Mexhlisit të Ulemasë në Shkup...

Emërimin të Komesaritit shtetëror, rëndësi të veçanti i kushtoi shtypi i atëhershëm ditor e periodik. Fletushka për gjoja “ngritjen” kulturore dhe ekonomike të myslimanëve “Nash Dom”, redaktor i së cilës ishte përkrahësi i politikës serbomadhe, Zyfer Musiq, në numrin e jashtëzakonshëm të datës 21 maj 1940 në faqen e parë me shkronja të mëdha shkruante: “U vendos komesariati në Bashkësinë Fetare Islame në Jug”, ndërsa si nëntitull: “I erdhi fundi i arbitrarizmit dhe shkeljes së ligjit në Bashkësinë Fetare Islame”. Duke e përkrahur pa asnjë rezervë vendimin, në të thuhej: “Nuk mund të paramendohet, e ku më të përshkruhet, ajo veprimtari arbitrarë e joligjore, të cilin e ka zbatuar grupi i z. Ferhat Dragës në Bashkësinë Fetare Islame në Jug. Këtë më së miri e ka të qartë pasuria e Vakëfit, e cila është shpenzuar në mënyrë të paskrupullt. Ky grup i njerëzve kanë harruar, se ajo është institucion i të gjithë myslimanëve, e jo vetëm i bejlerëve, të cilët përbëjnë lungun e rrezikshëm në trupin e myslimanëve mbarë e me këtë edhe të botës punëtore shqiptare në vendin tonë....”¹³⁵.

Të njëjtën ditë, përkatësisht, më 21 maj 1940, i deleguari i banit të Shkupit, inspektori Daut Vilhem, së bashku me tre komesarët e lartëpërmendur, shkuan në selinë e Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, me qëllim siç thuhet në një dokument. “anëtarëve të Mexhlisit të Ulemasë z.z. Sherif Osmanit, Ataullah Kurtishit, Bedri Hamidit dhe Idriz Hajrullaut t’ua dorëzojnë vendimin e

¹³⁴ AJ. Фонд 63, фасц. бр. 135, Пов. бр. 42554/40-XIV, 17 маја 1940 год., Београд.

¹³⁵ По ату; Чланови Комесаријата су г.г. Мехмет Зеки, Дервиш Шељеркадиќ и Мурат Шељерагиќ, Шкуп, 21 мај 1940.

nënshkruar nga ana e ministrit të Drejtësisë me të cilin në territorin e Mexhllisit të Ulemasë në Shkup vendoset Komesariati Shtetëror, i cili do t'i ndërmarrë të gjitha detyrat e funksionet e funksionarëve e nëpunësve të zgjedhur të BFI-së, në territorin e Mexhllisit të Ulemasë në Shkup". Një kërkesë e tillë, u refuzua në mënyrë kategorike, nga të katër anëtarët e atij mexhllisi, të cilët deklaruan: "Vendimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 42554/40-IV, me të cilin vendoset Komesariati Shtetëror dhe ndërprerjen e çdo veprimtarie tonë të mëtutjeshme, e konsiderojmë si joligjor prandaj nuk mund detyrën t'ua dorëzojmë komesarëve të caktuar"¹³⁶.

Ndërkohë, Ferhat bej Draga, më 20 qershor 1940, në cilësinë e kryetarit të Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup, Këshillit Shtetëror në Beograd i dorëzoi një padi prej 17 faqesh kundër vendimit të lartëpërmendur. Në vazhdim po e paraqesim një pjesë të asaj padie: "....Me këtë urdhëresë, si individualisht po ashtu edhe në tërësi, është shkelë hiç më pak se autonomia e Bashkësisë Fetare Islame, e garantuar me Ligjin për Bashkësinë Fetare Islame të Mbretërisë Jugosllave, ndërsa me ato masa arbitrare është pezulluar thuajse flet për flete Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame....Bashkësia Fetare Islame administrohet sipas ligjeve dhe Kushtetutës së saj, të cilat, në këndëvështrimin juridik, është identike për shembull me Ligjin për Kishën Ortodokse Serbe dhe me Kushtetutën e Kishës Ortodokse Serbe. Ligjëvënësi është kujdesur me vëmendje, që gjatë përpilimit të Ligjit fetar të mos ketë as dyshimin më të vogël të diskriminimit apo padrejtësisë. Ja, për shembull ne nuk mund ta paramendojmë, që në Shtetin tonë mund të gjendet ndonjë ministër i drejtësisë, madje edhe nëse nuk do të ishte serb i besimit ortodoks, por jashtë atij besimi – të themi kroat, slloven ose, madje edhe shqiptar – i cili do të merrte guximin qoftë kjo edhe teorike për ta plotësuar qëllimin që autonomisë së Kishës Ortodokse Serbe t'ia hartojë kësulën në mënyrën, siç tash praktikisht ministri i Drejtësisë po bën përpjekje ndaj autonomisë së Bashkësisë Fetare Islame. Në atë rast mund të paramendohet, askush nuk mund t'iu shmangej pasojave të rënda, sepse ne ende e kemi të freskët furtunën e paradokohshme....Theksum se, vendimi i sjellë as që mund të kuptohet, e ku më të vlerësohet, mbi bazën e kriterit të drejtësisë. I njëjtë vendim nuk përmban as ç'farë arsytimi të dokumentuar, me çka do të mund të hulumtoheshin reagimet e arsyeshme, me të cilat zoti ministër i Drejtësisë mbështetet gjatë

¹³⁶ По ату, Записник о примопредаји дужности између Улема Меџлиса у Скопљу са једне стране и државног комесаријата с друге стране, 21 мај 1940 год., Скопље.

sjelljes së tij. Në atë hamendje do të ngeleshim edhe më tutje, po qe se zoti Reis-ul-ulema në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Mearif të Vakëfit në Sarajevë, të mbajtur më 14 qershor të vitit 1940 (sipas informatave të gazetës zagrebase “Obzor” nr. 138 nga 15 qershori 1940), duke protestuar për shkak sjelljes së vendimit kundërligjor, veç të tjerash, konstatoi: “Kur gjatë debatit me ministrin e drejtësisë biseduam për këto çështje, ai më deklaroi, se kjo nuk është çështje juridike por politike”. Nëse ky konstastim është i këtillë (ndërsa nuk kemi arsye të dyshojmë në fjalët e zotëri Reis-ul-ulemasë), atëherë sjellja e zotit ministër të drejtësisë mund të jetë e kuptueshme vetëm në disa këndvështrime, të papërcaktuara dhe të pakuptueshme për ne, të interesit politik, mirëpo me këtë ky veprim ende nuk është arsyetuar nga këndvështrimi i Ligjit, rregullimit juridik, sigurisë juridike e të moralit publik. Për këtë arsye lus, Këshillit Shtetëror, që ta miratojë këtë padi nga arsyet e lartpërmendura dhe ta hedhë poshtë në tërësi vendimin e zotit ministër të drejtësisë të datës 17 maj të vitit 1940”¹³⁷.

Një ditë më pas, pasoi padia edhe e Mexhlisit të Ulemasë, drejtuar të njëjtit institucion, në të cilën veç të tjerash në të thuhej: “...Duke e pas parasysh se akti për pezullimin e Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup ashiqare është JOLIGJOR, sepse zoti ministër i Drejtësisë kontrollin e nevojshëm ka mund ta kryej paralelisht me ekzistimin e Kuvendit, meqenëse Reis-ul-ulemaja e Bashkësisë Fetare Islame nuk e pranon e as që do ta pranojë aktin për vendosjen e Komesariatit Shtetëror në Drejtorinë e Vakëfit në Shkup, prandaj me të njëjtin nuk pranon as çfarë bashkëpunimi, meqenëse Mexhlisi i Ulemasë në frymën e Kushtetutës e të Ligjit për Bashkësinë Fetare Islame është detyruar t’iu përmbahet urdhëresave dhe instruksioneve të Reis-ul-ulemasë si udhëheqësin e tij suprem, prandaj Mexhlisi i Ulemasë nuk ka mundësi ligjore të veprojë sipas urdhëresës së z. ministër të drejtësisë në vendimin e bashkangjitur, për çka pason padia jonë deri te Këshilli Shtetëror me lutje që ky vendim i z. ministër të drejtësisë të hudhet poshtë si antiligjor.”¹³⁸.

¹³⁷ По ату, Државном Савету Београд – Тужба Драга А. Ферхада из Скопља, као претседника Вакуфског-Меарифског Сабора у Скопљу против одлуке Министарства Правде од 17 маја 1940 год. Бр. 42554/40-XIV, Beograd 20 qershor 1940.

¹³⁸ По ату, Државном Савету Београд – Тужба Улема Меџлиси у Скопљу против Министарства Правде Бр. 45638 од 25 маја 1940 године, ПРЕДМЕТ: Решење Министарства Правде којим се наређује Улема Меџлису да сарађује са постављеним Комесаријатом у Вакуфској Дирекцији у Скопљу у вези са распуштањем Вакуфског-Меарифског Сабора при поменутој дирекцији, Shkup, 21 qershor 1940, Nr. 7160/40.

Duke u munduar t’u kundërvihet dy padive të mësipërme, ish kryeshefi i Ministrisë së Drejtësisë – dhoma për fe në Shkup, Hasan Rebac, i shkruante Këshillit Shtetëror në Beograd, se udhëheqja e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup, po zbaton një politikë “nacional-shoviniste”. Sipas tij “Ferhat bej Draga, këtë e ka shtruar në mënyrë të qartë në mbledhjen e datës 19 prill 1939, duke i ndarë myslimanët e jugut në shqiptarë e joshqiptarë”. Në këtë frymë të re të imponuar, theksonte në vazhdim, Rebac “sikurse tërë kryesia po ashtu edhe i tërë këshilli kuvendor dhe i tërë këshilli i kontrollit, i ashtuquajtur i këshilli i punës përbëhen vetëm nga shqiptarët” e nëse merret parasysh se edhe të gjithë anëtarët e Mexhlisit të Ulemasë janë shqiptarë, “atëherë mund të paramendohet se në ç’farë gjendje nënçmuese janë myslimanët – joshqiptar, përkatësisht, myslimanët-serbë...”¹³⁹.

Për dallim nga Hasan Rebac, udhëheqësi suprem i BFI-së në Sarajevë, Reis-ul-ulemaja Fehim ef. Spaho, në mënyrë kategorike e hodhi poshtë vendimin e ministrit, të cilin ai e quante antiligjor dhe arbitrar, duke kërkuar nga Mexhlisi i Ulemasë në Shkup, ta ndërpresë çdo lloj bashkëpunimi me Komesariatit Shtetëror. Këtë e shohim në urdhëresën me numër 98/40, të datës 21 gusht 1940, përmbajtja e së cilës është si vijon: “Me rastin e vendosjes së komesaritit shtetëror në Drejtorinë e Vakëfit në Shkup, aktin e ministrit të Drejtësisë numër 42554/40 nga data 17 maj 1940, me aktin e këtushëm Proc. nr. 67/40 nga 6 qershori k.v., ia kam bërë me dije Mexhlisit të Ulemasë t’i ndërpresë të gjitha shkresat me këtë komesarat të vendosur në mënyrë joligjore, pasi ky komesarat sipas Kushtetutës dhe Ligjit të BFI-së nuk ka as ç’farë legjitimiteti legal për ekzistimin e vet, prandaj tërë veprimtaria e tij nga pikëpamja e Kushtetutës dhe Ligjit të BFI-së janë joligjor dhe pa bazë morale. Në lidhje me këtë, lutet Mexhlisi i Ulemasë, që përmes një qarkore t’ua bëjë me dije të gjithë imamëve të rretheve e të xhematit, që edhe ata të mos mbajnë as ç’farë korrespondence me këtë komesarat, sepse të gjitha vendimet e këtij trupi janë të pavlefshme juridikisht, ndërsa për të njëjtat duhet të prononcohet edhe Drejtoria e Vakëfit në Shkup”¹⁴⁰.

Ndërkohë, Ferhat bej Draga, më 18 nëntor 1940, i dërgoi një letër nënkryetarit të Qeverisë së Mbretërisë jugosllave, Vlatko Mačekut, ku veç të tjerash shkruante: “Meqenëse me vendimin e

¹³⁹ По ату, Државном Савету у Београд, Хасан Ребац, шлан Вакуфског-Меарифског Сабора у Скопљу и началник Министарства Правде у пензии.

¹⁴⁰ По ату, Исламска Веска Заједница – Улема Меџлис у Скопљу Пов. бр. 41/40, Shkup,, 24 gusht 1940.

17 majit të këtij viti të ministrit të Drejtësisë në mënyrë joligjore e ka pezulluar Kushtetutën e Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, dhe në mënyrë arbitrare ka emëruar komesariat, tërë popullsia myslimane këtë e ka parë si një grusht ndaj institucioneve të veta fetare dhe si një atentat të ri ndaj të drejtave elementare të myslimanëve në trevat jugore. Pas rrugës plot me ferra përmes së cilës myslimanët e viseve jugore e sidomos ata të kombësisë shqiptare ishin të detyruar të kalojnë në mbrojtjen e pasurisë së tyre fshatare nga grabitqarët zullumqar, e cila zbatohej përmes të ashtuquajturës reformë agrare dhe kolonizim, e cila edhe pse gjoja është ndërprerë përkohësisht, ende u kërcënohet si shpatë mbi kokë, tash atyre u kërcënohet edhe në të drejtën e vetme, të cilën ata e kanë gëzuar në këtë shtet, në autonominë e tyre fetare. Përndryshe, Juve, Zotëri Kryetar, U janë të njohura rrethanat përsëafërmi se në çfarë përmasash janë zhvilluar përndjekjet e myslimanëve tanë, për arsye se herpashere edhe vetë kam pasur nderin, për tërë këto të Ju informoj...”¹⁴¹.

Vendosja e Komesariatit Shtetëror, riktheu situatën e para vitit 1936, ku dëme më të mëdha pësuan pasuria vakëfnore. Më 2 dhjetor të vitit 1940, Gjyqi i Qarkut të Prizrenit, solli vendim, me të cilin xhaminë historike “Sinan Pasha” në Prizren ia dhuroi Kishës Ortodokse Serbe. Duke e arsyetuar këtë vendim, Gjyqi i Qarkut të Prizrenit konstatonte: “...ky truall është pronë e komunës paditëse, se edhe xhamia e cila është ndërtuar në këtë truall përbën pronë e palës paditëse sepse është ndërtuar në tokën e komunës paditëse me materialin e manastirit të rrënuar Shën Arangjeli e ndërtuar nga Car Dushani, i cili manastir është rrënuar përmes terrorit dhe dhunës ndërsa materiali është bartë në Prizren dhe nga ky material është ndërtuar xhamia; se ky truall së bashku me xhaminë deri në luftërat ballkanike ka qenë në duart e Prokurës së Vakëfit Mearif të Prizrenit, përkatësisht deri në pushtimin e qytetit nga ana e ushtrisë të Mbretërisë serbe; se atëherë këtë xhami e ka marrë në duart e veta ushtria jonë; se këtë xhami e ka shndërruar në magazinë; se kjo xhami edhe sot është magazinë; se pronësia e Prokurës së Vakëfit Mearif të Prizrenit nga momenti i marrjes së këtij trualli e deri në luftën ballkanike dhe më tej deri më sot është e dhunshme dhe jo-ligjore...etj.”¹⁴². Ndaj këtij vendimi arbitrar, reagoi Reis-ul-Ulemaja, Fehim ef. Spaho, i cili më 24 dhjetor përmes një shkrese iu drejtua ministrit të drejtësisë, ku ndër të tjerave

¹⁴¹ По ату, Ферхад Драга – Београд, Таковска 9, Београд, 18 нентор 1940.

¹⁴² По ату, Окружни Суд у Призрену По 5/40, Пресуда због изостанка у име Његовог Величанства Краља.

shprehej: “Në lidhje me shkresat e mija të mëhershme për punën joligjor të anëtarëve të Komesariatit pranë Drejtorisë së Vakëfit në Shkup, në Gjyqin e Qarkut në Prizren për xhaminë e atjeshme të Sinan Pashës, për të cilën Komesariati nuk ka dërguar përfaqësuesin e vet mbrojtës, për çka është sjell vendim në dëm të Bashkësisë Fetare Islame dhe xhamia i është dhënë kishës...Krahas asaj se kjo xhami – shprehej më tej Spaho – është në pronësi të përhershme të Bashkësisë Fetare Islame dhe, veçoritë e saja, konstruksioni i saj, dëshmojnë pronësinë e pakontestueshme të BFI-së ndaj kësaj xhamie, prandaj si dëshmi e gjallë, ajo nuk mund të prezantohet ndryshe, mirëpo kjo paraqet një dëshmi më shumë, se si anëtarët e Komesariatit edhe në këtë mënyrë e shkatërrojnë pasurinë e BFI-së, që kjo më herët nuk ka ndodhur, përderisa funksiononte kuvemdi...”¹⁴³.

Dokumentet e kohës hedhin dritë për një sërë masash të tjera që u ndërmorën menjëherë me vendosjen e Komesariatit Shtetor në Mexhlisin e Ulemasë së Shkupit, të cilat për qëllim kishin shkatërrimin e tërësishëm të pasurisë së BFI-së, që me këtë rast po e veçoja vendimin për mbylljen e Bibliotekës Qendrore të Vakëfit në Shkup, e cila ishte e vetmja në hapësirat që i mbulonte Mexhlisi i Ulemasë së Shkupit. Një akt i tillë i kryer nga Komesariati, shqetësoi tej mase Reis-ul-Ulemanë, të cilën revoltë mund ta shohim edhe në letrën e tij protestuese dërguar më 24 nëntor 1940, të cilën në vazhdim po e paraqesim të plotë:

“E keni të njohur se në Jug ka rreth një milion myslimanë, gjendja arsimore e të cilëve është në një shkallë tepër të ulët. Mirëpo ndoshta Ju nuk jeni të njoftuar se kjo bibliotekë është e vetmja e atij lloji, e cila ekziston në mesin e myslimanëve të Jugut. Vendimi i Komesariatit që të mbyllet edhe kjo bibliotekë, ofron dëshmi të mjaftueshme për qëllimin e aktit për vendosjen e Komesariatit, i cili faktikisht nuk ka për qëllim mbrojtjen e interesave të Bashkësisë Fetare Islame, por cënimin dhe shpartallimin e së njëjtës për një afat sa më të shkurtër, duke e zhdukur edhe çerdhen e fundit kulturore të myslimanëve të Jugut edhe ashtu me nivel të dobët kulturor e arsimor...”¹⁴⁴.

¹⁴³ АЈ. Фонд 63, фасц. Бр. 135, Пов. бр. 2386/40, 24 децембра 1940 год., Сарајево.

¹⁴⁴ По ату, Пов. бр. 2156/40, 24 новембра 1940 године, Сарајево.

Pjesa dërmuese e pronave të vakëfit në trojet e RMV janë bastarduar dhe shpronësuar, si nga pushteti ashtu edhe nga individë të caktuar, në këtë periudhë prandaj edhe i kushtuam rëndësi të veçantë kësaj pjese të administrimit të vakëfeve në periudhën e Mbretërisë Jugosllave¹⁴⁵.

2.5 Administrimi i vakëfeve në periudhën e ish RSFJ-së

Themelimi i shtetit të ri të Jugosllavisë komuniste i gjeti totalisht të paorganizuar komunitetet myslimane të këtyre trojeve dhe si pasojë e kësaj edhe pronat vakëfore të cilat kishin mbetur të administrohen kryesisht nga Bashkësia Islame. Gjendja edhe më e mjherë ishte në hapësirat e Republikës së Maqedonisë, veçanërisht për shkak të mosorganizimit total të Bashkësisë Islame. Kur nën parullën se: “toka u takon atyre që e punojnë”, pushteti i ri komunist me Ligjin për Reformën Agrare dhe Kolonizimin të 23 gushtit 1945, të cilin e miratoi Kuvendi i Përkohshëm Popullor i Jugosllavisë Demokratike Federative (JDF), mori hapësira të stërmëdha toke. Marrja e tokës bashkësive fetare u shpjegua, mes të tjerash, me ndërtimin e unitetit të ardhshëm të popujve jugosllavë.¹⁴⁶

Gjatë procesit të transformimit të raporteve pronësore në shoqërinë jugosllave, është aktualizuar çështja e riprivatizimit, respektivisht kthimi i pronarëve të mëparshëm i pronës së marrë me dhunë në periudhën e pasluftës. Ndër ata pronarë vend të veçantë zënë bashkësitë fetare që në mënyra të ndryshme janë privuar nga një pjesë e konsiderueshme e pronës së tyre. Në Jugosllavinë e pasluftës me dhunë u ndryshua baza pronësore e shoqërisë, me marrjen apo kufizimin e pronësisë private. Justifikimin ideologjik të atyre masave e siguroi teza marksiste për “shpronësimin e shpronësuesve”. Prona e bashkësive fetare ishte objekt marrjeje për dy arsye:

¹⁴⁵ Falënderim të veçantë i përket Dr. Qerim Litës i cili i ka zbardhur dokumentet arkivore në lidhje me administrimin dhe keqpërdorimin e vakëfeve në periudhën e Mbretërisë Jugosllave, të cilat i kemi shfrytëzuar edhe ne në këtë pjesë.

¹⁴⁶ “Duke e shpjeguar në referatin për misionin rus në Beograd problemin e reformës agrare në tokat kishtare në Jugosllavi, ministri i bujqësisë Vasa Çubriloqiq në tetor të vitit 1945 shkruan: “Për çdokënd që sadopak i njeh raportet e brendshme në Jugosllavi është e qartë se nuk do të ketë unitet të popujve të saj, derisa ndikimi i fesë të mos kufizohet dhe atë vetëm në qëllimet dhe detyrat e ngushta fetare. Kjo do të mund të arrihet vetëm me dobësimin e fuqisë ekonomike, kulturore e politike të hierarkive kishtare..., domethënë t’iu pamundësojë që brezat e ardhshëm në Jugosllavi t’i edukojnë si deri më tani në përjashtim fetar dhe urrejtje, dhe kjo është një nga arsyet madhore përse duhet kryer reforma agrare edhe në tokat kishtare”. Radmila Radiq, “Drzava i verske zajednice 1945-1970”, I, Institut za noviju istoriju Srbije, Beograd, 2002, f. 179.

(1) për shkak se bashkësitë fetare në Jugosllavinë e paraluftës ishin pronarë privatë-juridikë të rëndësishëm, dhe

(2) për shkak se ata u cilësuan si kundërshtarë ideologjikë të rrezikshëm për procesin e ndërtimit të “botës së re, të mirë”.¹⁴⁷

Në Jugosllavinë e paraluftës prona e Bashkësisë Islame me cilësinë e vakëfit paraqiste mundësi ekonomik të mëdha. Në hapësirën e Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi në vitin 1933 janë regjistruar 872 vakëfe. Në ato vise fuqia ekonomike e vakëfeve ishte reduktuar në masë gjatë dy dekadave të Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene (Jugosllavisë), për shkak të konfiskimit të paligjshëm të pronës së vakëfit apo keqpërdorimit të drejtuesve dhe shfrytëzuesve të papërgjegjshëm. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, sipas të dhënave nga viti 1938, kishte 1.647 vakëfe për të cilat miratoheshin 968 buxhete të veçanta. Në atë hapësirë vakëfi konsiderohej si pronar privat më i madh.¹⁴⁸

Rrëmbimi me dhunë i pronës së vakëfit u krye përmes reformës agrare, shtetëzimit dhe shpronësimit të pronës private. Përmes reformës agrare nga pronarët e deriatëhershëm u morën disa pasuri bujqësore dhe u kaluan në pronësi shoqërore, respektivisht iu dhanë sidomos personave të caktuar.

Me reformën agrare nga viti 1945, u shpall se në pronësi shoqërore kalojnë edhe pronat tokësore të të gjitha llojeve të dhuratave dhe faltoreve të caktuara, xhami, teqe, vakëfe dhe të ngjashme (Ligji për reformën agrare dhe kolonizimin i dt. 27.07.1945).¹⁴⁹ Për shkak të nevojave të tyre, disa xhamive, teqeve dhe institucioneve fetare të ngjashme, iu lanë 100 dynymë (10 hektarë) nga sipërfaqja e përgjithshme e pronave, livadheve dhe zabeleve (pyjeve) të tyre. Nëse bëhej fjalë për institucione fetare me rëndësi më të madhe ose me vlerë historike më të madhe, mund të lihej nga prona e tyre deri në 300 dynymë të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së punueshme dhe zabelit.¹⁵⁰ Kështu ishte shkruar në letër, por në realitet situata ishte krejtësisht ndryshe.

¹⁴⁷ Enes Durmišević, “*Vakufi u različitim političkim sistemima - odnos vlasni prema vakufima, posebno posle agresije na BiH*”, në **Novi Muallim**, vjeshtë 2011, viti XII, Nr. 47, f. 21.

¹⁴⁸ Shih: Fikret Karčić, “*Vakufi i reprivatizacija*”, *Glasnik*, Rijaset Islamske zajednice u SFRJ, Sarajevë 1991, nr. 3, f. 269; po ashtu: Enes Durmisevic, *vep. cit.*, f. 22.

¹⁴⁹ Godinjak, Vejsil, “*Neka zapažanja o vakufskoj upravi kod nas*”, *Glasnik IZ-e*, nr. 3, 1991.

¹⁵⁰ Fikret Karcic, *vep. cit.*, f. 270.

Sipas të dhënave të organeve zyrtare të Bashkësisë Islame nga fillimi i viteve 1950, kjo masë nuk kishte reflektim mbi pasurinë e vakëfit, ngaqë ishin të rrallë vakëfet me pronësi tokësore më të madhe se 100, respektivisht 300 dynymë.¹⁵¹ Mirëpo, tokat vakëfe, për shkak të mosfunksionimit të administratës së vakëfit apo mungesës së mbrojtjes juridike, ishin shpesh objekt uzurpimi. Sipas të dhënave nga viti 1955, në dhjetëvjeçarin e parë të pas luftës në mënyra të ndryshme janë marrë dhunshëm 3197 dynymë tokë vakëfi që edhe është konstatuar në mbledhjen e Kuvendit të Vakëfit të mbajtur më 30.10.1955.¹⁵²

Përmes shtetëzimit të kryer në vitet 1946, 1948 dhe 1958, u realizua pronësia zoteruese shtetërore, respektivisht shoqërore, në të gjitha degët dhe në fushën e patundshmërive. Ligji për shtetëzimin e kompanive private ekonomike nga 06.12.1946, me ndryshimet dhe plotësimet nga 29.04.1948, ishte baza juridike për marrjen me dhunë të mullinjve, hoteleve, banjave (Ilixhave) dhe institucioneve të ngjashme të vakëfit. Kompensimi për të mirat e shtetëzuara jepej përmes bonove me vlerë që ishin në emër të prurësit.¹⁵³

Goditje e veçantë pronës së vakëfit iu bë me Ligjin për disponimin me banesa dhe hapësira biznesi nga 17.02.1945 dhe me Ligjin për shtetëzim të ndërtesave të dhëna me qira dhe tokave ndërtimore nga 28.12.1958, duke pasur parasysh rrethanën se ato objekte paraqisnin pjesën më të madhe të fondit vakëfor në mjediset urbane. Me këtë ligj Bashkësisë Islame iu morën të gjitha ndërtesat e banimit dhe të biznesit, përveç atyre që shërbenin për veprimtari fetare të përkufizuar me saktësi (rite fetare, punë fetare dhe banesat e nëpunësve fetarë). Për ndërtesat e shtetëzuara me tokën në të cilën gjenden i është caktuar kompensim pronarit të mëparshëm në masë prej dhjetë për qind të qirasë që është paguar për atë ndërtesë ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit, dhe atë për një periudhë pesëdhjetëvjeçare në këste mujore të barabarta, duke filluar nga

¹⁵¹ “Glasnik VIS” (Organi zyrtar i Kryesisë Supreme Islame), Nr. 4-7/1950, 162)

¹⁵² “Glasnik VIS”, Nr. 4-6/1957, 197.

¹⁵³ Sipas gojëdhënave, për arsye se nuk kemi dokumente të shkruara, në Kumanovë para Luftës së Dytë Botërore, drejtor i Drejtorisë së Vakëfit ka qenë Hasan Rebac. Ky drejtor varrezat në qendër të Kumanovës (ku sot gjendet spitali i qytetit) i ka shitur, dhe kjo ka shkaktuar revoltën e qytetarëve të Kumanovës, që ka rezultuar me dorëheqjen e tij. Në vend të tij vjen babai i Tarik Shara, biznesmen i njohur turk me prejardhje nga viset tona, me mbiemrin Hamziq, ngaqë pushtetarët e asaj kohe nuk kanë dëshiruar që në krye të një institucioni fetar të vijë shqiptar. Këtë të dhënë e kam siguruar nga një autor i disa veprave me karakter historik dhe kulturor të këtyre viseve, Fahri Kaja. Nga ai e kam edhe një të dhënë tjetër se para shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, një banor i fshatit Jakimovo – rrethi i Vinicës, me emrin Hafzi, e shet xhaminë. I pyetur nga Fahri Kaja se përse e ka bërë këtë, ai është përgjigjur se nuk ka mbetur askush më aty.

01.01.1959. Për tokë vakëfi të pandërtuar kompensimi është paraparë sipas tarifës për shpronësim.¹⁵⁴

Goditja përfundimtare, vakëfeve iu bë me Ligjin për Shtetëzim të ndërtesave dhe tokës ndërtimore të vitit 1958. Atëherë, Bashkësisë Islame, sipas të dhënave të Drejtorisë së Vakëfit, iu morën 11.324 vakëfe (dyqane, xhami, varreza, shtëpi, banesa, ndërtesa, mektepe) me një sipërfaqe të përgjithshme prej 30.342.496 metrash katrorë. Dëmi, si rezultat i shtetëzimit të banesave të vakëfit dhe hapësirave afariste, vlerësohet në rreth 372.000.000 EUR.¹⁵⁵ Vitin në vijim, pra më 1959, u shfuqizua Drejtoria e Vakëfit dhe të gjitha organet e drejtorisë vakufore-mearife, sepse Bashkësia Islame mbeti pa pronë dhe ajo mbijetoi vetëm falë kontributeve vullnetare të anëtarëve të saj.¹⁵⁶

Si pasojë e këtyre ligjeve për shpronësim të vakëfeve që i takonin Bashkësisë Islame në RMV shumica e vakëfeve u nacionalizuna ose konfiskuan nga ana e shtetit dhe vetëm një pjesë e vogël, në krahasim me sasinë e vakëfeve pronë të Bashkësisë Fetare Islame, mbetën nën administrimin e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë.

2.6 Administrimi i vakëfeve në periudhën e Republikës së Maqedonisë

Pas deklarimit të pavarësisë të Maqedonisë dhe ndarjes prej federatës jugosllave në vitin 1990 puna kryesore e Bashkësisë Islame ishte përqendrimi në kthimin e vakëfeve të uzurpuara nga ana e shtetit, veçanërisht pas miratimit të ligjit për denacionalizim.

¹⁵⁴ Shih: Fikret Karčić, *po aty.*, f. 270; po ashtu: Enes Durmisevic, *po aty.*, f. 21.

¹⁵⁵ Enes Durmisevic, *po aty.*, f. 22.

¹⁵⁶ Aty nga fundi i ekzistimit të RSFJ-së në të gjitha njësitë federale jugosllave nisi procesi i përgatitjes, respektivisht i sjelljes së akteve ligjore që do të mundësonin kthimin e pronës së marrë me detyrim. Nga pikëpamja e pronës së bashkësive fetare e pranueshme ishte zgjidhja, sipas së cilës me një ligj do të rregulloheshin veprimet e përbashkëta të riprivatizimit, pavarësisht statusit të pronarëve të mëparshëm, ose të miratoheshin ligje të veçanta për kthimin e pronës, bashkësive fetare. Në qarqet profesionale thuhej se për procesin e riprivatizimit ishte e domosdoshme të siguroheshin supozime juridike me vënien në fuqi të ligjit në bazë të të cilave është bërë marrja me dhunë e pronës dhe me ndryshimin e dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me raportet pronësore-juridike. Nga aspekti i bashkësive fetare duheshin ndryshuar dispozitat kushtetuese sipas të cilave ato “në kufij të përcaktuar me ligj, mund të kenë të drejtë pronësie mbi patundshmëri” (neni 174 i Kushtetutës së RSFJ etj.). Bashkësitë fetare duhej të barazoheshin me personat fizikë në aspekt të së drejtës së pronësisë mbi patundshmëritë. Shih, Suat Mahmutovic, “*Višedecenijsko uništavanje vakufa u Bosni i Hercegovini*”, **Novi Muallim**, nr. 32, 19 dhul-hixhxe, 1428 / 29 dhjetor, 2007, f. 30.

Bashkësia fetare Islame e Maqedonisë e gëzonte të drejtën kushtetutare për kërkimin e kthimit të pronave të saja nga ana e shtetit për shkak se me kushtetutën e vitit 1991 përcaktohej pozita juridike e saj dhe garantohej e drejta e zbatimit të obligimeve fetare. Bashkësitë fetare në Maqedoni konsiderohen si të barabarta para kushtetutës dhe ligjit dhe janë të ndara nga shteti. Më pas në kushtetutë theksohet se bashkësitë fetare kanë të drejtë të themelimit të shkollave fetare dhe të institucioneve humane shoqërore në bazë të procedurave të parapara me ligj. E drejta e besimit, mendimit dhe vetëdijes së lirë e ngërthen edhe lirinë e manifestimit të fesë së personit ose besimit të tij, që ai vetë ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht e ka. Nuk lejohet në asnjë mënyrë diskriminimi fetar. Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz kanë të drejtën e organizimit të lirë të brendshëm, duke i themeluar organet e veta udhëheqëse, hierarkinë dhe kompetencat dhe të zgjedhin personat që do ti përfaqësojnë. Ata kanë të drejtën e sjelljes edhe të akteve në lidhje me këto veprime.

Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz regjistrohen në regjistrin gjyqësor të veçantë për kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze dhe me këtë e fitojnë statusin e subjektit juridik.

Të ardhurat e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz janë nga vetëfinancimi, filantropia private, donacionet dhe forma të tjera të financimit. Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz në trajtë të pavarur disponojnë me të ardhurat e tyre, në ujdi me ligjin dhe me dispozitat e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz.¹⁵⁷

Duke u bazuar në dispozitat pozitive ligjore të përmendura më sipër Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni ishte i vetmi institucion që e gëzonte të drejtën për kthimin e pronave të uzurpuara në periudhën e komunizmit.

Veprimtaria e Bashkësisë Islame në aspekt të kthimit të pronës së vakëfit të marrë me dhunë filloi krahas me paralajmërimin e procesit të reformës ekonomike, politike dhe juridike në Jugosllavi. Funkionarët më të lartë të Bashkësisë ua parashtruan kërkesat përkatëse organeve politike. Operacionalizimi i atyre kërkesave pasoi me vendimin e Kuvendit Suprem të Bashkësisë Islame të RSFJ-së të datës 06.11.1990, me të cilën u angazhuan meshihatet që deri në fund të Ramazanit (prill) 1991 të përpilojnë listën e të gjitha patundshmërive të vakëfit në territoret e

¹⁵⁷ Për më tepër, shih në: M. B., *Правна положба и правен статус на црква, verska zaednitsa i religiozna grupa vo Republika Makedonija*, 21 gusht 2014, <https://akademik.mk/pravna-polozhba-i-praven-status-na-tsrkva-verska-zaednitsa-i-religiozna-grupa-vo-republika-makedonija/>.

tyre, si ato të marra pas vitit 1945, ashtu edhe të atyre që ishin ende në pronësi të Bashkësisë Islame. Kuvendi Suprem do t'iu dërgonte organeve federale kërkesë për kthimin e pronës së marrë, ndërsa kuvendet në republikat e veçanta, do t'i dërgonin kërkesë autoriteteve kompetente republikane.¹⁵⁸

Meshihati në Shkup i parashtroi kërkesë qeverisë së Maqedonisë për kthimin e pronës së tërësishme vakëfore të marrë. Si shembull i korrespondencës midis Bashkësisë Islame të Maqedonisë me organet shtetërore për kthimin e disa objekteve sakrale të shtetëzuara, po e përmendim një shkresë nga BI, të datës 22.05.1991, drejtuar Kuvendit të RS të Maqedonisë, ku kërkohet kthimi i (1) objekteve fetare të shtetëzuara: Jeni Xhamisë në Manastir (që shfrytëzohej si galeri artistike); Hajdar Kadi xhamisë, po ashtu në Manastir (që shfrytëzohej si magazinë për verëra); Zibija – kërëk xhamisë ne Prilep (e shfrytëzuar si magazinë); Mesxhidi në Manastir (i shfrytëzuar si hapësirë afariste); (2) objekte fetare të uzurpuara: Harabati Baba teqeja në Tetovë (e shfrytëzuar pjesërisht si restorant, e pjesërisht si muze); dhe (3) objekte fetare të rrënuara, monumente kulture...¹⁵⁹

Kësaj kërkesë Qeveria e RS të Maqedonisë, në bazë të shkresës nga Ministria e Financave nr. 12-2283/1, të datës 29.05.1991, i përgjigjet me shkresën e datës 08.07.1991, ku ndër të tjera thotë:

... Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 06.07.1991, e shqyrtoi Kërkesën e Kryesisë së Bashkësisë islame në RM për kthimin e objekteve fetare të BI-së dhe në bazë të mendimit të Ministrisë së Financave konstatoi se:

¹⁵⁸ Duke vepruar sipas këtij vendimi, Meshihati në Sarajevë me datë 12.11.1990 nxori përfundim për atë që publikisht t'i paralajmërojë të gjithë ata të cilët për çfarëdo arsye e mbajnë pronën e vakëfit se do të konsiderohen si të shfuqizuara të gjitha marrëveshjet që do të kishin si lëndë tjetërsimin e asaj prone. Më 29.11.1990, Meshihati kërkoi nga të gjitha këshillat e Bashkësisë Islame të realizojnë përfundimin e kuvendit për regjistrimin e patundshmërive të vakëfit. Me një udhëzim të veçantë u numëruan të gjitha të dhënat e duhura dhe dokumentet e nevojshme për vendosjen e regjistrimit të patundshmërive të vakëfit. Të dhënat e kërkuara i dorëzuan rreth pesëdhjetë këshilla. Fikret Karcic, *po aty*, f. 271.

¹⁵⁹ Kryesia e Bashkësisë Islame në RSM, nr. protokoli 509, data 22.05.1991, dorëzuar në Qeveri më 23.05.1991, me nr. protokoli 23-1119/1.

Kërkesa e Kryesisë së BI për kthimin e xhamive të përmendura është e pasaktë dhe jokomplete, për çka nuk mund t'i përgjigjet nga aspekti pronësor-juridik dhe të propozohet zgjidhje e duhur për këtë çështje...¹⁶⁰

Duke filluar nga kjo periudhë Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë një nga prioritetet e veprimit të saj e ka pasur procesin e kthimit të pronave të uzurpuara të saj. Është fakt se në këtë proces janë bërë lëshime edhe nga ana e organeve të BFI-së, por ama edhe pushteti i ri nuk ka pasur gatishmëri për kthimin e pronave veçanërisht të atyre që i kanë takuar BFI-së.

Gjatë analizës së vakëfeve të cilat kanë ngelur në administrim të BFI-së në RMV është konstatuar se ato kryesisht përbëhen nga xhamitë, që një pjesë e madhe e tyre është ndërtuar në toka të reja të cilat janë vakëfuar nga vetë banorët myslimanë më vonë, disa teqe , si në Kërçovë, Strugë dhe Ohër, dhe disa dyqane në qytetet me popullsi më të dendur myslimane shqiptare, siç janë Shkupi (veçanërisht çarshia e vjetër), Tetova, Gostivari dhe Struga. Përveç këtyre pjesa më e madhe e pronave të vakëfeve që kanë ngelur nga periudha osmane janë uzurpuar në periudhat e pushteteve të ndryshme të cilat kanë udhëhequr me këto hapësira. Duhet theksuar se pjesa më e madhe e pronave aktuale të patundshme të BFI-së në RMV, si p.sh. Medreseja Isa Beu dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Kondovë të Shkupit, Dega e vajzave e medresesë Isa Beu në Shkup, Tetovë, Gostivar, godinat e Rijasetit të BFI-së, të myftinive të ndryshme, janë prona të vakëfuara në periudhën pas viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar.

¹⁶⁰ Shkresa dërguar Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Nr. 23-1119/1, i datës 08.07.1991, Shkup.

KAPITULLI I TRETË

DENACIONALIZIMI I VAKËFEVE NË RMV

3.1 Definicioni dhe historiku i denacionalizimit

Denacionalizimi në aspekt juridik e paraqet veprimin ligjor për deaktivizimin e akteve ligjore në lidhje me pronën e nacionalizuar. Në kontekst më të gjerë nacionalizimi e ngërthen ndërprerjen e akteve përmes të cilave prona private është transferuar në pronësi shtetërore, jo vetëm nga aspekti i nacionalizimit, por edhe në bazë të parimeve të tjera ligjore, siç është konfiskimi, dispozitat për reformën agrare, tejkalimi i maksimumit ligjor , etj. Ndërsa në kontekst më të ngushtë denacionalizimi nuk e ngërthen ndërprerjen e akteve ligjore të transferimit të pronës private në pronë shtetërore por vetëm aktet ligjore të cilat ai transferim i përplas me sistemin e ri juridik, gjegjësisht me rregullat ligjore të periudhës pas pavarësisë së Maqedonisë. Denacionalizimi në Republikën e Maqedonisë pas viteve të nëntëdhjeta është kornizuar me ligj në kontekstin e tij të ngushtë që shihet qartë nga Ligji për denacionalizim.¹⁶¹

Njëri ndër elementet më të rëndësishme në bazë të të cilit përcaktohet relacioni i shtetit të Maqedonisë me bashkësitë fetare është kthimi, denacionalizimi i pronës së bashkësive dhe organizatave fetare. Në sistemin e mëparshëm, në periudhën kur Maqedonia ka qenë pjesë e ish RSFJ-së, ka pasur procese të uzurpimit të pronës së bashkësive fetare nga ana e shtetit, gjegjësisht nga ana e Republikës Socialiste të Maqedonisë. Si rrjedhojë e këtyre proceseve është dëmtuar dukshëm bashkësia fetare dhe organizatat në kuadër të tyre. Pas pavarësisë së Maqedonisë si shtet demokratik dhe i pavarur, problemi i denacionalizimit të pronës është diksutuar si prioritarë në kontekst të përmirësimit të kësaj padrejtësie historike.

Ligji i parë për denacionalizimi është miratuar në 29.04.1998.¹⁶² Me këtë ligj bashkësitë fetare kanë qenë të përjashtuara nga procesi, për shkak se neni 1¹⁶³ e ka paraparë kthimin e pronës vetëm të personave fizik që janë shtetas të Maqedonisë. Kjo gjendje është përmirësuar me Ligjin

¹⁶¹ Закон за Денационализација, Службен весник на Р Македонија, бр.20/98 од 29.04.1998 год.

¹⁶² Закон за денационализација, Службен весник на Република Македонија, viti.: LIV,nr.: 20, 29.4.1998, fq. 1086-1091.

¹⁶³ Закон за денационализација, Службен весник на Република Македонија, viti.: LIV, nr.: 20, po aty.

për ndryshim dhe plotësim të ligjit për denacionalizim të miratuar në 20.04.2000¹⁶⁴, kur janë bërë ndryshime evidente në këtë ligj. Më konkretisht me nenin 1-a është zgjeruar përfshirja e denacionalizimit, në mes tjerash, edhe në kontekst të bashkësive fetare. Me këtë nen është paraparë që t'u kthehet e tërë prona bashkësive fetare, gjegjësisht, nëse ajo nuk do të jetë e mundshme, të kompensohet prona e uzurpuar e faltoreve, manastireve dhe vakëfeve të konfiskuara në mënyra të ndryshme pas 2 gushtit 1944. Gjithashtu duke patur parasysh: 1. Dispozitat ligjore në bazë të cilave është uzurpuar prona; 2. Dispozitat ligjore të uzurpimit të pronave për realizim të ndonjë interesi publik; dhe, 3. Uzurpimi pa bazë ligjore. Në këtë kontekst me rëndësi të veçantë është edhe neni 1-b i ligjit me të cilin janë definuar kategoritë “tempull fetar” (me të cilin nënkuptohet kishë krishtere dhe faltore, xhami islame, dhe sinagogë hebreje), si edhe “vakëf fetar” (me të cilin nënkuptohet pronë që nuk mund të tjetërsohet dhe i cili është i dedikuar për qëllime fetare dhe humanitare).¹⁶⁵

E drejta e denacionalizimit nuk është e drejtë për një gjë të caktuar (siç është e drejta e pronësisë), dhe as e drejtë për ndonjë veprim të caktuar (siç është e drejta për kompensim), por ajo është e drejtë e përfitimit të të drejtës në lidhje me ndonjë objekt të caktuar, gjegjësisht e drejtë tipike subjektive. Do të thotë sipas karakteristikave të veta, e drejta për denacionalizim është e drejtë potestative ose transformuese, pra e drejtë për arritjen e të drejtës subjektive për kompensim të pronës së uzurpuar ose i të drejtës së pronësisë së uzurpuar (restitucion). Si rrjedhojë, kjo e drejtë, nga aspekti juridik, është i kufizuar me kohë të caktuar.¹⁶⁶ E drejta e denacionalizimit arrihet sipas ligjit, në rastet kur janë të plotësuara supozimet ligjore të përcaktuara për një kohë të caktuar. Kjo e drejtë ndërpritet në rastet kur personi i autorizuar nuk parashton kërkesë për denacionalizim në afat të caktuar. Specifika e të drejtës për denacionalizim është në atë se ajo i takon vetëm personave fizik dhe subjekteve juridike në një rreth të caktuar dhe nuk mund të del jashtë këtij rrethi. Kjo e drejtë humbet në rastet kur personi i autorizuar nuk e realizon në proces konform mënyrës së përcaktuar me ligj. Për shembull në

¹⁶⁴ Закон за изменување и дополнување на Законот за денационализација, Службен весник на Република Македонија, viti.: LVI, nr.: 31, 20.4.2000, fq.: 1828-1830.

¹⁶⁵ Тања Каракамишева-Јовановска dhe Александар Спасеновски, *Прирачник за правото на верските заедници и за слободата на вероисповед во Република Македонија*, Shkup 2018, fq.62-64;

¹⁶⁶ Në lidhje me të drejtën potestative shih: Gams, A, *Uvod u gradjansko pravo*, Naučna Knjiga, Beograd, fq. 87-89.

nenin 11 të Ligjit për denacionalizim qartë është përcaktuar korniza e personave që e kanë të drejtën e denacionalizimit. Aty thuhet: *Të drejtën për të parashtruar kërkesë për denacionalizim ka pronari i mëparshëm, gjegjësisht, personat që janë trashëgimtarë të tij në ditën kur ky ligj ka hyrë në fuqi, në bazë të dispozitave të trashëgimisë.*

*Parashtruesi i kërkesës sipas alinesë 1 të këtij neni është personi i cili në ditën e miratimit të ligjit është shtetas i Republikës së Maqedonisë.*¹⁶⁷

Gjithashtu neni 5 i Ligjit për denacionalizim e tregon qartë karakterin e përkthuar më sipër të këtij ligji. Në këtë nen thuhet: Personat që sipas nenit 11 që sipas dispozitave të ligjit kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për kthimin e pronës, ose, për kompensim munden që në afat kohor prej pesë viteve pas hyrjes në fuqi të ligjit të kërkojnë kthimin e pronës ose marrjen e kompensimit. Sipas dispozitave të këtij ligji prej:

- 1) Çdo person që sipas nenit 3 , gjegjësisht nenit 13 alinea 1 të ligjeve të cituara në nenin 3 të këtij ligji nuk e ka dorëzuar me vetë dëshirë pronën e tij por e njëjta i është marrë jashtë vullnetit të tij dhe ka qenë i domosdoshëm ta dorëzojë, pa marrë parasysh si ajo pronë është bërë pronë e tij.
- 2) Farefisi i afërm i tij, gjegjësisht trashëgimtari që e ka trashëguar pronën e tij dhe nuk është në rrethin e personave që kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e kësaj prone ose marrjen e kompensimit për të, kur këtë të drejtë e kanë trashëgimtarët e pronarit të mëparshëm.¹⁶⁸

Gjithashtu edhe neni i 6 i Ligjit për denacionalizim e ngushton rrethin e kthimit të pronave të nacionalizuara, siç u sqarua më lartë. Në këtë nen thuhet:

Lëndë e denacionalizimit nuk është prona:

- 1) E marrur sipas Ligjit për revizion për dhënie të tokës për kolonizatorët dhe intersentët agrarë në Republikën Popullore të Maqedonisë dhe në Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë.

¹⁶⁷ Закон за Денационализација, Службен весник на Р Македонија, бр.20/98 од 29.04.1998 год. Neni 11.

¹⁶⁸ Закон за Денационализација, Службен весник на Р Македонија, бр.20/98 од 29.04.1998 год. Neni 5

- 2) I marrur si pasojë e humbjes së nënshtetësisë sipas fuqisë së ligjit ose në bazë të vendimit të plotëfuqishëm dhe
- 3) Për të cilën është bërë kontartë ndërshtetërore për kompensim për pronën e marrur.

Lëndë e denacionalizimit nuk është toka ndërtimore dhe prona e ekspropriuar, ndërsa çështjet pronësore të kësaj prone shqyrtohen në pajtim me dispozitat e ligjit për tokë ndërtimore dhe ekspropriim.

Lëndë e denacionalizimit nuk është toka bujqësore dhe pyjet të ngërthyera me arondacion, gjegjësisht komasacion, ndërsa çështjet pronësore të kësaj prone shqyrtohen në pajtim me dispozitat për arondacion dhe komasacion të tokës bujqësore dhe pyjeve.¹⁶⁹

Si pasojë e ngushtimeve dhe kufizimeve të cilat i ka bërë Ligji për Denacionalizim Bashkësia Fetare Islame në RMV që nga fillimi është përplasur me zhagjitje dhe probleme të mëdha në kontekst të kthimit të pronave të nacionalizuara dhe konfiskuara nga ana e shtetit. Ky realitet është shprehur edhe në shumë konferenca të organizuar në lidhje me problemin e denacionalizimit të pronës vakëfore të BFI-së në RMV. Në konferencën “Denacionalizimi- e drejtë pronësore” e organizuar nga Instituti për të drejtat e njeriut në bashkëpunim me zyrën e Bashkimit European në Shkup dhe Ambasadës së Hollandës, profesori Fidanço Stojçev, nga Fakulteti Juridik i Universitetit Shën Kirili në Shkup, do të konstatojë:

“ Ligji i miratuar që në fillim ishte shumë kontrovers dhe ka sjellur shumë kundërshti. Vetë miratimi i tij në një periudhë prej tre vitesh të jep përshtypjen se diçka po zihet pas shpine”.¹⁷⁰

Në lidhje me ligjin e denacionalizimit janë organizuar edhe debate të ndryshme ku kanë marrë pjesë zyrtarë të Bashkësisë Fetare Islame si dhe ekspertë juridik. Në debatin me temë “Ligji për denacionalizim dhe interpretimi i gabuar që prodhon diskriminim”, të organizuar nga Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë me ekspertë nga fusha e drejtësisë është nxjerrur përfundimi se Qeveria dhe institucionit shtetërore në Maqedoni po diskriminojnë BFI-në në kthimin e vakëfit duke kërkuar kështu që të bëhet ndryshime në ligjet ekzistuese me qëllim

¹⁶⁹ Закон за Денационализација, Службен весник на Р Македонија, бр.20/98 од 29.04.1998 год. Neni 6

¹⁷⁰ Vlerësimi i shkruar në lidhje me konferencën nga drejtori i vakëfeve pranë Bashkësisë fetare Islame z. Driton Dikena.

të lehtësimit të procedurës për kthimin e vakëfit. “Procesi i denacionalizimit në Maqedoni, zvarritet në mënyrë të padrejtë, gjë e cila e konfirmon përshtypjen e përgjithshme se shteti nuk ka qëllime të mirëfillta për ta zbatuar tërësisht procesin e denacionalizimit brenda afatit të paraparë, periudhë kohore e cila tanimë ka skaduar vite të tëra. Shteti me strukturat e tij, demonstrojnë një praktikë që japin shenja se nuk janë për bashkëjetesë multietnike, multifetare dhe demokratike”, janë fjalët e kryetar të BFI-së, Reis Ul Ulema Haxhi Sulejman ef. Rexhepi në fillim të debatit.

Analistët dhe ekspertët juridik në këtë debat vlerësuan se komuniteti mysliman në Maqedoni është i diskriminuar dhe se përfaqësuesit në qeveri të këtij komuniteti, nuk kanë ndërmarrë asgjë për të parandaluar këtë diskriminim. Juristët, gjithashtu, vlerësuan se duhet të rishikohen të gjitha ligjet për denacionalizim, të cilat janë kundër interesave të BFI-së dhe në kundërshtim me konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. “Mendoj që si pasojë e diktateve politike, pamundësohet procesi i kthimit të pronave të BFI-së sepse ky proces tashmë ka arritur finalen e saj, prandaj kjo qendër politike dikton disa rregulla të çuditshme që janë në kundërshtim me të gjitha parimet kushtetuese bile edhe me konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut me të cilën garantohet mbrojtja e të drejtave të pronësisë”, ishte konkluzja e profesorit universitar dhe ekspertit juridik Prof.dr.Jeton Shasivarit. Ai në vazhdim shtoi: Qasja e Qeverisë së Maqedonisë ka të bëjë me një padrejtësi historike dhe kulturore në emër të historisë dhe kulturës. Kjo, sipas tij, po ndodhë në Maqedoni dhe se nga miratimi i Ligjit për denacionalizim, në vitin 1998 pritjet kanë qenë shumë zhgënjyese dhe të pasuara më dëme të mëdha të bëra nga shteti. “Kthimi i pronave të BFIM do të avanconte pozitën e këtij institucioni dhe shteti do të përcillte një porosi humane dhe solidarizuese, që do të ishte pajtimi dhe paqja me BFIM dhe bashkësitë e tjera fetare. Mendoj se aparati shtetëror aktual duhet të jetë i vetëdijshëm se çdo shtet që qëndron mbi pronat e zaptuara apo konfiskuara, është në interes të tij që të çlirohet nga këto prona që s’janë të tyre. Mirëpo, me vendimet e fundit të Qeverisë, manifestohet një vullnet i kundërt me të gjitha këto që u përshkruan më sipër. Unë kam bindjen se, aktualisht, shteti po bën çmos që prona e BFIM të mos kthehet mbi bazën e ligjit për denacionalizim dhe në

këtë rast BFIM paraqitet si viktimë dhe palë e goditur”.¹⁷¹ Në vijë të njëjtë ishin edhe prononcimet e ekspertëve, Osman Kadriu, Agim Nuhiu, Arse Petrevski dhe të tjerë.¹⁷²

Si rrjedhojë e kësaj që u tha shihet qartë se konteskti i denacionalizimit të pronave në RMV është i kufizuar tej mase sipas ligjit si dhe, krahas deklaratave politike për kthimin e pronave në veçanti atyre të BFI-së, mosekzistimit të vullnetit për kthimin e tyre, dhe si rrjedhojë historiku i denacionalizimit dhe kthimit të pronave vakëfore të BFI-së në RMV është tejet i zbehtë.

3.2 Baza juridike e denacionalizimit të pronave në RMV

Pas ndryshimit të sistemit politik dhe ekonomik, dhe në bazë të përvojës të shteteve të tjera të të ashtuquajturit bllok komunist edhe Republika e Maqedonisë në vitin 1998 e solli Ligjin për Denacionalizim (i shpallur në gazetën zyrtare të RM me numrë 20/98 të datës 29.04.1998), i cili më vonë pati numër të konsiderueshëm të plotësimeve dhe ndryshimeve. Qëllimi i miratimit të këtij ligji ishte të përmirësohet një padrejtësi historike dhe ideologjike në relacion me pronarët (ose trashëgimtarët e tyre) për pronën që u ishte uzurpuar në kohën e sistemit të mëparshëm dhe t’u mundësohet atyre sërish ta përfitojnë të drejtën e pronësisë ndaj pronës së tyre. Miratimi i ligjit ishte në pajtim edhe me realizimin e të drejtës kushtetuese për pronësi si një prej të drejtave fundamentale. Sipas nenit 30 të Kushtetutës së RM-së, “ garantohet e drejta e pronësisë dhe e drejta e trashëgimisë. Askujt nuk mund t’i merrent ose t’i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat deduktohen nga ajo, në përjashtim të çështjeve të interesit publik të përcaktuar me ligj”. Përcaktimi kushtetues i lartëpërmedhur e garanton të drejtën e pronësisë edhe për kategorinë e qytetarëve të cilëve prona iu ishte marrur në bazë të dispozitave ligjore që ishin të plotfuqishme në një sistem tjetër ose pa ndonjë bazë ligjore.

¹⁷¹ Për më tepër, shih: <http://www.lajmeshqip.com/kombetare/shkup-politika-mban-peng-pronat-e-bashkesise-islame>

¹⁷² Për më tepër, shih në: <https://bfi.mk/ligji-per-denacionalizim-dhe-interpretimi-i-gabuar-qe-prodhon-diskriminim/>

Ligji për denacionalizim i RM-së e kishte këtë kornizë ligjore për denacionalizimin e pronave të nacioanlizuara:

- Me këtë ligj rregullohet mënyra, kushtet dhe procedura për kthim në pronësi të pronës, gjegjësisht kompensimi për persona fizik qytetarë të RM për pronën e marrur në dobi të shtetit”.
- Lëndë e denacionalizimit është prona e marrur pas 2 gusht 1944.
- Denacionalizimi do të bëhet për pronat të cilat kanë bërë nacioanlizim të përgjithshëm dhe kufizim të pronësisë.
- Pronat që janë nacionalizuar për interese të përgjithshme, pronë e ekspropriuar për interesa të përgjithshme.
- Pronat që janë nacionalizuar pa bazë juridike.¹⁷³

Nisur nga pengesat ekzistuese juridike ose pamundësia për kthimin e pronës së nacionalizuar për shkaqe objektive, Ligji ka paraparë edhe zgjidhje për mos kthimin e pronës dhe për dhënien e kompenzimit:

- Për pronën që deri në ditën e miratimit të këtij ligji person fizik ose juridik i tretë me vendim të organit kompetent e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi të.
- Për Fondin e bagëtisë së nacionalizuar.
- Për pronën që është në funksion për mbrojtjen e sigurisë së RM-së.
- Për pronën që shfrytëzohet nga institucionet shëndetsore dhe institucionet për mbrojtje sociale dhe fëmijërore dhe arsim shtetëror.

Përveç kësaj, Ligji për denacionalizim ua jep mundësinë edhe pronarëve të mëparshëm që gjatë marrjes së pronës u është dhënë kompensim material, të përfitojnë të drejtën për pronësinë të pronës në rast se e kthejnë kompensimin e marrur, dhe kjo bëhet sipas mënyrës dhe procedurës të rregulluar nga qeveria e RM-së.

¹⁷³ Закон за Денационализација, Службен весник на Р Македонија, бр.20/98 од 29.04.1998 год. Neni 2

Për realizimin e të drejtës për pronësi Ligji i ka paraparë provat e nevojshme që parashtruesi i kërkesës duhet ti dorëzojë deri te organet për denacionalizim, në mes të cilave edhe aktin e nacionalizimit të pronës. Nëse parashtruesi nuk e ka aktin e nacionalizimit ose i njëjti është në duart e shfrytëzuesit të njëjtin organ i denacionalizimit do ta sigurojë sipas detyrës zyrtare.

Me *Rregulloren për zbatimin e procedurës së denacionalizimit*, të miratuar me 23.05.2000 nga ana e qeverisë së RM-së më hollësisht rregullohet procedura dhe mënyra e kthimit të pronës së marrur, dokumentacioni i nevojshëm dhe dorëzimi i pronës pronarëve të mëparshëm dhe trashëgimtarëve të tyre. Me Rregulloren precizohen edhe provat për pronësi në rast të mospranisë të aktit të nacionalizimit. Si rrjedhojë në rastet kur kërkesë për denacionalizim të dorëzuar për pronë të nacionalizuar pa bazë juridike si dhe kur nacionalizimi i provës është realizuar në bazë të dispozitave dhe pronarit të mëparshëm nuk iu është dorëzuar akti i nacionalizimit si argument për identifikim mund të parashtrohet çdo provë që në mënyrë direkte ose indirekte e vërteton se pronën e ka në mbikqyrje shteti, dhe qeverisja lokale, institucioni publik, shoqëria publike ose ndonjë institucion tjetër publik.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për denacionalizim të vitit 2010 (Gazeta zyrtare e RM-së nr.72/10) edhe më tepër është degraduar kjo e drejtë. Me plotësimin e nenit 49 alineja 5 organi për denacionalizim pas skadimit të afatit nga alineja 3 (7 maj 2003) për kërkesën e pranuar do të përcaktojë kompenzim ndërsa do të kthehet vetëm prona për të cilën nuk janë paraqitur pengesa juridike ose faktike deri në ditën e vendimit meritore.

Nisur nga fakti se e drejta për pronësi është një prej të drejtave fundamentale të garantuara me kushtetutë dhe se kjo e drejtë numrit të madh të qytetarëve iu ishte uzurpuar për shkaqe ideologjike, Ligji për denacionalizim parasheh që procedura e denacionalizimit të jetë urgjente. Sipas Ligjit (neni 53 alineja 3) “Vendimin për denacionalizim, organi i denacionalizimit është obliguar ta sjellë më vonë në afat prej 6 muajsh nga dita e parashtrimit të kërkesës, ndërsa në raste të komplikuar më vonë 6 muaj pas zgjidhjes së kontestit të mëparshëm”.

Edhe pse korniza ligjore është e qartë prap se prap procesi i denacionalizimit në përgjithësi, ndërsa ai i pronës së BFI-së në veçanti është zhagitur. Zhagitja e procesit të denacionalizimit

i dëmton personat fizik dhe institucionet shoqërore (në këtë rast BFI-në) por e dëmton financiarisht edhe buxhetin e shtetit për shkak të punës shterpe të numrit të madh të komisioneve. Procedurat e pazgjidhura të denacionalizimit ndikojnë negativisht edhe në realizimit të projekteve të caktuara urbanistike në kuadër të qeverisjes lokale.

Procesi jo efikas i denacionalizimit e rrënon edhe imixhin e shtetit përshkak të mos respektit ndaj një të drejte fundamentale kushtetuese siç është e drejta e pronës.

Qëllimi kyç i Ligjit për denacionalizim (v. 2000) konsistonte në ndreqjen e gabimit të sistemit socialist i cili në ideologjinë e tij e kishte goditjen e dhunshme të pronës private si një "trajtë e panevojshme historike", gjë që në esencë përbënte njërin nga gabimet më të mëdha ekonomike dhe politike të këtij sistemi, sepse prona private paraqet virtytin kryesor të çdo njeriu apo subjekti, me ç'rast mbrojtja juridike e saj paraqet njërin prej funksioneve bazike të çdo shteti demokratik, sepse me mbrojtjen e saj ruhet edhe vetë stabiliteti politik dhe ekonomik i një vendi. Mirëpo vendimet e Qeverisë së Maqedonisë janë në relacion që prona e nacionalizuar e BFI-së të mos i kthehet asaj mbi bazën e Ligjit për denacionalizim dhe Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, ku BFI paraqitet si viktimë e dukurisë që në drejtësi quhet si "konfliktologji juridike", që shënon kundërthënien e një ligji me një ligj tjetër, bile edhe të dispozitave brenda të të njëjtit ligj, që shkakton pasoja mjaft negative për sigurinë dhe barazinë juridike të BFI-së si dhe të subjekteve të tjera.¹⁷⁴

Sjellja jo korrekte e qeverisë së Maqedonisë ndaj BFI-së dhe standardet e dyfishta janë evidente edhe në anulimin e disa aktvendimeve të komisioneve për denacionalizim nga ana e avokatit të popullit, siç konstaton edhe profesor Jeton Shasivari. Në vazhdim ai thotë: Aktvendimet e tilla anuluese të Komisioneve të Qeverisë janë absurde, kundër kushtetuese, të paligjshme, jo profesionale, të padrejta, arbitrare, promovojnë pasiguri dhe pabarazi juridike dhe janë të diktuar nga një qendër politike që përmes diktatit politik orvatet me mish e me shpirt të pengojë procesin e denacionalizimit të pronësisë në favor të BFI-së, në kundërshtim me bazat, rregullat dhe parimet juridike materiale dhe procedurale të

¹⁷⁴ Shasivari, Jeton, *Shteti që diskriminon në emër të fesë, historisë dhe kulturës*, 30 Maj 2011, <https://www.studentet.info/modules/ipboard/index.php?showtopic=44068>

sanksionuara në Kushtetutë, ligje të kësaj lëmie dhe konventa të ratifikuara ndërkombëtare. Në këtë drejtim, janë për t'u veçuar dy raste, edhe atë: së pari KAPANHANI në Shkup, me ç'rast, Qeveria përmes Komisionit të shkallës së dytë duke vendosur sipas kërkesës së Avokatit shtetërorë shpalli nul aktvendimin e shkallës së parë të Komisionit për denacionalizim me të cilin ishte miratuar kërkesa për denacionalizimin e këtij objekti në favor të BFI-së e, sipas të cilit objekti në fjalë edhe iu dorëzua në posedim BFI-së, dhe, së dyti, Teatri i Fëmijëve në Shkup, me ç'rast Komisioni për denacionalizim i cili më parë me aktvendim të shkallës së parë e kishte miratuar kërkesën në favor të BFI-së por, Komisioni i shkallës së dytë duke vendosur sipas ankesës së Avokatit shtetëror e kishte anuluar atë dhe kishte kthyer lëndën në rivendosje, me ç'rast tani i njëjti Komision e refuzon kërkesën e BFI-së për denacionalizimin e këtij objekti.

E përbashkëta e këtyre dy aktvendimeve konsiston në atë se Komisioni në fjalë në arsyetimin e tyre thirret në nenin 7, paragrafi 2, i Ligjit për denacionalizim ku thuhet se: "Lëndë të denacionalizimit nuk janë sendet dhe objektet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike të përcaktuara me ligj". Në këtë drejtim, nëse ju referohemi disa dispozitave kushtetuese, ligjore dhe të Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, atëherë praktikisht dëshmohet zbatimi i gabuar i të drejtës materiale në këto dy raste. Kushtetuta e vendit, në nenin 56 përcakton se: "...sendet dhe objektet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike të përcaktuara me ligj janë të mira me interes të përgjithshëm për Republikën dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë". Kushtetuta në nenin 8 si vlerë themelore të rendit kushtetues të vendit, përveç tjerash përcakton edhe: "sundimin e së drejtës, mbrojtjen juridike të pronësisë dhe humanizmin, drejtësinë sociale dhe solidaritetin" (pra, trashëgimia kulturore nuk është përcaktuar si vlerë themelore e rendit kushtetues). Poashtu, në paragrafin 2 përcaktohet se: "Në vendin tonë është e lirë çdo gjë që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj".

Kushtetuta në nenin 52, paragrafi 4, përcakton se: "Ligjet dhe dispozitat e tjera nuk mund të kenë efekt prapaveprues, përveç se përjashtimisht, në rastet kur kjo është më e favorshme për qytetarët". Ligji i veçantë për shpalljen e Çarshisë së vjetër të Shkupit për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë është miratuar më 15 tetor 2008, ndërkaq, kërkesat e BFI-së për rikthimin e këtyre dy objekteve datojnë që nga viti 2000. Ligji për pronësinë dhe të drejtat

e tjera sendore (05.03.2001) në dispozitën e nenit 16, paragrafi 2 përcakton se: "Sendet që në bazë të Kushtetutës ose me ligje të veçanta janë të shpallura për sende me interes të përgjithshëm për Republikën mund të jenë objekt i të drejtës së pronësisë të shtetit, përkatësisht të personave fizik dhe juridik".

Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (02.04.2004) në dispozitën e nenit 10, paragrafi 2 përcakton se: "Trashëgimia kulturore mund të jetë në pronësi të Republikës, të njësive të vetadministrimit lokal si dhe të personave të tjerë juridik dhe fizik". Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për denacionalizim (27.05.2010) në dispozitën e nenit 6 përcakton se: "Procedurat e filluara për denacionalizim deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji e, për të cilat nuk janë nxjerrë aktvendime të shkallës së parë, do të vazhdojnë sipas dispozitave të këtij ligji". Protokolli numër 1 (20.03.1952) i Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në dispozitën e nenit 1 përcakton se: "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare . Megjithatë, dispozitat e mësipërme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera". Problemi kryesor i aktvendimeve të mësipërme lidhur me rastin e KAPANHANIT dhe Teatrit të fëmijëve, konsiston në faktin e pamohueshëm se këto objekte (si dhe objekte të tjera) prej momentit kur i janë marrë BFI-së (nga ana e Qeverisë dhe Qytetit të Shkupit në periudhën e viteve 1948-1959), gjatë gjithë asaj kohe si dhe nga momenti i hyrjes në fuqi dhe i zbatimit të Ligjit për denacionalizim, nuk kanë qenë të përcaktuara me ligje të veçanta (pra, ligje që konkretisht dhe individualisht do t'i shpallnin ato si objekte me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike (ashtu siç kërkon Kushtetuta, neni 16-të i Ligjit mbi pronësinë dhe neni 7 paragrafi 2 i Ligjit për denacionalizim), por, një gjë e tillë është bërë me aktvendime konkrete të institucioneve të ndryshme kulturore (muzeume, ente, etj.) që janë bazuar në ligje të përgjithshme, sipër shembull, aktvendimi i 14.11.1967 që përcakton se KAPAN-HANI paraqet një përmendore me rëndësi historike për kulturën e që bazohet në Ligjin e ish-Jugosllavisë për mbrojtjen e përmendoreve

të kulturës të v. 1965. Që të jetë situata ende më paradoksale dhe ironike, aktvendimi mbi Teatrin e fëmijëve bazohet në Ligjin për shpalljen e Çarshisë së vjetër të Shkupit për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë të miratuar më 15 tetor 2008 (kurse procedura administrative e denacionalizimit të këtij objekti ka filluar 8-të vite para hyrjes në fuqi të këtij ligji), me ç'rast shtrohet pyetja: përse u soll ky Ligj i veçantë?! Është më se e qartë se shteti e solli këtë ligj vetëm e vetëm për të penguar procesin e denacionalizimit në favor të BFI-së e, jo për të ofruar mbrojtjen e veçantë të këtij objekti, sepse siç u morr vesh, sipas dispozitave të mësipërme ligjore, trashëgimia kulturore mund të jetë në pronësi edhe të personave fizik dhe juridikë (pra, edhe të BFI-së).¹⁷⁵

Përvoja nga shtetet ku ky proces është kryer shpejtë dhe në trajtë efikase, siç është Bullgaria, tregon se ky proces ka ndikuar pozitivisht në imixhin e shtetit si dhe sasia e investimeve të huaja është rritur në masë të madhe, ndërsa rasti nuk është i tillë në RMV.

3.3 Procesi i denacionalizimit të vakëfeve të BFI-së në RMV

Bashkësia fetare Islame në RMV e vetëdishme për rolin, rëndësinë dhe vlerën e vakëfit si nga aspekti juridik islam ashtu edhe nga aspekti i interesit të përgjithshëm të myslimanëve që nga pavarësia e Maqedonisë e deri më ditët e sodit vazhdimisht është përpjekur ta ruajë aktualitetin e kthimit të pronave të uzurpuara të saj në periudhën e monizmit. BFI në kontinuitet ka bërë përpjekje dhe kërkesa pranë organeve shtetërore për përmirësimin e padrejtësisë dhe krimit të madh që i është bërë BFI-së dhe myslimanëve të RMV-së nga sistemi i mëparshëm. Kjo padrejtësi, sipas deklaratave të organeve të BFI-së, që u ushtrua me dekada të tëra do të mund të zbutet vetëm me kthimin e pronës së uzurpuar të saj.

Organet kompetente të BFI-së menjëherë pas rënies së sistemit monist dhe vendosjes së sitemit demokratik në teritorin e RMV-së parashtrori kërkesat e nevojshme një pas një për kthimin e pronave që i ishin marrë BFI-së në forma të ndryshme. Bashkësia Fetare Islame në RMV me shkresë zyrtare të protokoluar me nr. 60 të datës 20.01.1992 iu drejtua komisionit juridik ligjdhënës pranë parlamentit të RM-së me kërkesë që urgjentisht të shqyrtohen lëndën

¹⁷⁵ Po aty.

e pronës së nacionalizuar nga sistemi i mëparshëm dhe ata t'i kthehn pronarit, gjegjësisht BFI-së. Komisioni fare nuk iu përgjigj kësaj kërkesë të Bfi-së dhe çështja u neglizhua. Kërkesë i është bërë edhe Minsitrisë së Financave të RM-së dhe ajo është përgjigjur me shkresë të datës 18.03.1997 të protokoluar me nr. 17-1681/1 e cila në BFI ka arritur tre muaj më vonë me datë 12.06.1997. Në përgjigjen e ministrisë thuhet që Parlamenti i Maqedonisë në mbledhjen e saj të 59 që u mbajt me datë 19.02. 1997 ka vendosur se pronat e BFI-së do të kthehen më vonë, pasi që parlamenti ta miratojë ligjin për denacionalizim.

BFI priti një kohë të caktuar me shpresë se parlamenti do ta miratojë ligjin për denacionalizim, por pasi ky ligj zvaritej dhe kaloi kohë e gjatë pa u miratuar, BFI sërish me datë 30.09. 1997 e përsëriti kërkesën e saj të protokoluar me nr. 03-872 deri tek parlamenti, mirëpo sërish nuk mori përgjigje.

Parlamenti i RM-së për kthimin e pronave pronarëve të saj në vitin 1998 e miratoi ligjin për denacionalizim. Në ligjin e miratuar nga parlamenti nuk përfshihej prona e vakëfit. Mirëpo, me intervenim të BFI-së dhe KOM-it në RM me 10.03.2000 komisioni juridik i propozoi parlamentit për ndryshim të ligjit për denacionalizim, me numër protokolar 33-1048/1. Parlamenti debatoi në lidhje me propozimin me datë 14.04.2000 dhe si rrjedhojë u bënë disa ndryshime në këtë ligj sipas propozimit të qeverisë. Në ndryshimin e ligjit për denacionalizim, nenit 2 iu shtua alineja si më poshtë: “Kthehet prona, gjegjësisht kompenzohat prona e personave fizik dhe tempujve fetar, manastireve dhe vakëfeve të marra pas 2 gusht 1944”. Edhe pse ky ligj e parasheh kthimin e pronës vakëfore, prapë se prap BFI-së nuk do ti kthehet e tërë prona, por do ti kompenzohet dhe ky kompensim ishte tejet relativ dhe vlerësimet u bënë me standarte të ndryshme. Ligji gjithashtu le mundësi të komentimeve të ndryshme e cila gjë vitet pas miratimit të ligjit u tregua e dëmshme në relacion me kthimin e pronave të BFI-së.¹⁷⁶

Edhe pse pjesa dërmuese e pronës së vakëfit kishte përjetuar shkatërrime, veçanërisht në Maqedoninë lindore, prap se prap pushteti u detyrua të njohë të drejtën e kthimit në pronësi të disa vakëfeve të cilat kanë qenë të regjistruara si prona të BFI-së në Maqedoni. Edhe në

¹⁷⁶ Bislimi, Taxhedin, *Vakëfi në Maqedoni 1391-2001*, Shkup, 2007, fq. 96-97.

këtë proces janë bërë keqpërdorime duke i shlyer pronat nëpërmjet organeve kadastrale ose nëpërmjet të zvarritjeve të ndryshme nga qeverisja lokale. Si rrjedhojë pjesa dërmuese e pronës së vakëfit që aktualisht është regjistruar si pronë e BFI-së përbëhet nga xhamitë dhe varrezat, kurse prona e cila sillte përfitime ekonomike, për të cilin ishte i dedikuar vakëfi, siç janë dyqanet, shtëpitë, hamamet, hanet dhe toka pjellore përbëjnë vetëm një sasi simbolike në krahasim me pronën e vërtetë të vakëfit. Zyrtarët e BFI-së pohojnë se kanë parashtruar 350-70 kërkesa, prej të cilave vetëm 15% e pronës së vakëfit është kthyer, për 30% është dhënë kompensim, kurse 55% e kërkesave është refuzuar. Gjithashtu, zyrtari i BFI-së Driton Dikena konstaton se problemi i kthimit të vakëfeve të BFI-së është problem që e neglizhon çdo qeveri e Maqedonisë që nga pavarësia e këndeje.¹⁷⁷

Më poshtë do të paraqesim, sa për ilustrim pronën aktuale të vakëfit sipas regjistrave kadastral që janë në arkivin e BFI-së për qytetin e Tetovës, pasi ky rajon e përbën edhe boshtin e studimit tonë.

TABELA 2:

Prona e vakëfit në qytetin e Tetovës¹⁷⁸:

Numri i parcelës	Sipërfaqja në m2
6352-6452-9453	62.2442
4181-4044	36.531
2809	1.756
1920	586
2085	943
2320	603
Totali	102.661 m2

¹⁷⁷ Për më tepër, shih në: <https://makfax.com.mk/makedonija/%D0%B8%D0%B2%D0%B7-%D0%BE%D0%B1%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%B8%D1%81%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%BE%D1%84%D0%BE%D0%B1%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%BE%D1%82%D0%B8-%D0%B4%D1%80%D0%B6%D0%B0/>.

¹⁷⁸ Libri kryesorë i evidencës interne të të BFI-së për Tetovën

TABELA 3:

Prona e vakëfit në fshatrat e qytetit të Tetovës¹⁷⁹:

Fshati	Numri i parcelës	Sipërfaqja në m2
Çellopek	2085-2675-2501	43.447
Dobrosht	1311-1345-1285	1.152
Gajre	777	770
Gjermë	1137	1.070
Grupçin	1227	2.537
Reçicë	176	1.660
Sllatinë	746	2.044
Sellcë	2271-2181-2180	70.860
Sedllarcë	1616	327
Sellcë e keqe	505	421
Saraqinë	473	733
Përshevcë	546-547-649-717-731-808- 809-821-1217-4-5/3-5/4-98- 99-102-475	78.981
Tearcë	897-898-1164	4.564
Novo sellë	602-1122	24.497
Novakë	203	445
Merovë	1256-797-835	67.581
Kopanicë	318	144
	Totali	302.233 m2

¹⁷⁹ Libri kryesorë i evidencës interne të të BFI-së për fshatrat e Tetovës

3.4 Praktika gjyqësore, administrative dhe analiza e përgjithshme e lëndëve të denacionalizimit të pronave në RMV

Gjatë analizës së kërkesave të parashtruara nga ana e BFI-së në drejtim të komisionit për denacionalizim është evidente se një numër i konsiderueshëm i lëndëve janë refuzuar për shkak të përjashtimeve të cilat i bënë Ligji për denacionalizim në kontekst të moskthimit të pronave të nacionalizuara dhe të cilat në mënyra të ndryshme u janë bartur personave të tretë. Gjithashtu haset edhe në kërkesa të cilat janë refuzuar për shkak të dokumentacionit të pa kompletuar si dhe skadimit të afateve. Për të shërbyer si shembull ne këtu do të paraqesim tre lëndë për denacionalizim të BFI-së prej të cilave njëra është kthyer, e dyta është kompensuar dhe e treta është refuzuar.

d) Kërkesa për denacionalizim e Myftinisë së Shkupit me numër 19-08-715/1 (38) e datës 07.09.2000.

Ministri i financave nëpërmjet të komisionit për vendosje në lidhje me kërkesat për denacionalizim të parashtruara nga zyrtarët e objekteve fetare dhe bashkësive fetare në RM me selinë në Ministrinë e financave e shqyrtoi kërkesën për denacionalizim të Myftinisë së Shkupit me numër 19-08-715/1 (38) e datës 07.09.2000, në bazë të nenit 15 alineja 2 të ligjit për denacionalizim dhe vendimit të komisionit të qeverisë së RM-së për zgjidhjen e çështjeve administrative të shkallës së dytë në fushën e denacionalizimit numër 47-247-37/2 të datës 13.03.2004, në pajtim me nenin 205 të ligjit për procedurë të përgjithshme administrative me datë 13.08.2009 e solli këtë

VENDIM

1. Kërkesa për denacionalizim e Myftinisë së Shkupit me numër 19-08-715/1 (38) e datës 07.09.2000 për pronë të patundshme me PK 4957 KK Shkup – MIRATOHET.
2. Prona e patundshme tokë nën ndërtesë që paraqet pjesë të PK 4957 KK Shkup sipas matjes së vjetër; kurse sot: PK 9359 me sipërfaqe 1091 m², PK 9346 me sipërfaqe 28 m², PK 9345 me sipërfaqe 42 m², PK 9351 me sipërfaqe 34 m², PK 9352 me sipërfaqe 26 m², PK 9353 me sipërfaqe 33 m², PK 9354 me sipërfaqe 58 m², PK 9355 me sipërfaqe 27 m², PK 9356 me sipërfaqe 54 m², PK 9357 me sipërfaqe 41 m² dhe PK 9358 me sipërfaqe 41

m2- të gjitha në KK Qendër 1 (në total 1475 m2 tokë nën ndërtesë) si dhe obor me sipërfaqe 322 m2 të PK 9359.

3. Prona e patundshme hapësirë afariste në PK 4957 KK Shkup sipas matjes së vjetër (Kapan An) sot PK 9359 KK Qendër 1.¹⁸⁰

e) Kërkesë për denacionalizim me numër 19-385/07-2 e datës 20.11.2007 e parashtruar nga Myftinia e Shtipit këshilli i Xhamisë Pekçevë

Ministri i financave nëpërmjet të komisionit për vendosje në lidhje me kërkesat për denacionalizim të parashtruara nga zyrtarët e objekteve fetare dhe bashkësive fetare në RM me selinë në Ministrinë e financave e shqyrtoi kërkesën për denacionalizim të Myftinisë së Shtipit këshilli i Xhamisë Pekçevë me numër 19-385/07-2 e datës 20.11.2007, në bazë të nenit 15 alineja 2 të ligjit për denacionalizim me datë 29.10.2009 e solli këtë

VENDIM

1. Kërkesë për denacionalizim me numër 19-385/07-2 e datës 20.11.2007 e parashtruar nga Myftinia e Shtipit këshilli i Xhamisë Pekçevë – MIRATOHET
2. Për pronën e patundshme në vendin e quajtur varrezat turke me sipërfaqe 20.000 m2 (2 hektar) e marrur nga shteti pa bazë juridike sipas Ligjit për reforma agrare përcaktohet kompensim 220.000 denarë.

Mënyra e kompensimit do të precizohet me vendim shtesë¹⁸¹.

f) Kërkesë për denacionalizim me numër 19-08-580/1 (554) e datës 14.05.2002 e parashtruar nga Myftinia e Shkupit

Ministri i financave nëpërmjet të komisionit për vendosje në lidhje me kërkesat për denacionalizim të parashtruara nga zyrtarët e objekteve fetare dhe bashkësive fetare në RM me selinë në Ministrinë e financave e shqyrtoi kërkesën për denacionalizim të

¹⁸⁰ Më detajisht në vendimin origjinal në pjesën e Shtojcës së këtij punimi.

¹⁸¹ Më detajisht në vendimin origjinal në pjesën e Shtojcës së këtij punimi.

Myftinisë së Shkupit me numër 19-08-580 (554) e datës 14.05.2002, në bazë të nenit 15 alineja 2 të ligjit për denacionalizim dhe nenit 205 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative me datë 12.01.2009 e solli këtë:

VENDIM

Kërkesë për denacionalizim me numër 19-08-580/1 (554) e datës 14.05.2002 e parashtruar nga Myftinia e Shkupit për pronë të patundshme BEZISTEN në PK 3443/1 KK Shkup **REFUZOHE** SI E PABAZË.

Në këtë lëndë e cila është refuzuar komisioni për denacionalizim si fakt për moskthimin e pronës në fjalë e ka paraqitur se prona kur është nacionalizuar nuk i ka takuar BFI-së por Përfaqësisë së Vakëfit, që në realitet janë dy emra të ndryshëm të subjektit të njejtë¹⁸².

Në bazë të dhënave të marrura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga BFI e RMV situata me procesin e denacionalizimit të pronave të saj është si më poshtë:

TABELA 4:

Situata e lëndëve për denacionalizim në BFI të RMV

Kërkesa të dorëzuara për denacionalizim	Sipërfaqe tokësore	Sipërfaqe të ndërtuara	Të procesuara
370 kërkesa	4 milion m2(fusha, livadhe,tokë ndërtimore	42.000 m2(shtëpi, dyqane, hamame, hane)	200 kërkesa
74 kërkesa (20%) të përfunduara pozitivisht	40 kërkesa të përfunduara pozitivisht dhe pronë e kthyer.	34 kërkesa të përfunduara pozitivisht dhe objekte të kthyer.	170 kërkesa nuk janë të pocesuara ende, ndërsa 126 janë të kompensuara me letra me vlerë

¹⁸² Më detajisht në vendimin origjinal në pjesën e Shtojcës së këtij punimi.

KAPITULLI I KATËRT

DENACIONALIZIMI I PRONAVE TË VAKËFIT TË BFI-SË NË RAJONIN E TETOVËS

4.1 *Procesi i denacionalizimit në kuadër të Myftinisë së BFI-së në Tetovë*

Myftinia e Tetovës është njëra nga myftinitë me dendësi më të madhe të besimtarëve myslimanë si rrjedhojë e kësaj edhe me praninë e pronave të vakëfit në RMV. Procesi i denacionalizimit të pronave vakëfore që nga vitet e nëntëdhjeta ka qenë një prej çështjeve më me prioritet edhe në myftininë e Tetovës. Krahas objekteve të tjera dhe tokës pjellore veçanërisht në fshatrat e Tetovës interesi kryesor i organeve të myftinisë së Tetovës ka qenë në kthimin e pronës së kompleksit Harabati Baba Teqe si dhe shtëpisë përmirësuese e cila në matjet e mëparshme ka qenë pjesë e kompleksit të Harabatit.

Myftiu i Tetovës Prof.dr. Qani Nesimi në prononcimin e tij në lidhje me denacionalizimin e pronave të BFI-së në rajonin e Tetovës, në mes tjerash thotë: Çështja e denacionalizimit të pronave në BFI- Myftinia e Tetovës, vazhdon të jetë në kontinuitet një çështje serioze dhe e pazgjidhur. Kjo, sipas mendimit tim, është rezultat i mungesës së vullnetit politik për kthimin e tyre. Në Tetovë, edhe nëse është kthyer diçka, ajo është shumë pak në krahasim me atë që duhet të kthehet. Kemi prona që me dokumente janë pronë e BFI-së, kurse me dekada janë në procedurë gjyqësore, siç është Harabati Baba Teqe dhe mendoj se në bashkëpunim me Rijasetin dhe në veçanti me Reisu'l-ulemanë ta intensifikojmë këtë çështje në myftininë e Tetovës.¹⁸³

Kompleksi i Harabati Baba Teqesë si lëndë është zvarritur një periudhë të gjatë për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me çështjen se kujt i takon pronësia e këtij kompleksi. Edhe pse kompleksi i Harabati Baba Teqesë në dokumentet zyrtare kur është nacionalizuar figuron si pronë e BFI-së së RMV, në lidhje me këtë kompleks, duke u bazuar në dokumentet më të vjetra pronësore, nga periudha e shtetit osman, kërkesë për t'iu kthyer ka bërë edhe Bashkësia Bektashiane e Maqedonisë. Si rrjedhojë e përzierjeve të shumta edhe nga politika ditore denacionalizimi i këtij kompleksi është zvarritur afro dy dekada. Më poshtë do të paraqesim

¹⁸³ Intervistë e Myftiut Prof.dr. Qani ef. Nesimit dhënë gazetës Hëna e Re pranë BFIM-së, 11 prill 2015, <http://myftiniatetove.com/interviste-e-myftiut-prof-dr-qani-ef-nesimit-dhene-gazetes-hena-e-re-prane-bfim-se/>

lëndët e denacionalizimit në lidhje kompleksin e Harabati Baba Teqesë i cili është kthyer në tre pjesë, si: Harabati Baba Teqe, Shtëpia Përmirësuese, dhe pjesa e tokës në afërsi të varrezave të qytetit. Krahas kësaj do të paraqesim edhe një lëndë të katërt në lidhje me denacionalizimin e vakëfit të BFI-së që është toka në afërsi të shkollës së muzikës në Tetovë.

4.2 Denacionalizimi i Harabati Baba Teqesë

Myftinia e Tetovës në kuadër të BFI-së të RMV-së padyshim e paraqet institucionin më të suksesshëm në kuadër të këtij institucioni për sa i përket denacionalizimit të pronave të saja. Veçanërisht pas emërimit për myfti të kësaj myftinie të Prof.dr. Qani Nesimit ky proces ka marrur hov edhe më të madh dhe si pasojë i janë kthyer disa objekte dhe vende të rëndësishme në qytetin e Tetovës.

Në mesin e objekteve të denacionalizuara Kompleksi i Harabati Baba Teqesë është objekti më i rëndësishëm i cili falë përpjekjeve maksimale të organeve të myftinisë në krye me myftiun i është kthyer BFI-së në RMV. Procesi i denacionalizimit të këtij kompleksi është ndjekur me peripeci të shumta pasi për kthim të kësaj prone është paraqitur si pronar edhe Bashkësia Bektashiane në RMV.

Kompleksi i Harabati Baba Teqesë është edhe më i rëndësishëm për shkak se është edhe një prej monumenteve më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore historike të myslimanëve dhe shqiptarëve në këto troje. Harabati Baba Teqe është një nga katër teqetë më të rëndësishme bektashiane në botë dhe si e tillë edhe vizitohet nga shumë vizitorë të huaj si nga orienti ashtu edhe oksidenti.

Harabati Baba Teqeja ka funksionuar si teqe duke filluar prej themelimit të saj në shekullin e XVI e deri në vitet e luftimeve ballkanike 1912-13, ndërsa pas kësaj një periudhë të caktuar nuk ka funksionuar për shkak të turbulencave politike dhe ndërrimit të njëpasnjëshëm të pushteteve në këto hapësira. Kështu ka vazhduar deri në vitin 1943 kur prej Elbasani në këtë teqe është emëruar për baba i teqes Baba Kazim Bakalli, një intelektual i shquar shqiptar, dhe ai së bashku me disa dervish bektashi të tjerë e ka hapiur sërish teqen dhe ajo ka funksionuar deri në vitin 1948, kur Baba Kazim Bakalli është dëbuar prej Tetovës nga ana e pushtetit dhe ai është vendosur në teqenë bektashiane të Gjakovës. Prej vitit 1948 e deri në vitet e gjashtëdhjeta të sheklullit XX sërish

teqeja ka qenë e mbyllur. Në vitet e gjashtëdhjeta fabrika e tekstilit “Teteks” në Tetovë e ka restauruar kompleksin dhe aty ka hapur një restorant i cili ka punuar deri në luftën e vitit 2001. Në ndërkohë në vitin 1994 një grup i bektashinjëve nën udhëheqjen e Baba Tahirit nga Tetova kanë hyrë në teqe duke bërë grevë urie dhe si rrjedhojë u është lejuar që të vendosen në një pjesë të teqes ku vazhdojnë të qëndrojnë edhe sot e kësaj dite. Pas viti 2001 edhe BFI-ja është inkuadruar në objektet e kompleksit të teqesë dhe e ka hapur për adhurim pjesën e xhamisë në kuadër të kompleksit dhe aty edhe sot e kësaj dite vazhdohet me faljen e namazit dhe adhurimeve të tjera fetare të organizuara nga BFI-ja. Krahës këtyre orvatjeve BFI vazhdimisht ka kërkuar prej instancave shtetërore që prona t’i kthehet BFI-së dhe ky proces ka përfunduar në vitin 2017 kur kompleksi i është kthyer BFI-së.

Ministri i financave nëpërmjet të komisionit për vendosje në lidhje me kërkesat për denacionalizim të parashtruara nga zyrtarët e objekteve fetare dhe bashkësive fetare në RM me selinë në Ministrinë e financave e shqyrtoi kërkesën për denacionalizim të Myftinisë së Tetovës me numër 17-4/1 (1708/4) e datës 09.01.2001, në bazë të nenit 15 alineja 2 të ligjit për denacionalizim me datë 31.08.2015 e solli këtë

VENDIM

1. Kërkesa me numër 17-4/2 (1708/4) e datës 09.01.2015 e parashtruar nga BFI-Myftinia e Tetovës, **MIRATOHET**
2. Prona e patundshme me sipërfaqe prej 18,374 m² në KK Tetovë, më poshtë e sqaruar në hollësi së bashku me objektet që i ka në kuadër (shih: Shtojca), e nacionalizuar në dobi të shtetit me Vendim për nacionalizim të tokës ndërtimore për Muzeun e Tetovës me numër 01-7467 e datës 26.09.1966 e miratuar nga Këshilli i komunës së Tetovës i kthehet në pronësi parashtruesit të kërkesës Bashkësia Fetare Islame- Myftinia e Tetovës në Republikën e Maqedonisë.
3. Për vlerën e shtuar të pronës së patundshme sipas nenit të 2 të këtij vendimi do të vendoset me vendim të veçantë.

4. Gjithashtu BFI-së-Myftina e Tetovës për pjesët e uzurpuara mbi kompleksin e teqes i jepet kompensim prej 61.000,00 denarë. Edhe kjo pjesë hollësisht me numra të parcelave e sqaruar në vendim (Shih: Shtojcë).

Në arsyetimin e Vendimit të denacionalizimit në mes tjerash është theksuar si më poshtë: Komisioni për denacionalizim më parë pas kërkesës së parashtruar nga Myftinia e Tetovës ka vendosur që prona t'i kthehet pjesërisht pronarit të mëparshëm, por ndaj këtij vendimi është ankuar Myftinia e Tetovës dhe lënda është bartur në komisionin e shkallës së dytë. Komisioni në datën 13.04.2011 e ka pranuar ankesën e Myftinisë së Tetovës dhe e ka anuluar vendimin e miratuar të datës 09.04.2010. Në procedurën e dytë komisioni për vendim në lidhje me kërkesat për denacionalizim vendosi që në lidhje me këtë lëndë të vendosë me vendim ri.

Me vendimin e komisionit nuk është pajtuar Avokati Publik i Republikës së Maqedonisë dhe ka dorëzuar padi deri te Gjykata administrative e cila e refuzoi ankesën e prokurorisë së Tetovës me vendim numër 1332/2011 të datës 09.05.2013. Prokuroria e Tetovës për lëndën u ankua më pas në Gjykatën e Lartë Administrative të Republikës së Maqedonisë i cili e pranoi ankesën e prokurorisë dhe e anuloi vendimin e sjellur të gjykatës administrative.

Si rrjedhojë komisioni për denacionalizim sërish e mori në shqyrtim lëndën dhe vendosi si më poshtë: Komisioni i morri në shqyrtim të gjitha dokumentet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës (në Arsyetimin e vendimit janë të paraqitura të gjitha dokumentet e dorëzuara nga Myftinia e Tetovës; shih: Shtojcë) dhe vajti për ta konstatuar gjendjen faktike në teren dhe e paraqiti në hollësi historikun e zhvillimit të parcelave që i takojnë kësaj lënde. Më pas i paraqiti edhe nenet që e arsyetojnë kthimin e kësaj prone Myftinisë së Tetovës dhe si pasojë vendosi siç është e paraqitur në këtë Vendim.

E vendosur në Shkup me datë 31.08.2015 me numër 17-4/3(1708/4)-4.

Vendimi është bërë i plotfuqishëm me datë 31.07.2017.¹⁸⁴

¹⁸⁴ Më detajisht në vendimin origjinal në pjesën e Shtojcës së këtij punimi.

4.3 Denacionalizimi i Shtëpisë përmirësuese në Tetovë

Shtëpia përmirësuese në Tetovë, gjithashtu, është pjesë e kompleksit të Harabati Baba Teqesë i cili në periudhën e RSFJ-së është ndarë nga kompleksi dhe i është dhënë në shfrytëzim Shtëpisë përmirësuese në Tetovë.

Ministri i financave nëpërmjet të komisionit për vendosje në lidhje me kërkesat për denacionalizim të parashtruara nga zyrtarët e objekteve fetare dhe bashkësive fetare në RM me selinë në Ministrinë e financave e shqyrtoi kërkesën për denacionalizim të Myftinisë së Tetovës me numër 19-227/1(1708)62 e datës 07.05.2002, duke vendosur sipas vendimit të gjykatës administrative numër 756/2015 e datës 27.10.2016 në bazë të nenit 15 alineja 2 të ligjit për denacionalizim me datë 01.02.2017 e solli këtë

VENDIM

1. Kërkesa për denacionalizim me numër 19-227/1 (1708)62 e datës 07.05.2002 e parashtruar nga BFI-Myftinia e Tetovës, MIRATOHET
2. I kthehet në pronës BFI-Myftinisë së Tetovës prona e patundshme që paraqet tokë me sipërfaqe 41.654 m² e sqaruar më hollësisht në vazhdim të vendimit (shih: Shtojcë) e cila është nacionalizuar nga pronari në dobi të shtetit sipas ligjit për reformë agrare numër 14-3245/1 e datës 22.05.1984 të këshillit të komunës së Tetovës.
3. Për vlerën e shtuar të pronës së patundshme sipas nenit 2 të këtij vendimi do të vendoset me vendim të veçantë.

Në arsyetimin e vendimit komisionit në trajtë të hollësishme është paraqitur historiku i ecurisë së procedurës së denacionalizimit në lidhje me kthimin e pronës së patundshme që ishte në shfrytëzim të shtëpisë përmirësuese në Tetovë. Edhe kjo lëndë si kompleksi Harabati Baba Teqe disa herë është ankimuar nga prokuroria shtetërore e Tetovës deri te Gjykata Administrative dhe i është kthyer sërish në shqyrtim komisionit të shkallës së dytë të denacionalizimit.

Në fund, duke u bazuar në nenin 218 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi

E vendosur në Shkup, me datë 01.03.2017 me numër 19-227/4 (1708)62.

Vendimi është bërë i plotfuqishëm me datë 03.11.2017.¹⁸⁵

4.4 Denacionalizimi i PK 3530, KK Tetovë-1 (në afërsi të varezave) në Tetovë

Prona në fjalë është pjesa e cila aktualisht shfrytëzohet në kuadër të varrezave të qytetit të Tetovës dhe në kuadër të së cilës është ndërtuar edhe Objekti për shërbime fetare dhe sociale (i inauguruar me datë 15 Maj 2019). Kjo pjesë i është marrur nga pronësia BFI-së duke u regjistruar në emër të shtetit, gjegjësisht, Republikës së Maqedonisë pa bazë juridike. Si rrjedhojë myftinia e Tetovës e ka paditur shtetin dhe pas disa seancave gjyqësore ndihmës prokurori i Shtetit ka vendosur si më poshtë:

Padia e paditësit Bashkësia Fetare Islame-Myftinia e Tetovës , kundër RM-së në bazë të faktit për regjistrim pa bazë juridike, MIRATOHET.

Konstatohet se është bërë regjistrim pa bazë juridike në kontekst të të drejtave të evidencës kadastrale e PK 3530 në vendin e quajtur Teqja e Sipërme dhe një pjesë e Vreshtave me P.K. 6241 me sipërfaqe 27.666 m2.

Obligohet e paditura RM që të ndryshojë evidencën në librat gjegjëse dhe prona e mësipërme të evidentohet në emër të pronarit Myftinia e Tetovës.

Siç shihet kjo lëndë është shembull i regjistrimit jo adekuat dhe pa bazë juridike të pronës së vakëfit në emër të shtetit. Raste të tilla me vakëfet, veçanërisht në Maqedoninë Lindore, ka shumë.

Në kuadër të vendimit hollësisht është paraqitur edhe historiku i zhvillimit të procesit të kthimit të kësaj prone të patundshme.

E vendosur në Gjykatën themelore Tetovë me datë 02.11.2007 me numër 29/07.

¹⁸⁵ Më detajisht në vendimin origjinal në pjesën e Shtojcës së këtij punimi.

4.5 Privatizimi i tokës ndërtimore me numër PK. 1645, KK Tetovë-1 (afër shkollës së muzikës) në Tetovë.

Rasti i parcelës ndërtimore në afërsi të shkollës së muzikës, ku ka pasur një xhami të vogël e quajtur Fevrije, në të cilën tash janë ndërtuar objekte afariste dhe objekte banimi, është një rast tjetër i keqpërdorimit të pronës së vakëfit nga ana e shtetit. Kjo parcelë i është marrur BFI-së vetëm me vendim të këshillit të komunës por nuk i është hequr pronësia. Si rrjedhojë, pas miratimit të ligjit për privatizim myftinia e Tetovës ka parashtruar kërkesë për privatizim të kësaj prone të patundshme dhe Zyra për çështje pronësore juridike pranë Ministrisë së financave, si rrjedhojë e kërkesës për privatizim nga ana e Myftinisës së Tetovës me numër 19-664/1 të datës 05.06.2007 dhe në bazë të nenit 29 të Ligjit për privatizim të tokës ndërtimore (Gazeta zyrtare e RM numër 4/05) dhe nenit 205 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative solli

VENDIM

Për privatizim të tokës ndërtimore në bazë të pronësisë së mëparshme

1. Kërkesa për privatizim të tokës ndërtimore me numër 19-664/1 e datës 05.06.2007 , në bazë të pronësisë së mëparshme, **MIRATOHET**.
2. Toka ndërtimore në pronësi të shtetit e evdientuar në P:K: 1645, objekt 131 m2, obor 1104 m2 dhe sipërfaqe në tërësi 1235 m2 në KK- Tetovë, privatizohet.
3. Toka ndërtimore sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi privatizohet në pronësi të BFI-Myftinia e Tetovës me numër BDS 409676.

Në arsyetimin e vendimit janë të paraqitura në hollësi dokumentet e parashtruara nga myftinia për argumentim të pronësisë si dhe historiku i zhvillimit të procedurës së privatizimit.

E vendosur në Misnitrinë për Financa- Zyra për çështje pronësore juridike- njësia rajonale në Tetovë me datë 05.07.2007, me numër 19-664/2.

Vendimi është bërë i plotfuqishë, me datë 25.07.2007.¹⁸⁶

¹⁸⁶ Më detajisht në vendimin origjinal në pjesën e Shtojcës së këtij punimi.

Katër lëndët e kthimit të pronës së patundshme nga ana e Myftinisë së Tetovës janë ilustrime shumë adekuate për mënyrat e nacionalizimit dhe konfiskimit të vakëfit të BFI-së në RMV. Gjithashtu, duhet të thuhet qartë se kthimi i këtyre pronave vakëfore në kuadër të Myftinisë së Tetovës është bërë si rrjedhojë e angazhimit maksimal të organeve të myftinisë në krye me myftiun e Tetovës. Një angazhim i tillë dhe më i gjallë i organeve të BFI-së edhe në viset tjera , ndoshta do ta zbuste sadopak gjendjen e mjerrueshme të BFI-së në kontekst të kthimit të pronave të vakëfit.

TABELA 5:

Situtata e lëndëve për denacionalizim në Myftininë e Tetovës të BFI në RMV

Kërkesa	Prona tokësore	Kompensim	Të refuzuara	Pa përgjigje
90-100 kërkesa	18-20 lëndë 20%	10 lëndë 10%	30 lëndë 30%	40 lëndë 40%

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Legjislacionet moderne të vendeve perëndimore nuk e njohin konceptin e vakëfit, por përmbajnë koncepte të ngjashme me karakterin e tij. Pra, ka shprehje të shumta, sipas kuptimit dhe përdorimit, të ngjashme me vakëfin, të cilat pranohen në përputhje me zhvillimin kulturor, politik dhe ekonomik të këtyre vendeve. Kështu, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ky sektor më shpesh quhet: sektori jofitimprurës (nonprofit sector), në Angli sektori vullnetar (voluntary sector), sektori i ekonomisë sociale në Francë, Gjermani (verien) etj. Përveç këtyre termave, përdoren edhe terma të tjerë, si: sektori i tretë, sektori bamirës, organizatat e shoqërisë civile, sektori i pavarur, sektori i shoqatave dhe sektori i liruar nga taksat. Këto terme të ndryshme u krijuan për shkak të qasjeve të ndryshme në rregullimin e tij, traditave dhe kulturës së ndryshme që kushtëzuan zhvillimin e tij, gjë që çoi edhe në përkufizimet e ndryshme.

Vakëfi është një institucion islam që ka themelet e veta në burimet themelore islame: Kur'ani dhe Sunneti. Normat mbi të cilat mbështetet vakëfi janë krijuar përmes procesit të krijimit dhe interpretimit të së drejtës islame nga juristët përkatës muslimanë që i vendosën standardet e vakëfit. Vakëfi ka një rol të paçmuar në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë muslimane. Në shumë periudha të historisë, kur sistemet e ndryshme shtetërore në këto hapësira ishin në krizë, vakëfi mori iniciativën dhe plotësoi lëshimet, dobësitë dhe pafuqinë e shtetit. Kjo ishte e dukshme në fushën e fesë, arsimit, kulturës, shëndetësisë, çështjeve sociale, ekonomike, etj.

Dihet mirëfilli se prona e vakëfit, nën masat represive në sistemet e kaluara social-politike, është konfiskuar, nacionalizuar dhe shkatërruar në mënyra të ndryshme. Gjatë sundimit të Monarkisë Austro-Hungareze, Mbretërisë së SKS, Mbretërisë Jugosllave dhe ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, mbi 95% të pasurisë së vakëfit është konfiskuar, nacionalizuar dhe shkatërruar në mënyra të ndryshme.

Gjatë gjithë historisë, vakëfi ishte në funksion të nevojave të muslimanëve, duke ruajtur gjithmonë bamirësinë e tyre themelore dhe qëllimin njerëzor. Paraardhësit tanë nuk ishin egoistë dhe nuk mendonin vetëm për veten e tyre, por edhe për të mirën e komunitetit më të gjerë. Ata investuan në vetvete, dhe në fëmijët e tyre, por edhe në njerëz të tjerë dhe në shumë gjenerata prapa. Rezultati i kësaj ishin rrugët e shumta, urat, burimet, xhamitë, teqetë, mektebet, mesxhidet, hanet, dyqanet, etj.

Vakëfi paraqet një institucion që nuk ka konkurrencë pasi në idenë e tij, Islami përmes vakëfit është në gjendje të ofrojë mekanizma për zgjidhjen e sfidave dhe nevojave të shumta shoqërore. Fuqia e vakëfit qëndron në multifunksionalitetin e tij, faktin se i ka rrënjët dhe dimensionet e veta shpirtërore, ekonomike, juridike, kulturore dhe shoqërore. Kjo shpjegon qëndrueshmërinë dhe forcën e tij, por edhe arsyet për luftën kundër vakëfit nga shumë shtete dhe regjime të kaluara që kanë kaluar nëpër historinë dhe hapësirën tonë.

Falë vakëfit, Bashkësia Fetare Islame në RMV e ka mbështetjen e saj të sigurtë dhe të vendosur për të kryer lirshëm misionin e saj mes besimtarëve. Kjo është edhe arsyeja se pse duhet të jemi të vetëdijshëm për vlerën e vakëfit, dhe kjo kryesisht do të thotë që vakëfi si një institut në legjislacionin tonë duhet të njihet dhe të mbrohet, kështu që koha e kaluar dhe e vështirë e rrëmbimit dhe uzurpimit të vakëfit në baza të ndryshme nga sistemet ligjore shtetërore dhe individët, të mos rikthehet më në të ardhmen.

Në këtë punim, u konstatua se, BFI e Maqedonisë së Veriut prej viteve të para të pluralizmit, ka qenë e para që ka iniciuar nga Qeveria, kthimin e pronave bashkësive fetare në përgjithësi, që sistemi i dikurshëm komunist i kishte nacionalizuar, uzurpuar dhe plaçkitur.

Poashtu, në këtë punim, u morr vesh se, BFI e Maqedonisë së Veriut asnjëherë nuk ka pranuar asnjë marrëveshje politike për kthimin e pronave të saj, por ka ndjekur procedurat ligjore juridike, duke u nisur nga motoja: prona na është marrë me akt juridik dhe duhet të na kthehet poashtu me akt juridik.

Edhe përkundër miratimit të Ligjit për denacionalizim në vitin 1998 megjithatë, në këtë punim, u konstatua se, gjatë zbatimit të tij në praktikë, dalin në shesh shumë pengesa dhe komplikime me qëllim të pengimit të kthimit të vakëfit. Në këtë drejtim, vlen të theksohet edhe intervista e Kryetarit të BFI të RMV-së, Reisu'l-Ulema Sulejman efendi Rexhepit, në vitin 2013 kur pohon se, në bisedë me kryeministrin e atëhershëm para se të miratohet ky ligj, Branko Cervenkovski, haptas na e tha: “mos ushtroni iluzione se do të ju kthehet prona që ju është marrë juve, nga një arsye shumë e madhe se atëherë ju duhet të jeni shteti, ndërsa neve filiala e juaj”.

Për fat të keq, gjithnjë sipas Kryetarit të BFI të RMV-së, edhe sot e kësaj dite BFI-ja vazhdon të jetë e diskriminuar, sepse sipas të dhënave që i ka kjo bashkësi fetare, duke marrë parasysh në total të gjitha këto (pra deri në vitin 2013), nëse përkthehet në përqindje sa është arritur brenda

këtyre viteve sa është në funksion ligji për denacionalizim, vetëm 10 për qind është arritur të kthehet nga vakufi, që domethënë se, 90% i pronës së BFI-së shfrytëzohet nga individë, kompani të ndryshme dhe nga vetë shteti. Më e keqja, sipas tij, është se në krahasim me Kishën Ortodokse Maqedonase jemi të diskriminuar, sepse kësaj të fundit i është kthyer 90 për qind e pronës dhe përveç asaj i kanë dhënë edhe pronë të re, siç është hoteli “Izgrev” në Strugë dhe një kazermë në Maqedoninë Lindore për shfrytëzim në afat prej 100 vitesh¹⁸⁷.

Në një vijë me konstatimet e mësipërme lidhur me zbatimin e Ligjit për denacionalizim dhe të krejt procesit në fjalë në RMV, janë edhe konstatimet e Avokatit të Popullit të RMV-së, z. Ixhet Memeti të theksuara në një intervistë të vitit 2014, ku thuhet se, zbatimi i Ligjit për Denacionalizim në Maqedoni, gjegjësisht procesi për kthimin e pronave të konfiskuara nga qytetarët në mënyrë të dhunshme nga sistemi i mëparshëm, ishte selektiv dhe nuk arriti qëllimin: *“Ajo që qytetarët e shprehin te institucioni Avokati i Popullit, është se ky proces nuk arriti t’i shërojë plagët e të kaluarës edhe pse një pjesë e qytetarëve arritën të kthejnë pronën e tyre. Pjesa e atyre që kanë perceptim se ky Ligj dhe ky proces nuk arriti t’i shërojë ato plagë, janë ata që kërkojnë ndihmë nga Avokati i Popullit dhe nuk arritën të kthejnë pronën e tyre dhe vlerësoj se ky proces shkoi sa për sy e faqe, se ky proces ishte shumë selektiv, se me këtë proces shteti jo me seriozitet deshi t’ua kthejë pronën e marrë në mënyrë të dhunshme qytetarëve, por sa për ta kryer atë obligim se edhe R. e Maqedonisë miratoi Ligj për Denacionalizim dhe ky proces mori fund”*. Sipas tij, organet, që duhej të realizonin denacionalizimin, vepronin në mënyrë selektive ndaj qytetarëve, por edhe ndaj bashkësive fetare. *“Te qytetarët u la një dyshim se organet shtetërore për kthimin e pronës veprojnë në mënyrë selektive, ndryshe vepronin me lëndët të cilat kishin të bëjnë me kthimin e pronësisë të bashkësive fetare kur bëhej fjalë për Kishën ortodokse maqedonase, ndryshe vepronin kur bëhej fjalë për Bashkësinë e fesë islame”*¹⁸⁸.

Lënia vakëf është edhe një formë e veçantë e arritjes së njërit nga parimet më qenësore shoqërore-morale të Islamit, e kjo është sakrifikimi për të mirën e përgjithshme. Por, nuk duhet harruar se lënia vakëf ka qenë traditë edhe para Islamit, që është praktikuar nga profetët e Zotit,

¹⁸⁷ *Të pakompromistë për interes fetare dhe kombëtare*, <http://bfi.mk/te-pakompromiste-per-interesat-fetare-dhe-kombetare/>

¹⁸⁸ Ixhet [Memeti, Kthimi i pronës u bë në mënyrë selektive](http://al.mrt.com.mk/node/4797), <http://al.mrt.com.mk/node/4797>

dhe nga ithtarët e tyre. Termi vakëf në hapësirën tonë shqiptare është i njohur. Fjalori i gjuhës shqipe, këtij termi i ka ndarë vend të veçantë ku thotë se vakëfi është pasuri e patundshme, që ishte pronë e një xhamie, e një kishe, e një teqeje a e një manastiri; apo vend i shenjtë, sipas përfytyrimeve mistike fetare.

Institucioni i vakëfit ishte i pranishëm në të gjitha sferat e jetës shoqërore në territorin e RMV-së duke u bërë kështu një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, fetar dhe kulturor të këtij areali, si dhe duke shërbyer në të njëjtën kohë edhe si një instrument i fuqishëm për ndihmë, solidaritet dhe përkrahje sociale. Sistemi komunist ka qenë kohë kur janë marrë vendime, janë miratuar ligje për marrjen, shpronësimin dhe shtetëzimin e vakëfit dhe janë konfiskuar dhe nacionalizuar një pjesë e madhe e vakëfeve që kanë qenë pronë e BFI-së. Nën parullën se: “toka u takon atyre që e punojnë”, pushteti i ri komunist me Ligjin për Reformën Agrare dhe Kolonizimin të 23 gushtit 1945, të cilin e miratoi Kuvendi i Përkohshëm Popullor i Jugosllavisë Demokratike Federative (JDF), mori hapësira të stërmëdha toke. Marrja e tokës bashkësive fetare u shpjegua, mes të tjerash, me ndërtimin e unitetit të ardhshëm të popujve jugosllavë.

Veprimtaria e Bashkësisë Islame në aspekt të kthimit të pronës së vakëfit të marrë me dhunë filloi krahas me paralajmërimin e procesit të reformës ekonomike, politike dhe juridike në Jugosllavi. Funkionarët më të lartë të Bashkësisë ua parashtruan kërkesat përkatëse organeve politike. Operacionalizimi i atyre kërkesave pasoi me vendimin e Kuvendit Suprem të Bashkësisë Islame të RSFJ-së të datës 06.11.1990, me të cilën u angazhuan meshihatet që deri në fund të Ramazanit (prill) 1991 të përpilojnë listën e të gjitha patundshmërive të vakëfit në territoret e tyre, si ato të marra pas vitit 1945, ashtu edhe të atyre që ishin ende në pronësi të Bashkësisë Islame. Kuvendi Suprem do t’iu dërgonte organeve federale kërkesë për kthimin e pronës së marrë, ndërsa kuvendet në republikat e veçanta, do t’i dërgonin kërkesë autoriteteve kompetente republikane.

Meshihati në Shkup i parashtrroi kërkesë qeverisë së Maqedonisë për kthimin e pronës së tërësishme vakëfore të marrë. Si shembull i korrespondencës midis Bashkësisë Islame të Maqedonisë me organet shtetërore për kthimin e disa objekteve sakrale të shtetëzuara, po e

përmendim një shkresë nga BI, të datës 22.05.1991, drejtuar Kuvendit të RS të Maqedonisë, ku kërkohet kthimi i (1) objekteve fetare të shtetëzuara: Jeni Xhamisë në Manastir (që shfrytëzohej si galeri artistike); Hajdar Kadi xhamisë, po ashtu në Manastir (që shfrytëzohej si magazinë për verëra); Zibija – kërkë xhamisë në Prilep (e shfrytëzuar si magazinë); Mesxhidi në Manastir (i shfrytëzuar si hapësirë afariste); (2) objekte fetare të uzurpuara: Harabati Baba Teqeja në Tetovë (e shfrytëzuar pjesërisht si restorant, e pjesërisht si muze); dhe (3) objekte fetare të rrënuara, monumente kulture.

Që nga kjo periudhë e deri më tash vazhdon procesi i denacionalizimit të vakëfeve dhe një pjesë e tyre ka përfunduar me sukses.

Si përfundim mund të themi se vakëfet kanë lozur rol të rëndësishëm në kontekst historik por kthimi i tyre, nga njëra anë do ta përforcojë kontekstin e shtetit ligjor, ndërsa nga ana tjetër do të shërbejë për zhvillimin pozitiv të proceseve edukative dhe kulturore fetare të BFI-së të cilat do të duhet të jenë edhe në shërbim të popullatës dhe shoqërisë. Angazhimi maksimal i Myftinisë së Tetovës në kontekst të kthimit të pronave vakëfore të BFI-së është një shembull i mirë i angazhimit si juridik ashtu edhe shoqëror për zbutjen e padrejtësisë që i është bërë këtij institucioni në sistemin e mëparshëm.

BIBLIOGRAFIA

A. BURIME ARKIVORE

Arkivi I Maqedonisë , Berat, numër 5,6,25,28

Arkivi I Maqedonisë , Vakëfname numër 1-24.

Arkivi i Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfve në Turqi (VGMA).

Arkivi I Osman I Kryeministrisë së Turqisë (BOA).

Архив Југославије /Министарство просвете Кралевине Срба, Хрвата и Словенаца, фасцикл 1102, арх. јед. 1429 (Велика Медреса Крал Александар I), Историја Школа у Скопљу.

Државен Архив на Република Македонија, фонд Улема Меџлис во Скопје , кутија 23, документи 91-96, листови 378-414, ДАРМ. 1. 613. 23. 91-96/378-414).

Myhimme Defteri Numër 7 (975-976/1567-1569) Përmbajtja-Transkripcioni-Indeksi, Botimet e Arkivit Osman të Kryeministrisë, Ankara 1998.

Sixhilet e Manastirit, Departamenti për dokumentacion pranë Institutit për hystori nacionale të RMV, Shkup.

B. TEKSTE UNIVERSITARE, PUBLIKIME, RAPORTE

Ahmet Akgündüz, *Islâm Hukukunda ve Osmanli Tatbikatında Vakif Müessesesi*, Ankara 1988.

Ahmet Sherif, *Vakëfet në Maqedoni në periudhën osmane*, Shkup 2006.

Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.

Ayverdi Haki Ekrem, *Avrupada Osmanli Eserleri, III,IV*, Stamboll 1982.

Ballagija, Abdusselam, *Ulloga Vakufa u verskom i svetovnom prosvetivanju nasih muslimana*, Beograd 1933.

Begović Mehmed, *Vakufi u Jugosllaviji*, Beograd 1963.

Bilmenoglu, Nadi, *Kalkandelen dun ve bugun*, Stamboll 1975.

Birol, Nurettin dhe Akpinar, Deniz, *xix. yüzyıl sonlarında manastır vilâyeti ve vali halil rifat paşa'nın faaliyetleri (1887-1889)*, **Akademik Sosyal Araştırmalar Dergisi**, Viti: 3, numër: 14, Qershor 2015.

Dževat Hodžić, *Vakuf i islamska prosvjeta u našim krajevima*, në; "Islamska misao", br. 66, Sarajevo juni 1984.

Crnić, J, *Kako vratiti dužeto nacionalizacijom, konfiskacijom i agrarnom reformom*, Zagreb 1991.

Čanović, Svetozar G., *Specifični problemi nastave u školama Kosova i Metohije*, Priština, 1967.

Çizakça, Murat, *Osmanlı Donemi Vakıfların Tarihsel ve Ekonomik Boyutları*, Stamboll 2000.

Ekrem Buğra Ekinci, *Osmanlı Hukuku: Adalet ve Mülk*, Stamboll, Arı Sanat, 2012).

Enciklopedia e Dijanetit të Turqisë DIA, XIII, Stamboll, 1986.

Elezović Glisla, *Turski spomenici u Skoplju*, Glasnik Skopskog naučnog društva, Libri I, fletorja I, Shkup 1925.

Enes Durmišević, "Vakufi u različitim političkim sistemima - odnos vlasni prema vakufima, posebno posle agresije na BiH", në **Novi Muallim**, vjeshtë 2011.

Filip Hiti, *Istorija Arapa*, Sarajevo, 1983.

Finzgar, A dhe Stojanović, D, *Drushtvena stojina*, në Enciklopedija imonigskog prava i prava udruženog rada, Beograd 1978.

Gams, A, *Svojina*, Beograd 1988.

Güran, Tevfik, *Ekonomik ve Mali Yönleri ile Vakıflar Süleymaniye ve Şehzade Süleyman Paşa Vakıfları*, Stamboll.

Hüseyin Hatemi, *Türk Hukukunda Vakıf Kurma Muamelesi: Önceki ve Bugünkü*, Stamboll, 1969.

Ibrahim Džananović, *Vakuf u svjetlu islamskih propisa*, në: "Anali Gazi Husrev-Begove biblioteke", knjiga IX-X, Sarajevë, 1983.

Inbashi, M, dhe Kul, E, *Balkanlarda bir turk sehri Uskup*, Ankarë 2018.

Kaleshi, Hasan, *Najstari Vakufski Dokumnti u Jugoslaviji na Arapskom Jeziku*, Prishtinë, 1972.

Kaleshi Hasan, *Najstaria vakufname u Jugosllaviji*, Prillozi za orientallno fillollogiju, Fletorja X-XI, Sarajevë 1960.

Kaleshi Hasan dhe Mehmedovski Mehmed, *Tri vakufnami na Kaçanikli Mehmed Pasha*, Shkup 1958.

Kaleši, Hasan në: *Kosova nekad i danas*, Beograd, 1973.

Koprulu, Bulent, *Tarihte Vakifllar*, Hukuk fakultesi mecmuasi, VIII/3-4, Ankarë 1951.

Lidija Kumbaracı – Bogoyevič, *Arkitektura Osmane në Shkup*, Stamboll 2008.

Lita Qerim, Zgjedhjet e vitit 1937 konform Kushtetutës së BFI-së të vitit 1936 në Mexhlin e Ulemasë së Shkupit, tryezë shkencore nga Bashkësia Fetare Islame në RM “80 vjet të Kushtetutshmërisë së BFI-së”, Riaseti i BFI-së, Shkup 2017.

Mehmed Mujezinović, *Islamska epigrafika BiH*, Knjiga I, Sarajevë, 1974.

Mevlüt Dede, *Vakëfet e Shkupit; Një analizw e historisë sociale*, Instituti i Shkencave Sociale pranë Universitetit Gazi, Teza e Doktoraturës, Ankarë 2015.

Nerkez Smailagić, *Leksikon Islama*, Sarajevo, 1990.

Ömer Lütfi Barkan, *“Fatih İmareti 1489-90 Yılları Muhasebe Bilançoları”*, **İktisat Fakültesi Mecmuası**, vëll. XXIII, Stamboll: 1963.

Osman Nuri Topbash, *Vakëfi, dhurimi dhe shërbimi*/përktheu Mithat Hoxha, pa vend dhe vit botimi.

Özcan, Tahsin *“Osmanli Vakif Hukuku Çalışmaları”*, **Türkiye Arastirmalari Literatur Dergisi**, III/5, Stamboll 2005.

Ozer, Mustafa, *Uskupte turk mimarisi*, Ankarë 2006.

Öztürk, Nazif ,*“Sosyal Siyaset Açısından Cumhuriyet Öncesi Vakıflar”*, **Cumhuriyetin 80. Yılında Uluslararası Vakıf Sempozyumu**, Ankarë: 2004.

Ramadani, Naser, *Depërtimi osman në Maqedoni dhe zhvillimi I arsimit islam gjatë shekujve XV-XVI*, Shkup 1998.

Redžepagić, Jašar, *Razvoj i obelježa turskih škola na teritoriji današnje Jugoslavije do 1912 godine*, "Studije", 1988.

Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008.

Sokolloski Metodija, *Krajshte Isa bega Isakoviça*, GINI, XII/1, Shkup 1979.

Sokolloski Metodija, *Osvrt na Vakufite i vakufskite imoti vo Tetovska nahija vo XV i XVI vek*, XX/3, Shkup 1986.

Stojanovski Aleksandar, *Gradovite vo Makedonija od krajot na XIV do XVI vek*, Shkup 1981.

Shabanovic, Hazim, *Dvije najstarije vakufname u Bosni*, **Prilozio za orijentalnu filologiju I istoriju jugoslovenskih naroda pod turskom vladavinom**, II, Sarajevë, 1951

Sherif Ahmed, *Vakëfet në Maqedoni në periudhën Osmane*, Shkup 2006.

Tetovo i Tetovsko niz istorijata, Tetovë 1982.

Ulken, Hilmi Ziya , *“Türk Vakıf Sistemi ve Türk Şehirciliği”*, Vakıflar Dergisi, IX, Ankara 1971.

Yediyıldız Bahaeddin, *“Türk Vakıf Kurucularının Sosyal Tabakalaşmadaki Yeri 1700-1800”*, **Osmanlı Araştırmaları**, II, Stamboll: 1982.

Vasileviç Haxhijovan, *Skoplje i njegova okolina*, Beograd 1930.

Zagorka Janc, *Islamska minijatura*, Zagreb, 1985.

Ziya Kazici, *Historia e arsimit islam*, Tiranë, 2001.

C. BURIME JURIDIKE POZITIVE

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, e ndryshuar me amandamentet e vitit 1992, 1998, 2001 dhe 2005
- Ligji për shoqatat dhe fondacionet i vitit 2010.
- Ligji për denacionalizim, me ndryshimet e viteve 1998, 2000 dhe 2003.
- Ligji për tokë ndërtimore i vitit 2015.
- Ligji për eksproprijim i vitit 2012 dhe 2013.
- Ligji i për pronësi dhe të drejtat tjera sendore i viteve 2001, 2008, 2009 dhe 2010.
- Raport për të drejtat e njeriut në maqedoni për vitin 2016.

SHTOJCË

VENDIMET GJYQËSORE TË LËNDËVE PËR DENACIONALIZIM

- 8. Kërkesa për denacionalizim e Myftinisë së Shkupit me numër 19-08-715/1 (38) e datës 07.09.2000.**

ДН број 19- 08-715/1 (38)-2

Министерот за финансии, преку Комисијата за одлучување по барањата за денационализација поднесени од старешините на верските објекти на верските заедници во Република Македонија I, со седиште во Министерството за финансии, постапувајќи по барањето за денационализација ДН број 19- 08-715/1 (38) од 07.09.2000 година поднесени од барателот Исламска Заедница на Република Македонија-Муфтиство Скопје, врз основа на член 15 став 2 од Законот за денационализација („Службен весник на Република Македонија“ број 43/2000 пречистен текст) и решението на Комисијата на Владата на Република Македонија за решавање на управни работи од втор степен од областа на денационализација бр. 47-247-37/2 од 13.03.2004 година, согласно член 205 од Законот за општа управна постапка (сл. Весник на Р.М бр. 38/2005) на ден 13.08.2009 година го донесе следното

РЕШЕНИЕ

1. Барањето за денационализација ДН број 19- 08-715/1 (38) од 07.09.2000 година поднесено од Исламска Заедница на Република Македонија-Муфтиство Скопје за недвижен имот кој представува КП 4957 КО Скопје - **СЕ УВАЖУВА.**

2. Недвижниот имот **земјиште под зграда**, што представува дел од КП 4957 КО Скопје стар премер; а денес: КП 9359 во површина од 1091 м2, КП 9346 во површина од 28 м2, КП 9345 во површина од 42 м2, КП 9351 во површина од 34 м2, КП 9352 во површина од 26 м2, КП 9353 во површина од 33 м2, КП 9354 во површина од 58 м2, КП 9355 во површина од 27 м2, КП 9356 во површина од 54 м2, КП 9357 во површина од 41 м2 и КП 9358 во површина од 41 м2-сите КО Центар 1 (или вкупно од 1475 м2 земјиште под зграда), како и двор во површина од 322 м2 што представува КП 9359 КО Центар 1.

3. Недвижниот имот деловен простор што представува КП 4957 КО Скопје стар премер (КАПА-АН) денес КП 9359 КО Центар 1:

- дуќан на приземје во површина од 38,01 м2 локал 1
- дуќан на приземје во површина од 24,88 м2 локал 2
- дуќан на приземје во површина од 14,30 м2 локал 3
- дуќан на приземје во површина од 14,61 м2 локал 4
- дуќан на приземје во површина од 14,61 м2 локал 5
- дуќан на приземје во површина од 16,06 м2 локал 6
- дуќан на приземје во површина од 14,63 м2 локал 7
- дуќан на приземје во површина од 14,30 м2 локал 8
- дуќан на приземје во површина од 16,21 м2 локал 9

- дуќан на приземје во површина од 15,97 м2 локал 10
- дуќан на приземје во површина од 16,53 м2 локал 11
- дуќан на приземје во површина од 24,86 м2 локал 12
- дуќан на приземје во површина од 15,82 м2 локал 13
- дуќан на приземје во површина од 15,82 м2 локал 14
- дуќан на приземје во површина од 15,57 м2 локал 15
- дуќан на приземје во површина од 15,57 м2 локал 16
- дуќан на приземје во површина од 15,57 м2 локал 17
- дуќан на приземје во површина од 15,57 м2 локал 18
- дуќан на приземје во површина од 16,35 м2 локал 19
- дуќан на приземје во површина од 7,33 м2 локал 20
- дуќан на приземје во површина од 8,68 м2 локал 21
- дуќан на приземје во површина од 21,68 м2 локал 22

II

- дуќан на кат 1 во површина од 18,68 м2 локал 100
- дуќан на кат 1 во површина од 110,87 м2 локал 101, 102 и 103
- дуќан на кат 1 во површина од 36,01 м2 локал 104
- дуќан на кат 1 во површина од 17,98 м2 локал 105
- дуќан на кат 1 во површина од 20,38 м2 локал 106
- дуќан на кат 1 во површина од 20,82 м2 локал 107
- дуќан на кат 1 во површина од 21,31 м2 локал 108
- дуќан на кат 1 во површина од 19,84 м2 локал 109
- дуќан на кат 1 во површина од 26,68 м2 локал 110
- дуќан на кат 1 во површина од 34,67 м2 локал 111
- дуќан на кат 1 во површина од 20,07 м2 локал 112
- дуќан на кат 1 во површина од 24,11 м2 локал 113
- дуќан на кат 1 во површина од 22,65 м2 локал 114
- дуќан на кат 1 во површина од 18,02 м2 локал 115
- дуќан на кат 1 во површина од 31,47 м2 локал 116
- дуќан на кат 1 во површина од 22,27 м2 локал 117
- дуќан на кат 1 во површина од 22,04 м2 локал 118
- дуќан на кат 1 во површина од 88,25 м2 локал 119, 120, 121 и 122
- дуќан на кат 1 во површина од 33,00 м2 локал 123

одземен во корист на државата од Вакувството поверенство Скопје со указ на Владата на НРМ У.бр. 24 од 28.04.1948 година и тапија Р. бр. 790/61 од 07.06.1961 година на околски суд Скопје, при спроведување на Законот за национализација на приватните стопански претпријатија и Законот за национализација на наемни згради и градежно земјиште; **СЕ ВРАЌА ВО СОПСТВЕНОСТ** на барателот Исламска Заедница на Република Македонија -Муфтиство Скопје.

4. По правосилноста на ова решение недвижноста од точка 2 и 3 на ова решение да се евидентира во книгите за недвижности во Агенција за катастар на недвижности, центар за катастар на недвижности Скопје.

5. Предавањето во владение на недвижниот имот ќе се изврши по правосилноста на ова решение и по поднесено барање од барателот.

Образложение

Барателот Исламска Заедница на Република Македонија -Муфтиство Скопје, до Министерството за финансии- Управа за имотно правни работи, Подрачна единица Центар поднесе барање за денационализација под ДН број 19- 08-715/1 (38) од 07.09.2000 година.

Постапувајќи по барањето за денационализација, Комисијата за одлучување по барањата за денационализација со седиште во општина Центар, со решение ДН бр. 19-08-136/6 (38) од 20.04.2001 година барањето на барателот го отфрлила.

